



International Conference
on **Islamic Studies**



The Role of Women
in Modern Society from
the Islamic Perspective

10 January 2019
University College Bedër

PROCEEDING BOOK



Department of Islamic Sciences, University College Bedër

Muslim Community of Albania

World Muslim Communities Council

Second International Conference on Islamic Studies

Konferenca e II Ndërkombëtare në Studimet Islame

**The Role of Women in Modern Society from the Islamic
Perspective (ISCON II)**

**Roli i gruas në shoqërinë moderne sipas këndvështrimit
Islam (ISCON II)**

Tiranë, 10 janar 2019

<http://conf.beder.edu.al/iscon/>

Bordi Shkencor:

H. Skender Bruçaj

Prof. Dr. Ferdinand Gjana

Dr. Ali Al Nuaimi

Dr. Mohammed Bechari

Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi

H. Bujar Spahiu

Dr. Jamal al Safarti

Dr. Genti Kruja

Msc. Agron Hoxha

Msc. Dorian Demetja

Msc. Fatma Karaj

Msc. Lorela Shehu

Msc. Hysni Skura

Msc. Xhorxhina Seferi

Msc. Aorel Senja

Editor:

Dr. Genti Kruja

Redaktor shkencor:

Prof. Asoc. Rahim Ombashi

ISBN: 978-9928-4590-3-9

Pasqyra e Lëndës

Konferenca e II Ndërkombëtare në Studimet Islame.....	1
Bordi Shkencor	2
Bordi Organizativ.....	2
Pasqyra e Lëndës.....	3
Skender Bruçaj - Fjala Përshëndetëse	7
Ferdinand Gjana - Fjala Përshëndetëse	10
Loreta Aliko - Fjala Përshëndetëse	12
Rahim Ombashi - Gruaja shqiptare - Ajo që bëri të dëgjohet heshtja	17
Gjergj Sinani - Burri dhe gruaja në fetë monoteiste	24
Matilda Likaj Shaqiri - Analizë sociologjike e fesë, edukimit dhe familjes: Shembulli i rolit të gruas në Islam	45
Gëzim Tushi - “Gratë në kohën e tyre dhe beteja për barazi gjinore”	63
Zenepe Dibra - Kontributi patriotik, emancipues dhe kultural i gruas muslimane në historinë e Shqipërisë	74
Dr. Ilirjana Kaceli - Roli i gruas në edukimin e brezave, bazuar në revistat kulturore islame.....	105
Fatma Karaj - Të drejtat e gruas në Islam dhe qasja e myslimanit në trajtimin e çështjeve që përbëjnë debat	131

Konferenca e II-të Ndërkombëtare në Studimet Islame (ISCON)

“Roli i gruas në shoqërinë moderne sipas këndvështrimit Islam”

SEANCA E PËRSHËNDETJEVE

Moderator: Rahim Ombashi

- 1. Skender Bruçaj** - Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë
- 2. Ferdinand Gjana** - Rektor i Kolegjit Universitar Bedër
- 3. Mohammed Bechari** - Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Abu Dabi, Emiratet e Bashkuara Arabe
- 4. Loreta Aliko** - Kryetare e Komitetit Shtetëror për Kultet

SEANCA E PARË SHKENCORE:

“Roli i gruas në edukimin e shoqërisë”

Moderator: **Bujar Spahiu** - Nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

- 1. Rahim Ombashi** - Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane, KU Bedër, *“Gruaja shqiptare - Ajo që bëri të dëgjohej heshtja”*
- 2. Fatmah Aldahmani** - Universiteti Mohammad al Khamis University, Abu Dabi
“Gruaja myslimane si model në shoqërinë e Emirateve të Bashkuara Arabe”
- 3. Liya Makhmutova** - Presidente e Bashkimit të Grave Myslimane të Shteteve Balltike,
“Roli i gruas myslimane në ndryshimin e shoqërisë evropiane”
- 4. Gjergj Sinani** - Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale,
“Figura e gruas në fetë e mëdha monoteiste”
- 5. Matilda Likaj** - Universiteti i Durrësit *“Aleksandër Moisiu”*

“Analizë sociologjike e fesë, edukimit dhe familjes: shembulli i rolit të gruas në Islam”

6. Lauren Luli - Nënkyetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,

“Gruaja myslimane, si promovuese e vlerave të Islamit në shoqëri”

SEANCA E DYTË SHKENCORE:

“Të drejtat e gruas në shoqërinë moderne”

Moderator: **Tidita Abdurrahmani** - Dekane e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit, KU Bedër

1. Gëzim Tushi - Shërbimi Social Shtetëror,

“Gratë në kohën e tyre. Rreth problemit të barazisë gjinore në shoqërinë e sotme shqiptare”

2. Natalia Tampega - Universiteti St. Petersburg

“Roli i gruas në aktivitetin e organizatave fetare myslimane në Rusi”

3. Zenepe Dibra - Presidente e Shoqatës “Gruaja Intellektuale Shkodrane”

“Kontributi patriotik, emancipues dhe kultural i gruas myslimane në historinë e Shqipërisë”

4. Ana Uka - Kolegji Universitar Bedër,

“Divorci dhe dhuna në familje, plagë të shoqërisë moderne”

5. Ilirjana Kaceli - studiuese

“Roli gruas në edukimin e brezave, bazuar në revistat kulturore islame”

6. Besa Ismaili - Bashkësia Islame e Kosovës

“Rolet e ndryshueshme të grave në shoqëritë myslimane”

7. Fatma Karaj - Përgjegjëse e Zyrës së Gruas, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

“Të drejtat e gruas në Islam”

SEANCA E PËRSHËNDETJEVE

Moderator: Rahim Ombashi

- 1. Skender Bruçaj** - Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë
- 2. Ferdinand Gjana** - Rektor i Kolegjit Universitar Bedër
- 3. Mohammed Bechari** - Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Abu Dabi, Emiratet e Bashkuara Arabe
- 4. Loreta Aliko** - Kryetare e Komitetit Shtetëror për Kultet

Skender Bruçaj¹ - Fjala Përshëndetëse

Paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të gjithë Ju.

Të nderuar pjesëmarrës!

Në Kur'anin Famëlartë, në suren “Nisa”, ka shumë dispozita të cilat kanë të bëjnë me statusin dhe rolin e gruas në shoqëri. Aty përcaktohet qartë se, origjina, zanafilla e burrit dhe e gruas është një e përbashkët dhe janë krijuar për të njëjtin qëllim, që të njohin dhe të falënderojnë Krijuesin e gjithësisë, për mirësitë dhe begatitë që Ai u ka dhuruar.

Burri dhe gruaja përshkruhen si mbulojë (libas) të njëri-tjetrit (2:187) dhe si bashkëshortë, që jetojnë dhe banojnë në qetësi (33:21). Burri dhe gruaja janë dërguar, për të plotësuar njëri-tjetrin (9:71). Secilit i kërkohet, që të përmbushë përgjegjësitë e caktuara, që i janë ngarkuar për të mirën e të dyve, të familjes dhe të mbarë shoqërisë.

Hazreti Ademi nuk ishte i plotë, ishte i vetmuar në parajsë dhe pastaj jeta mori kuptim kur gjeti Havanë. Burri dhe gruaja nuk janë njëlloj, por plotësojnë njëri-tjetrin.

Gruaja në Islam në rolin e nënës ka një pozitë jashtëzakonisht të rëndësishme. Kur Profeti Muhamed (a.s) u pyet nga një besimtar: “O i dërguar i Zotit, kush është njeriu që e meriton më së shumti shoqërinë dhe respektin tim?”, ai (a.s) iu përgjigj: “Nëna.” Burri e pyeti: “Po pas saj?” Profeti (a.s) iu përgjigj: “Nëna.” Burri vazhdoi:

¹ H. Skender Bruçaj, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

“Po pas nënës?” Profeti (a.s) u përgjigj: “Nëna.” Burri e pyeti për të katërtën herë: “Po pas saj?” Profeti (a.s) u përgjigj: “Babai.”

Nga moria e porosive profetike për femrën, si bijë, si vajzë e re, kuptojmë dhe mësojmë se ajo duhet të trajtohet me dinjitet duke respektuar individualitetin e saj. Përkujdesja dhe investimi për edukimin dhe formimin e vajzave, sipas mësimëve profetike është shkak për fitimin e xhenetit.

Në të njëjtën kohë, Profeti Muhamed (a.s) na adresohet të gjithëve, duke na thënë se, më i miri ndër ju është ai që sillet mirë me familjen e tij, me bashkëshorten e tij.

Kur’ani i paraqet gratë besimtare si një shembull për t’u ndjekur, duke sjellë në vëmendje se roli dhe kontributi i gruas është i rëndësishëm në shumë sfera të shoqërisë, prandaj ne kurrsesi nuk mund ta kushtëzojmë apo kufizojmë rolin dhe përgjegjësinë e saj.

Islami i ka besuar gruas të njëjtin amanet që i ka besuar burrit, amanetin e mëkëmbësit të Zotit në tokë. Ai e ka barazuar gruan me burrin në nderimin dhe fisnikërinë që u ka bërë të dyve. Ai i ka barazuar në obligime, mbajtjen e përgjegjësiave dhe shpërblimin që do të kenë sipas punëve të mira që kanë kryer.

Gruaja po ashtu ka një status të lartë në familje. Ajo jo vetëm është e barabartë me burrin, por gëzon edhe të drejtat e saj. Allahu në Kur’an i ka nderuar gratë duke u ripohuar dinjitetin, statusin njerëzor dhe partneritetin e tyre me burrat. Për këtë Hz. Muhamedi (a.s) ka thënë: “Gratë janë partnere të burrave.”

Ky është imazhi i vërtetë i gruas dhe statusi i saj në Islam, larg deformimeve ideologjike, të drejtave zakonore të verbra, paragjyqimeve dhe qëndrimeve islamofobike, që ndeshen shpesh edhe në shoqërinë tonë ndaj grave të mbuluara.

Mund të themi se në Shqipëri femrat myslimane janë aktive në jetën shoqërore në role të ndryshme, si mësuese, mjeke, inxhinieri, politikane dhe lidere e komunitetit të vet, etj., duke ofruar një model dhe një kontribut të rëndësishëm në progresin dhe mbarëvatjen e shoqërisë sonë. Por, nga ana tjetër, është për të ardhur keq kur sheh se akoma ndeshemi me problemin e dhunës ndaj gruas, dhunës në familje, fakt ky që është një ndër shkaqet kryesore të numrit e lartë të divorceve në vend.

Ne si Komunitet Mysliman, në bashkëpunim edhe me komunitetet e tjera fetare, kemi firmosur një marrëveshje bashkëpunimi për t'iu ardhur në ndihmë grave të dhunuara, si dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë për rëndësinë dhe rolin jetik të gruas në stabilitetin dhe progresin e shoqërisë.

Referenca të ndryshme nga jeta e Profetit na bëjnë të qartë se askush dhe për asnjë arsye nuk ka të drejtë t'i thotë gruas të heshtë e të mos i kërkojë të drejtat e veta. Për më tepër, sipas Islamit, ajo nuk është e detyruar ta konsiderojë burrin e saj si një referencë të vetme në çështjet e ligjit dhe të fesë.

Prandaj, emancipimi dhe integrimi e gruas në shoqërinë tonë duhet të jetë një nga prioritetet tona më të rëndësishme, por duhet bërë duke respektuar dhe vlerësuar personalitetin, integritetin dhe temperamentin e gruas, si një forcë e madhe jetike, që mund të ndryshojë rrjedhën e shoqërisë sonë. Intelektuali i njohur, Ferit Vokopola, në revistën “Zani i Naltë”, në vitin 1937, shkruante: “Le të shpresojmë se me marrjen pjesë të gruas në lamën e aktivitetit njerëzuer, atdheu i jonë do të përparojë me hapa gjigande drejt sferave të lumnisë landore e shpirtnore”.

Jemi në vitin 2019 dhe akoma shpresojmë, përpiqemi e punojmë që gruaia të zërë vendin e saj të merituar në shoqërinë tonë.

Mirënjohës për kohën dhe vëmendjen tuaj.

Ferdinand Gjana² - Fjala Përshëndetëse

I nderuar kryetar i KMSH, z. Bruçaj,

I nderuar Dr. Ali Al Nuaimi - President i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane;

I nderuar Dr. Mohammed Bechari - Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane

E nderuar znj. Aliko, Kryetare e Komitetit të Kulteve

Të nderuar pjesëmarrës,

Konferenca Ndërkombëtare që po organizohet sot, një bashkëpunim i shkëlqyer me KMSH-në dhe Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane, ka mbledhur studiues të ndryshëm dhe në qendër të konferencës është gruaja, një personazh kompleks, i brishtë, i pranishëm dhe i domosdoshëm në çdo shoqëri, që mbart në vetvete vlera të jashtëzakonshme.

“M’u desh shumë kohë për të pasur një zë që të dëgjohet dhe tani që e kam, nuk do të hesht.”- shprehet Madeleine Albright, një thënie që tregon se zhvillimi dhe emancipimi i gruas në shoqërinë e sotme moderne, integrimi në jetën politike, sociale e ekonomike nuk ka qenë fort i lehtë, për të mos thënë shumë i vështirë. Ky emancipim ka kaluar barrierat e mentaliteteve të mbrapshta të shoqërisë dhe ka kushtëzuar imazhin e një shteti dhe shkallën e kulturës së një populli apo të një kombi.

Po të hedhim vështrimin pas dhe të shohim rrethanat historike të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, figura e gruas shfaqet në përpjekje të përhershme për të fituar të drejtat e saj në familje dhe në shoqëri.

² Prof. Dr. Ferdinand Gjana, Rektor i Kolegjit Universitar Bedër

Shumëkush mund të mendojë se kjo temë është trajtuar shumë dhe mund t'i vijë në mendje nëse është apo jo e nevojshme?

Me lejoni të shpreh brengosjen time, lidhur me dy ngjarje ndodhur vetëm gjatë ditëve të fundit, ku një burrë, nuk e di se si mund ta përshkruaj, vret bashkëshorten dhe motrën e saj në një mënyrë makabre, vetëm se kërkon të vizitojë prindërit e saj. Dhe ngjarja tjetër, ajo ku një baba vret vajzën e tij, pa asnjë arsye dhe e gropos atë.

Shkëputa dy ngjarjet e ditëve të fundit, që janë dy shembuj shumë të dhimbshëm, nga shumë të tillë që ndodhin në Shqipëri, por edhe në vende të tjera. Këto seç më sjellin ndërmend epokën e injorancës që tregon historia islame para ardhjes së profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), kur njerëzit i groposnin të gjalla vajzat e sapolindura. Dhe më tej mendoj se si ai njeri i virtytshëm i çrrënjosi shumë zakone çnjerëzore për të ngritur një shoqëri të emancipuar dhe paqësore. Ky shembull duhet të vlejë për të gjithë, lidhur me detyrën dhe kontributin që duhet të japim në shoqërinë ku jetojmë.

Besoj që pyetja që ngrita se a është e nevojshme diskutimi për pozitën e gruas sot, mendoj që po dhe them se të gjithë duhet të kontribuojmë, në forma dhe mënyra të ndryshme, për barazinë e gruas në të gjitha aspektet e jetës sociale.

Mendoj se punimet tuaja, me tematikat e ndryshme që do të trajtojnë, do të plotësojnë akoma më shumë se cili është roli i gruas shqiptare sot në shoqëri dhe kontributi i saj i në cdo aspekt të jetës.

Gjithsecili prej jush është ekspert në fushat ku punon dhe studion, prandaj unë shpreh besimin se mesazhet që ju do të na transmetoni do të jenë pozitive, frymëzuese, të bukura dhe të thella, ashtu siç është edhe shpirti njerëzor.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen, ju uroj punë të mbarë dhe suksese në punën tuaj të përditshme profesionale dhe shkencore.

Loreta Aliko³ - Fjala Përshëndetëse

I nderuar Kryetar Bruçaj,

I nderuar Prof. Gjana,

Të nderuar miq e të ftuar,

Me kënaqësinë për ftesën, duke qenë grua, ndihem veçanërisht e përfshirë në këtë argument. Tema domethënëse e cila trajtohet sot është e një rëndësie të veçantë dhe ju përgëzoj për iniciativën dhe guximin qytetar, parë nën dritën e ngjarjeve të fundit të trishtueshme që lidhen me dhunën ndaj grave. Gratë përfaqësojnë një kontingjent të çmuar për çdo sistem politiko - ekonomik, për vetë bagazhin e tyre intelektual, për intuitën e natyrshme që mbartin, për energjitë e pashterrshme që posedojnë. Fuqizimi i gruas është parësor për zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë, të hapur dhe gjithëpërfshirëse dhe për përshpejtimin e rritjes ekonomiko - sociale. Gruaja përbën themelin e qelizës bazë së shoqërisë, familjes. Një nënë e mirë do të brumosë e rrisë fëmijë me virtyte e vlera të larta njerëzore dhe kjo pasqyrohet dhe përcillet edhe në të gjitha doktrinat fetare.

Në hadithin e Profetit thuhet: *“Parajsa gjendet nën këmbët e nënës”*. A nuk është ky një vlerësim që iu bëhet nënave të përkushtuara? A nuk meritojnë ato konsideratën më të lartë?

Fatkeqësisht ende sot, në shumë vende të botës, nënat, gratë e vajzat keqtrajtohen, privohen nga e drejta për të shprehur lirisht mendimet, vlerësimet e ndjenjat e tyre, lihen mënjanë dhe iu mohohen aftësitë e tyre menaxheriale, krijuese, arsimuese etj. Kjo ndodh edhe në shoqëritë më të zhvilluara perëndimore, ku

³ Kryetare e Komitetit Shtetëror për Kultet.

diferenca në trajtimin financiaro - hierarkik mes burrave dhe grave është akoma e ndjeshme. Shpesh, gratë ngrenë me forcë zërin e tyre për të kërkuar të drejtat themelore, por ky zë ngjan me pëshpëritjen e të mbyturit nëse përkrah tyre nuk gjenden burrat, djemtë, shokët e tyre të jetës. Reduktimi i pabarazive gjinore në procesin e punësimit, të të ardhurave dhe qasja për një "punë të denjë, konform nivelit profesional", do të përmirësonte gjendjen e grave në familje, do të zvogëlonte rrezikun e dhunës brenda kësaj të fundit dhe influenconte pozitivisht në marrjen e vendimeve të pjekura që ndikojnë mbi shoqërinë dhe kapitalin njerëzor. Investimi në edukimin e grave, sidomos të atyre në zonat rurale, promovimi i normave dhe shembujve kulturore, në të cilët gratë vlerësohen si partnere të barabarta me burrat, është jetësor për shoqëritë moderne.

Margaret Thatcher, e ashtuquajtur "Gruaja e hekurt" thoshte: *"Nëse doni që të thuhet diçka, kërkojani një burri, nëse doni që të bëhet diçka, kërkojani një gruaje!"* Në këtë shprehje përmbledhet esenca e forcës dhe vendosmërisë, kapacitetit dhe efikasitetit së grave, që në të njëjtën kohë ruajnë veçoritë psikologjike të natyrës së tyre, fisnikërinë dhe finesën femërore.

Aktualisht, kjo thënie vërtetohet nga kontributi i vyer i grave në të gjitha profesionet, edhe në ato që dikur konsideroheshin si një ekskluzivitet i burrave. Shoqëria shqiptare e sotme është një provë e gjallë e kësaj shkalle të lartë pjesëmarrjeje të grave në jetën politiko – ekonomiko - sociale. Por a kemi arritur ne majën e Olimpikut?

Shumë mbetet për të bërë, dhe për këtë duhen bashkuar forcat e të gjithë aktorëve të shoqërisë, laikë e fetarë, intelektualë e punëtorë, në nivel qendror e lokal; për këtë duhen përgatitur dhe ngritur struktura; ofruar alternativa, për dhënien e dinjitetit grave të nënshtruara e të keqtrajtuara. Kjo kërkon përpjekje konkrete të vazhdueshme, investime njerëzore e materiale, durim e punë bindëse tek burrat, por shpesh edhe tek vetë gratë, për të dalë nga

“guacka” e shtypjes. Kontributet që mund të jepen janë të shumta, dhe prandaj, konferenca të tilla, ku shkëmbehen eksperiencat mes vendeve, ku nxirren mësimet të vlefshme mbi rëndësinë dhe respektin e figurës së nënës, gruas, motrës, vajzës, në librat e shenjtë, kontribuojnë në rrëzimin e barrierave, në thyerjen e “Tabuve” dhe keqinterpretimeve.

Ashtu siç kam theksuar edhe në aktivitete të tjera, personalisht, dhe në emër të Komitetit Shtetëror për Kultet, vlerësoj me konsideratë të lartë KMSH, Universitetin “Bedër” dhe veçanërisht, Zyrën e gruas në KMSH, për argumentet që zgjedh, mënyrën si i trajton, për shembullin që jep në përfshirjen aktive të grave myslimane në jetën sociale, për zemërgjerësinë dhe bujarinë që tregon ndaj atyre në vështirësi.

Në ditët e sotme, kur jemi pengje të lajmeve të kronikës së errët, përcjellja e shembujve pozitivë, ngritja e platformave të përbashkëta të mendimit me idetë për të vlerësuar figurën dhe konsoliduar pozicionimin e gruas në shoqëri, janë një dozë oksigjeni të pastër, në mes të smogut, herë – herë mbytës, të shoqërive moderne.

Ju faleminderit!

SEANCA E PARË SHKENCORE

“Roli i gruas në edukimin e shoqërisë”

Moderator: **Bujar Spahiu** - Nënkyetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

1. Rahim Ombashi - Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane, KU Bedër, *“Gruaja shqiptare - Ajo që bëri të dëgjohej heshtja”*

2. Fatmah Aldahmani - Universiteti Mohammad al Khamis University, Abu Dabi

“Gruaja myslimane si model në shoqërinë e Emirateve të Bashkuara Arabe”

3. Liya Makhmutova - Presidente e Bashkimit të Grave Myslimane të Shteteve Balltike,

“Roli i gruas myslimane në ndryshimin e shoqërisë evropiane”

4. Dr. Gjergj Sinani - Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale,

“Figura e gruas në fetë e mëdha monoteiste”

5. Matilda Likaj - Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”

“Analizë sociologjike e fesë, edukimit dhe familjes: shembulli i rolit të gruas në Islam”

6. Lauren Luli - Nënkyetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,

“Gruaja myslimane, si promovuese e vlerave të Islamit në shoqëri”

Rahim Ombashi⁴ - Gruaja shqiptare - Ajo që bëri të dëgjohet heshtja

Tubimi Kombëtar Shkencor, me përmasa më të gjera, vjen si grishje e çastit për të komunikuar mes veti për gruan si simbolikë apo për simbolin grua, sepse ndihet nevoja të kuptohet misteri ndërfaqor sipas besimit islam, përcjellë dhe në jetën fizike, ku roli i saj është vendimtar. Faktet e shumta dëshmojnë për jetësimin e rolit të gruas në aspekte të shumta të realitetit bashkëkohor shqiptar.

Jetoj prej shumë kohësh larg vendlindjes, por atë e kam me vete, sepse siç thotë Henri Longfellow: “Ëndrrat e fëminisë fluturojnë në erë/ Kujtimet e rinisë në shpirt janë thellë.” Një prej tyre, po e nxjerr nga shpirti, sepse e kërkon tema e sotme. Nëna e ndjerë vazhdonte e bënte paqësisht punët e shtëpisë, ndërkohë që këmbana e Shën Gjergjit jehonte gjithë hijeshi. Buzët e saj mbledheshin për të formuar bashkëtingëlloren e parë ‘b’ të Sures *Al Fatiha*, gjithçka mes një solemniteti pa zë.

Maksima e Aristotelit: *Heshtja është lavdia e gruas* vendos si themel fjalën ‘grua’, fjalë kyç që në shqip është sinonim me emrin ‘nuse’. Te studimi i Ismail Kadaresë *Autobiografia e popullit në vargje*, ajo fjalë merr kuptime të shumta semantike, por që në themel dëshmon aftësinë e saj për të sjellë në jetë pasardhës. Prej këtu fillon thellimi në zhbirimin e sqarimin e çështjes, i thellë dhe polisemik, që ha diskutim, sepse mund të shfrytëzohen si literaturë tri librat e shenjtë. Në *Kuran* është Surja 19 *Merjem*, mekase, me 98 vargje, ku rrëfëhet sesi ‘gruaja më e

⁴ Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane, Kolegji Universitar Bedër.

pastër e të gjitha kohëve’, ndonëse e virgjër, lindi profetin Isa (a.s.) për bijtë e Izraelit, Mesinë e vërtetë dhe të dërguarin e Allahut. Pranohet lutja e Zekirias për të pasur një pasardhës, por atij, ndonëse besimtar i devotshëm, iu duk i pabesueshëm njoftimi se do të bëhej me djalë atëherë, kur ai kishte hyrë në periudhën e pleqërisë së thellë.

Dhe me që krijimi është hyjnor, kuptohet besimi që i jepet nuses për të sjellë në jetë bekimin qiellor. Bashkë me detyrimet e tjera brenda familjes, më kryesori i gruas është të kujdeset për fëmijën-dhuratë, me tipare engjëlli. Biri që Merjemi solli në jetë që caktuar të ishte jo vetëm ‘i pastër’, por dhe do të bëhej ‘shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Qysh në djep ai hodhi poshtë paragjykimet dhe shpifjet e jobesimtarëve ndaj gruas së virtytshme, “Nuses së panusëruar” apo Havasë (Evës) së re. Duke lundruar në detin e jetës së përkohshme mësojmë që Isai në djep dëshmon se Allahu i ka dhënë *Ungjillin* dhe e ka bërë profet, ndërkohë që heshtja e saj plot dinjitet njëherazi reflektohet edhe te bashkëshorti:

22. Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët.

10. (Zekerija) tha: “O Zoti im, më jep ndonjë shenjë!” Ai tha: “Shenja jote do të jetë se nuk do të mund të flasësh me njerëzit për tri net, ndonëse do të jesh i shëndoshë.”

Jehona e këtij misteri të brendshëm reflektohet në folklor, si dhe në shembëllime të mirëfillta letrare. Te përmbledhja *Visaret e Kombit*, vëllimi I, nr. 3, 1937 është botuar një margaritar i lirikës sonë historike titulluar *Fryni era, u çil taraba*, që ka si heroinë një motër, e cila, kur kupton se i shoqi ia preu në besë dy vëllezërit, mallkimit të vëllait “- Ty mos t’leftë kurr djalë në votër.”, iu përgjigj me vetënëmjen: “- Mos m’leftë djalë e mos m’leftë çikë.”, që do të thotë se kishte mbetur besanike. Dhe dihet si shkoi e si

përfundoi ajo histori tragjike: *Ç'bani motra për Halilin?/ Preu të shojnë me gjith të birin;/ Vrau tre vetë e duel kaçkinë.*

Fakti historik i kthyer në varg kënge, dëshmon për kriteret e gjykimit prej zonje, ku besa e prerë duhet të marrë dënimin e duhur. Te një shkrim i revistës *Hylli i Dritës*, në vitin 1914, niveli i saj estetik ngrihej deri në shkallën sa të matej me një elegji të Ovidit, sepse asgjë nuk ishte kryer instiktivisht prej shkodranes, por sipas ndërgjegjes, kodit moral e etikës së trashëguar.

Në letërsinë e kultivuar ka jo pak figura të tilla. *Erveheja* e Muhamet Kyçyikut vë në qendër një simbol të virtytit dhe përkushtimit, duke sjellë përmes alfabetit arab të përshtatur për shqipen, personazhin e parë femër në letërsinë shqipe. Poema tregimtare u bë vepra më e përhapur gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, kurse figura e gruas bëhet personazhi i parë letrar në letërsinë shqipe.” (Hamiti, 2010)

Gjithçka në poemë endet rreth figurës së kësaj gruaje dinjitare, që shërben për të zhvilluar fabulën tregimtare, duke treguar se heroina vuan vetëm sepse është shembëllim virtyti dhe bukurie trupore. E shkruar rreth dy shekuj më parë, ajo këndohej në vatrat shqiptare dhe shërbente si model për vajzat që prisnin të bëheshin nuse: *Erveheja qe një grua,/ që s'kish shoqe n'atë ditë, / vajzë dhe si u martua, / posi hëna kur bën dritë.*

Një kulm vargëzimi oral e arrin te balada realiste me figurën e nënës, biri i së cilës po jep shpirt ‘përtej urës së Qabesë’: *Falë me shëndet nënësë / Të dy qetë e zez t'i shesë/ Të m'i bëjë nigjah së resë/*. Sepse ajo pak pasuri do t'i duhej për të rritur fëmijët. Kur duhej, ajo dorëzohej dervish, prandaj në Tiranë është nderuar me emrin *Dervish Hatixhe*, rruga ku ndodhet tyrbja që ajo çeli. Me të drejtë filozofi i madh kinez, Kong Fu Tzu ka vënë në dukje: “Shenjat dhe simbolet janë ato që e sundojnë dhe udhëheqin botën, e jo fjalët apo ligjet.”

Folklori, sidomos lirika historike, është mjaft pranë me veprat artistike, por gruaja që kupton kohën dhe jetësohet në të,

dëshmohet edhe në historinë tonë moderne. Naimi i ka caktuar detyrë lirikës që të të tërheqë zemrën. Këtë formë dhe mënyrë të pastrimit shpirtëror, ngritjes morale, ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm, me qëllim që të përftohet pajtimi i Zotit dhe lumturia e përhershme, Eqrem Çabej e veçon te fillimet poetike të poetit, kur thekson se ndjenja fetare e ndihmoi Naimin të forconte ndjenjën etike. (Ombashi, 2015:33) Para se ai të kontaktonte me klerikët e teqesë së Frashërit, këtë frymë mirësie ia kishte përcjellë e ëma, Emine Mirahori. Në vargun e poetit kombëtar ka ndikime nga disa kultura, por djepi e ndihmoi që të ngjitej aq larg sa të arrijë të vlerësohet: “Ai është frymë nga fryma jonë dhe gjak nga gjaku ynë.” (Bulo, 1999) Në zemrën e të riut vendosen virtytet dhe të metat, që, sipas Ernest Koliqit, formësohen në thelbin e origjinës, e cila është nën ndikimet e ardhura nga Lindja dhe Perëndimi:

“Njerëzit në Shqipëri ushtrojnë tre besime fetare që përfaqësojnë tre qytetnime të ndryshme. Këta faktorë tepër të ndryshëm nga njeri tjetri e me kontraste të theksueme, ndikojnë në zhvillimin kulturor të kombit, pikërisht sepse zbresin dhe përpunohen mbi të njajtën bazë të përbashkët të të njajtës origjinë dhe prandaj nuk e damtojnë por e pasunojnë letërsinë e kësaj baze. Frymëzimet e qytetnimeve të ndryshme që vijnë nga Lindja apo nga Perëndimi i japin ngjyrimet drite të trefishtë morisë së folklorit vendas dhe e fisnikërojnë dëshirën krijuese të shkrimtarëve tue e përsosun shijen.” (Koliqi, 1999)

Nënshkruesit e aktit të pavarësisë kombëtare si Ismail Qemali, Haxhi Vehbi Dibra, Imzot Nikollë Kaçorri, Luigi Gurakuqi, Pandeli Cale, Lef Nosi, Mehdi Frashëri gurët e themelit të ngrehinës së re i ngjizën me formulën ‘besime të lira në një shtet të lirë’, që përfshin edhe lirinë gjinore si edhe emancipimin e gruas. Laiciteti i bazuar mbi përfaqësimin e komuniteteve sipas parimit ‘pares inter pares’, u dëshmuar edhe në krijimin e qeverisë së Ismail Qemalit. Në këtë rrugë vijoi edhe Kongresi i Lushnjës,

ndërsa qeveria e Ahmet Zogollit duke forcuar natyrën laike të shtetit, vijoi reformat emancipuese, që sipas Tij do të përparonin dhe do të bashkonin popullin shqiptar. Nëna mbretëreshë, Sadie Toptani, filloi të luante rol përbashkues, sidomos me ndihmesën që jepte për shkollimin e vajzave, pa dallim besimi fetar. Portreti i saj dinjitoz u bë deri kopertinë e revistës *Minerva*. Në udhën e progresit ecën edhe motrat e mbretit, deri asokohe të vetëpërbashkuara, ndryshuan qëndrim nga koha e dasmës së princeshës Sanije në vitin 1936, që u bë publike. Më pas mbreti u dha pozicione zyrtare katër motrave të tij më të reja.

Princesha Sanije u emërua kryetare e *Kryqit të Kuq Shqiptar* në vitin 1928, sepse iu caktuan detyra brenda kujdesit shëndetësor. Në tetor të të njëjtit vit, mbreti zhbëri organizatat e të gjitha grave në Shqipëri duke i zëvendësuar ato me një organizatë të vetme, e emërtuar *Gruaja shqiptare*, që kishte kryetare po drejtuesen e institucionit të shëndetit. Në këtë atmosferë sociale, politika e qeverisë u dëshmuar radikale me Kodin Civil të vitit 1928, ku shprehej qartë se gratë kishin të drejta të barabarta në trashëgimi dhe divorc, shfuqizoheshin rregullat që detyronin për martesë, përfshi poligaminë, duke u dhënë grave të drejtën për arsimim dhe jetë profesionale. Organizata *Gruaja shqiptare* çeli degët lokale në 20 qytete, botoi gazetën e vet dhe mbështeti projekte të shumta në mbështetje të politikës së regjimit për gratë, kryesisht në lidhje me arsimimin, ndërkohë që problemet, duke filluar prej rrethinave të kryeqytetit, ishin të mëdha.

Fryma e krijuar në periudhën e ngjizjes së ndërgjegjes kombëtare, bëri që edhe letërsia artistike, përmes së cilës përcillen këshilla, të vërë në qendër gruan. Romani *Sikur të isha djalë* i Haki Stërmillit këshillonte që shoqëria shqiptare të merrte përgjegjësitë që i takonin, sepse dhunimi i vajzës, do të prekte karakterin e dinjitetin e gruas së ardhshme, të nënës. Në bisedat e përditshme filloi të bëhej e zakonshme një gjuhë e kujdesshme për

të ruajtur këto parime, që garantojnë paqen sociale, e cila nis në familje, që sipas mendimtarëve myslimanë është fole hyjnore.

Në folklorin oral dhe në veprat e romantizmit, sentimentalizmit, realizmit kritik që vijoi deri në vitin 1944, figura e gruas zonjë apo zonjë e rëndë vijoi të jetë në qendër. Në peridhën e sistemit totalitar, kur gjithçka u ngrit me përdhunë politike dhe ideologjike, u synua që nga zonjë e madhe apo heroinë letrare të kthehej në shoqe, duke iu larguar çdo ditë e më tepër modelit Merjem, e përzgjedhur për të bërë kujdestarinë mbi të shenjuarit. Propaganda se duhej barazi gjithkund, edhe te vlerat vetjake, u quajt drejtësi popullore. Nëna e fisme heshtte, ndërkohë që burri, vëllai, djali, nipi martirizohej. Shqipëria u përça në grupimin politik “Ne” dhe armikun e tij, grupimin “Ata”. Nëna, gruaja përsëri rrekej të edukonte bij të mëshirës, ndërkohë që propaganda me të gjitha mundësitë synonte të edukonte bij të urrejtjes së klasave. Le ta quajmë atë periudhë historike të nëmur: “epoka e të gjithëve kundër të gjithëve”, që la pasoja të rënda.

Rol parësor pas vitit 1990 lojti media e shtypur, e cila informon për gratë e veshura me heshtim. Shqiptarët mësuhan për Sabiha Kasimatin, maturanten e parë femër të Liceut Frances të Korçës, doktoren e shkencave të Universitetit të Torinos, që u dënua pa gjyq nga bashkatdhetarët e saj entuziastë të komunizmit. Ambasada Amerikane nis nga viti 2010 ta quajë *Çmimin për Gratë Guximshme* me emrin “Musine Kokalari”. Ambasadori amerikan John L. Withers shprehej se ‘figura e Kokalarit e ka mbushur me respekt për kontributin e dhënë në fushën e ideve politike dhe për modelin etik që krijoi në një kohë të vështirë për burra dhe njerëz të lirë dhe shumë herë më të vështirë për femrën’, që, sipas tij: “Nuk kanë fuqi të mbinatyrshme, por përfaqësojnë atë çka është e shkëlqyer, frymëzojnë të tjerë dhe kanë përkushtim me pasion ndaj sjelljes së ndryshimit brenda komuniteteve ku shërbejnë. 8 marsi është një ditë e caktuar për të nderuar nënat në Shqipëri dhe në mbarë botën si *Heroina të Përditshme*, që

zbulojnë shtigje të reja dhe kapërcejnë pengesa, ndërkohë që rendin drejt përparimit dhe begatisë për brezat që do të vijnë."

Musine Kokalari la pas veprat "Siç më thotë nëna plakë", botim i vitit 1939, më 1944 botoni "Rreth vatrës" dhe më 1945 "Sa u tund jeta". Si vepra postume të saj janë një përmbledhje e shkrimeve, artikujve, eseve dhe kujtimeve me titull "Si lindi Partia Demokratike" (2000), kurse në vitin 2004 i botohen 60 ese të sajat nën titullin "T'isha një lule".

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpalli në vitin 2006 Çmimin "Musine Kokalari" për gruan shkrimtare më të mirë të vitit, me synimin që të nxitë letërsinë e shkruar nga gratë, duke i dhënë këssoj një shtytje rolit të gruas në shoqëri, por vlerësimi nuk u dha, sepse konkursi nuk u bë kurrë.

Nuk arritën të bëheshin nëna, por dhuruan jetën dhe veprën e tyre moderne duke mbrojtur modelin e virtytit të trashëguar, në një kohë absurdi, që synonte të ndalonte modernen si tejkalim të bashkëkohësisë konvencionale.

Bibliografia

Bulo, Jorgo. (1999) *Tipologjia e lirikës së Naim Frashërit*, Tiranë.

Hamiti, Sabri. (2010) *Poetika shqipe*, Tiranë.

Koliqi, Ernest. (1999) *Kritikë dhe estetikë*, Tiranë.

Përgatiti Stefan Çapaliku.

Ombashi, Rahim. (2015) *Tesavvuf dhe palimpsest*, Tiranë.

Gjergj Sinani⁵ - Burri dhe gruaja në fetë monoteiste

Abstrakt

Vendi që zë burri dhe gruaja në fetë monoteiste, por edhe te fetë në përgjithësi, na paraqet një larmishmëri, e cila ka përcaktuar edhe diskutimet e ndryshme teologjike, filozofike dhe morale. Për më tepër, kjo çështje nuk mund të merret e shkëputur nga problemi i origjinës së njeriut. Në lidhje me këtë problem të fundit, përballë larmisë së diskutimeve, është e vështirë që të përcaktohet një tipologji e miteve mbi lindjen e qenies njerëzore.

Një njohje e mirë e këtyre tematikave duhet t'i shërbejë edhe kuptimit të debatit të sotëm politiko-fetar në lidhje me shumë fenomene që, jo rrallë, i bëjnë një përdorim abuziv shkrimeve të shenjta, duke e rënduar akoma më shumë ekzistencën njerëzore.

Duhet theksuar se kuptimi i teksteve të shenjta kërkon edhe një vështrim hermeneutik dhe këtu bëhet fjalë jo vetëm për një hermeneutikë të librave të shenjtë, por edhe të një hermeneutike filozofike.

“Nuk ka paqe ndërmjet kombeve, pa paqe ndërmjet feve. Nuk ka paqe ndërmjet feve, pa dialog ndërmjet feve. Nuk ka dialog ndërmjet feve, pa një kërkim në bazat e feve.” Hans Küng

Vendi që zë burri dhe gruaja në fetë monoteiste, por edhe te fetë në përgjithësi, na paraqet një larmishmëri, e cila ka përcaktuar edhe diskutimet e ndryshme teologjike, filozofike dhe morale. Për më tepër, kjo çështje nuk mund të merret e shkëputur

⁵ Prof. Dr. Gjergj Sinani, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Filozofisë.

nga problemi i origjinës së njeriut. Në lidhje me këtë problem të fundit, përballë larmisë së diskutimeve, është e vështirë që të përcaktohet një tipologji e miteve mbi lindjen e qenies njerëzore. Megjithatë, nga diskutimet e shumta mund të përcaktohen disa akse për të parë dallimet ndërmjet qasjeve të ndryshme fetare mbi origjinën e njeriut. Duhet theksuar se çështja e origjinës është trajtuar gjithmonë përmes një gjuhe simbolike, atë të mitit të origjinës. Madje edhe fetë që kanë vlerësuar kohësinë historike, si judaizmi ose krishterimi, i bëjnë thirrje një diskutimi mitik, kur bëhet fjalë për origjinën e njeriut. Ky lloj diskutimi është i domosdoshëm, pasi ai mund të shprehë një realitet, të cilin, format e tjera shprehëse, nuk arrijnë ta paraqesin, domethënë një realitet shumë më të hershëm se njeriu, prej nga buron edhe një e vërtetë ontologjike ose morale. Kështu, për sa i takon origjinave, të gjitha traditat fetare i drejtohen domosdoshmërisht mitit ose një gjuhe simbolike, ose ato nuk shprehen mbi këtë çështje. Disa fe, si budizmi, qëndrojnë vendosmërisht në rrugën e dytë. Fetë e tjera na japin tregime mitike, që tregojnë origjinën e njeriut, të popullit, ose të tribusë.

Nisur nga studimet e Claude Levi-Straus, Levi-Bruhl, Henri Dumezil, Mircea Eliade, etj., mund të paraqesim dy tipa të mëdha mitesh të origjinës së njeriut: mite që i bëjnë thirrje një zoti krijues dhe mitet, që flasin për lindjen spontane të njeriut. Të parat, që janë edhe më të shumtat, i gjejmë edhe te tri fetë e mëdha monoteiste, si dhe te shumë fe afrikane ose ameridiene. Të dytat i përkasin feve lindore, ku hasen edhe mite kreacioniste, ku paraardhësit kanë dalë nga toka. Mitet e lindjes së qenies njerëzore janë edhe tregues të vendit dhe funksionit që fetë e ndryshme i japin rolit të njeriut në univers. Në mendimin kinez, që përgjithësisht nuk është kreacionist, njeriu krijohet sipas imazhit të universit, që e përmbledh dhe formon, me qiellin dhe tokën, një triadë që mban botën. Atëherë, funksioni i tij thelbësor është që të mbajë me drejtësi rolin e tij me qëllim që të mbahet rendi kozmik.

Për popujt e Mesopotamisë, njerëzimi u krijua nga perënditë me qëllim për t'i përdorur ata dhe për t'i lehtësuar nga puna e madhe për mbajtjen e botës. Kjo prirje drejtuese, e punëtorit dhe e shërbëtorit të perëndive, tregon edhe për një lloj pesimizmi të mendimit fetar të popujve të Mesopotamisë. Ndërsa hebrenjtë, e bënë njeriun – i krijuar sipas imazhit të një Zoti unik dhe jo si shërbëtor i Zotit – një bir, një partner të Zotit në vazhdimin e procesit të krijimit të botës.

Krijimi është një nga idetë themelore të *Zanafillës* të Bibla. *Zanafilla* vendos edhe një dallim radikal ndërmjet një hyjnie Krijues dhe një krijese, bir i një Zoti unik, por edhe i ndarë nga Ai nga një hon i pakapërcyeshëm, që e detyron të flasë për këtë marrëdhënie “atërore” vetëm me terma metaforikë. Në fund të krijimit të universit vendoset krijimi i qenies njerëzore: “Hyji krijoi njeriun në përngjasimin e vet, e krijoi në përngjasimin e Hyjit; i krijoi mashkull dhe femër” (*Zanafilla*, 1,27).

Burri dhe gruaja te judaizmi: “i krijoi mashkull dhe femër”

Edhe pse mendimi talmudik shkon më përpara, duke i bërë gratë një popull në vetvete, për judaizmin burri dhe gruaja janë pjesë jo vetëm e një humanizmi, por edhe e një qenieje. Dy tregimet e krijimit të njeriut ndryshojnë në dukje mbi modalitetet e kësaj marrëdhënieje. Në një drejtim, adami fillestar (*adam* në judaizëm është një term i përgjithshëm që cilëson si burrin edhe gruan). Ky është edhe kuptimi i shprehjes të *Zanafilla*: “i krijoi mashkull dhe femër”, ishte mashkull dhe femër në origjinë. Më pas, ka ndodhur ndarja e kësaj qenieje unike. Mbi bazën e tekstit të *Zanafillës* (1, 27), Talmudi imagjiron në origjinë një lloj qenieje siameze me dy pamje. Të dy qeniet ishin të bashkuara shpinë më shpinë në një qenie, njëra anë ishte mashkullore dhe tjetra femërore dhe nuk mund të shiheshin ballë për ballë. Prandaj, Zoti i ndau që ata të bashkoheshin në dialog. Ky koncepton

(koncepcion), gati mitik, ka një rëndësi filozofike dhe etike. Ky konceptcion do të tregojë se, në parim, uniteti duhet të kryesojë atë të dallimit të burrit dhe të gruas. Sipas studimeve talmudike, rrënja e fjalës *havah*, Eva, cilëson pikërisht bashkëbisedimin, dialogun, por teksti biblik e përaftron me fjalën *hayim*, “jeta”: Eva është “nëna e të gjithë të gjallëve” [“Njeriu e quajti gruan e vet Evë, sepse ajo është nëna e të gjithë të gjallëve” (*Zanafilla*, 3.20)]. Kjo ndarje e mashkullores dhe femërores formulohet më qartë në tregimin e dytë të krijimit, me skenën e famshme të “brinjës”, që u mor nga *adami* për të krijuar Evën. Vetë termi hebraik është ambivalent (mund të tregojë “brinjën”, ose “ijën”) dhe komentari rabinik nuk nguron të bëjë një përafrim me anët e çadrës në shkretëtirë, duke lënë të nënkuptuar se *adami* mashkullor dhe femëror është imazh i çadrës, të pajisur me “anë”, që ka prezencën hyjnore.

Këto dy tregime mbi dallimin e sekseve tregojnë edhe se si ka evoluar konceptioni mbi gruan te judaizmi ndërmjet vlerësimit miklues dhe një vizioni zhvlerësues. Kështu, në *Midrach* gjejmë pohime zhvlerësuese për gruan: “Unë nuk do të të krijoj nga kafka (e Adamit) me qëllim që ajo të mos jetë mendjemadhe, as nga syri me qëllim që të mos jetë e ndërlikuar... as duke u nisur nga zemra, sepse ajo do të ishte xheloze... por duke u nisur nga një pjesë e trupit që është e fshehur, duke u nisur nga gjymtyra më modeste” dhe për secilën nga gjymtyrët që Ai krijoi, Ai i tha gruas: “Ji e turpshme, ji e turpshme!”, e megjithatë “ajo nuk ka qenë” (*Midrach Rabba Genëse*). Disa tekste nga *Midrach* japin idenë se gruaja u krijua në të njëjtën kohë me Satanin. Duhet theksuar se cilësitë negative për gruan (llupëse, e pasjellshme, përtace, xheloze, e lëkundshme, shpifarake, hajdute dhe qejfleshë), alternohen edhe me cilësi pozitive (ajo ka një besim më të madh se burrat, aftësi më të mëdha dalluese dhe është më e ndjeshme). Por gjithashtu, gruaja është për burrin një ngasëse (zëri i një gruaje, flokët dhe këmbët e saj janë erotike).

Megjithatë, judaizmi nuk ka përpunuar një teori “të mëkatit fillestar”, ku gruaja ishte në origjinë të këtij mëkati. Sigurisht, akti i Evës futi çrregullsinë në projektin hyjnor për njeriun (parajsa): shkelja dhe mundësia e të keqes lindën, përmes historisë – që fillon pikërisht këtu – me çiftin njerëzor dhe këtu shihej edhe mundësia për ta ndrequr gabimin përmes akteve të njerëzve. “Sepse, nëse vepron mirë a nuk do ta mbash kryet lart? E po s’veprove mirë, në pritë te dera e ke mëkatin; ai të lakmon ty; porse ti duhet ta mbizotërosh” (*Zanafilla*, 4.7). Për më tepër, teksti biblik pohon pa ekuivok mëshirën e Zotit. Psallmi 103 shpall qartazi: “Sikurse babai ka dhembje për fëmijët e vet, ashtu Zoti ka dhembje për ata që e druajnë. Sepse mirë e di si jemi të përbërë, s’e harron se ne jemi pluhur. Njeriu! Ditët e tija janë porsì bari; porsì lulja e fushës lulëzon, sa e prek era e më s’është, më s’e kujton as vendi i vet” (*Psallme*, 13-16). Por, në të njëjtën kohë, Zoti shpall edhe faljen e tij: “Zoti i tha Moisiut: Po ia fal në fjalën tënde” (*Numrat*, 14.20). Te libri i Jeremisë shpallet falja: “Unë do t’i pastroj nga çdo fajësi, me të cilën mëkatuan kundër meje, do të kem dhimbje për të gjitha fajet e tyre, me të cilat më fyen dhe më përbuzën” (*Jeremi*, 33.8).

Vlerat femërore

Kështu, te judaizmi feminiteti dhe seksualiteti nuk janë parë kurrë si diçka e keqe, e ulët. Përkundrazi, ato u bënë një fushë e privilegjuar që provonte realizimin e krijimit. Një burrë pa një grua nënkuptonte një jetë pa kënaqësi, por edhe pa bekim, madje nuk mund të konsiderohej edhe si njeri. Madje, burri kishte më shumë nevojë që të martohej sesa gruaja. Sigurisht, përmbajtja i rëndon shumë burrit, por ama ishte martesë që për të është një akt shenjtërimi para Zotit, akt i spiritualizimit të instinkteve. Gjithashtu, martesë bën të mundur vazhdimësinë e një familjeje që do të përjetësojë *Torën*. Kjo domosdoshmëri për martesën dhe, për pasojë, dënimi i beqarisë dhe i jetës monastike, shpjegohen

nën dritën e tregimit të krijimit. Në qoftë se *Adami* u krijua burrë dhe grua, perfeksioni, pas ndarjes së tyre, që ka si qëllim dialogun, qëndron në takimin dhe bashkimin e tyre. Kështu, uniteti hyjnor, «imazhi» i të cilit iu premtua njeriut, në qoftë se ai e meriton, do të vazhdonte i thjeshtëzuar në jetën e krijesës.

Edhe te libri *Zohar*, shikon te vetë hyjnia modelin e çiftit, të bashkimit të femërores dhe mashkullores. Kjo metaforë shpjegohet me doktrinën e dhjetë emanacioneve (*sefirot*) hyjnore, përmes të cilave Zoti ka krijuar botën dhe sidomos në doktrinën e *Shekhina*-s (Prezenca hyjnore), figurë femërore që tregon prezencën e Zotit midis njerëzve. Sipas judaizmit ana “femërore” e Hyjnisë është ana e «majtë», ana e gjykimit dhe ashpërsisë, ndërkohë që ana e djathtë është mashkullore, ana e hirit hyjnor, por asnjë anë nuk mund të ndahet nga tjetra, pasi kjo rrezikon shkatërrimin e botës. Bota mbijeton në sajë të marrëveshjes ndërmjet këtyre dy anëve. Madje, *Talmudi* shkon më tej kur pohon se Izraeli u shpëtua nga Egjipti në sajë të grave të drejta. Madje ka komente rabinike ku theksojnë se *Tora* iu dha në fillim grave të Izraelit dhe kjo identifikohet me shprehjen «Shtëpia e Jakobit» (*Libri i daljes*, 19.3). Por, ka edhe mjeshtër të tjerë të Talmudit, të cilët nuk e këshillonin mësimin e *Torës* nga gratë. Kështu, traktati i *Sota*-s thekson se kush i mëson vajzës së vet *Torën*, i mëson epshndjelljen.

Ka pasur shembuj të grave mjeshtre të Talmudit gjatë historisë, por, si rregull i përgjithshëm, studimi i Ligjit nuk është një detyrim për gratë. Në ritualin e përditshëm, burri reciton një lutje ku falënderon Zotin që nuk e ka bërë grua. Sot kjo lutje ka krijuar shumë diskutime dhe kundërshtime. Në rastin më të mirë të interpretimeve, burri falënderon Zotin, që i ka dhënë mundësinë që të praktikojë më shumë urdhëresa se gruaja. Gruaja, nga ana e saj, falënderon Zotin që e ka bërë sipas vullnetit të Tij. Gjithsesi ato i janë nënshtruar urdhëresave, që lidhen me kohën. Për më tepër, në *Librin e Zanafillës* hasim figura të tilla, si ato të Sarës

dhe Rebekës, të cilat dinë në mënyrë profetike, se cili nga djemtë e tyre duhej të merrte të drejtën e më të madhit. Kështu sipas judaizmit ka pasur edhe profetesha në kohën biblike dhe Debora ishte “gjyqtare”, drejtuese politike e konfederatës tribale të Izraelit.

Funksioni i lidhjes martesore

Te judaizmi bashkimi i burrit dhe gruas ka pasur një rol thelbësor: përmes saj kalonte eksperiencia dhe prova e aleancës, e lidhjes që mund të lidhte, pas krijimit, Zotin, i cili tërhiqej dhe ndahej nga qenia njerëzore që vinte në jetë. Kështu, marrëdhënia martesore, në diskursin profetik bëhej metafora kryesore e marrëdhënies së njeriut dhe Zotit dhe kriteri i besnikërisë së aleancës. Gruaja jo besnike është vetë imazhi i pabesnikërisë së Izraelit (*Libri Ezekielit*, 23; *Oze*, 2.4-23). Edhe *Kënga e këngëve* i drejtohet metaforës së marrëdhënies dashurore për të përshkruar marrëdhënien e Izraelit dhe të Hyjnisë.

Martesa, si një modalitet i aleancës, bazohet juridikisht mbi një kontratë që i siguron disa të drejta gruas. Para së gjithash, meqenëse bëhet fjalë për një aleancë, martesa mund edhe të prishet. Pra, divorci ekziston te judaizmi. Sigurisht, burri ka një vend të privilegjuar⁶, por në disa rrethana (dështimi në nivelin e detyrimeve, pabesnikëria, egërsia mendore, sëmundje të rrezikshme, profesion i përbuzshëm, ndalimi i gruas që të lëvizë

6 Bibla, Ligji i përtërirë, 24.1-4. : «Kur dikush martohet dhe jeton me të si grua, por pastaj ajo nuk i pëlqen më, sepse ka gjetur diçka të pahijshme në të, i shkruan vërtetimin e lëshimit, ia jep në dorë dhe e dëbon prej shtëpisë, dhe ajo si të ketë dalë prej tij, martohet me një tjetër, por edhe atij nuk i pëlqen dhe i jep edhe ai dëftesën e ndarjes dhe e hedh prej shtëpisë së vet, ose ndoshta vdes, burri i parë nuk mund ta marrë atë për grua, sepse ajo ka qenë përdhosur. Kjo do të ishte një poshtërsi në sy të Zotit. Ruaju se bën të mëkatojë toka që Zoti, Hyji yt, do të ta japë për pronë.»

lirshëm), gjyqi rabinik mund ta detyrojë burrin për t'i dhënë gruas së tij aktin e divorcit edhe nëse ai kundërshton.

Një nga objektivat e martesës është lindja e fëmijëve, por edhe lumturia sensuale ka rëndësi dhe është unike. Në judaizëm ekziston një literaturë e gjerë, si kabaliste dhe talmudike, mbi rëndësinë e lumturisë sensuale femërore në marrëdhëniet martesore. *Talmudi* jep një listë situatash ku tregohet se kur akti sensual martesor, pra dhe i ligjshëm, nuk është në përputhje me ligjin. Detajet e këtyre situatave tregojnë rastet ku respekti i personit femëror, qëllimi i dashurisë së burrit dhe vullneti i gruas nuk respektohen dhe e bëjnë aktin të pavlefshëm, edhe pse është një akt martesor. Madje, në Mesjetë kishte shumë traktate që përcaktonin kushtet psikologjike, dhe jo vetëm juridike, në të cilat marrëdhënia seksuale është e vlefshme. Gjithashtu, burri ka ndaj gruas së tij detyrime të përcaktuara në mënyrë precize: ushqimin, strehimin, veshjen, kënaqësinë seksuale, kujdesin mjekësor dhe pagimin e një shume në rast të rrëmbimit. *Talmudi* i rekomandon burrit që ta trajtojë gruan dhe fëmijët e tij më mirë se veten.

Poligamia ishte e lejuar në kohët biblike, por modeli adamik dhe uniteti i Zotit supozonin një monogami në parim. Poligamia dhe konkubinazhi u zhdukën gjatë periudhës së Tempullit të dytë (shek. IV para Krishtit – shek. I pas Krishtit). Në qoftë se rabinët e *Talmudit* e lejonin poligaminë ata vetë ishin monogamë. Në vitin 1000 poligamia u ndalua me dekret të veçantë nga rabini Gershom i Majnit. Ky dekret u pranua nga të gjitha bashkësitë hebreje, edhe pse poligamia në Lindje vazhdoi deri vonë. Gjatë Mesjetës, rabinët e përmirësuan statusin e gruas, por juridikisht ky status mbeti më inferior se ai i burrit. Megjithatë, gjatë historisë, statusi i gruas hebreje erdhi duke u përmirësuar.

Burri dhe gruaja te krishterimi

Gjatë një historie dymijëvjeçare, krishterimi nuk ka reshtur së trajtuari problemin e burrit dhe të gruas, shoqëruar nga një tension ndërmjet teksteve të Shkrimit të shenjtë, që pohonte barazinë absolute të qenieve njerëzore pa dallim race dhe seksi dhe peshës të strukturave sociale dhe kulturore të antikitetit pagan dhe hebre, që ekzistojnë pothuajse deri në ditët tona. Në fakt, përjashtimi pothuajse tërësor i grave nga jeta publike, që ishte rregull në shoqëritë antike dhe mesjetare, me përjashtime shumë të rralla, kaloi edhe në strukturat ekleziastike. Marrëdhënia burrë – grua, si në jetën private dhe atë juridike e kanonike, për një kohë të gjatë u konceptua sipas modelit të nënshtrimit të gruas, për shkak të inferioritetit «natyror» të kushtit të saj. Shoqëritë mesdhetare antike i njihnin gruas vetëm një funksion social, funksionin e nënës për të siguruar vazhdimësinë e familjes, asaj i mohohej jo vetëm pjesëmarrja në jetën publike e civile, por edhe në jetën fetare. Gruaja shikohej si objekt kënaqësie ose në rastin e martesës një e mirë e përkohshme.

Megjithatë, tregimet e Biblës mbi zanafillën (*Zanafilla*, 1.26-28, dhe 2.21-24) flasin për një qenie njerëzore të krijuar sipas “imazhit të Zotit”, si një qenie unike, burri dhe gruaja, të dy të quajtur njeri: «Hyji e krijoi njeriun, e krijoi në përngjashmërinë e Hyjit. E krijoi njërin mashkull, ndërsa tjetrin femër dhe i bekoj. Ditën kur qenë krijuar u dha emrin “Njeri”.» (*Zanafilla*, 5.1,2). Pikërisht kësaj qenieje unike iu besua drejtimi i krijimit, që përfshin shtimin dhe riprodhimin. Kjo marrëdhënie mashkull – femër shihej si pjesë thelbësore e qenies njerëzore, në marrëdhënie me Zotin e vetëm Krijues. Ndërkaq, formimi i Evës nga brinja e Adamit (*Zanafilla*, 2.21-22) ka qenë perceptuar si vendosja e një marrëdhënieje varësie të Evës ndaj Adamit. Kështu, krijimi i gruas u paraqit si një ngjarje dytësore, që ishte një shenjë që tregonte inferioritetin e gruas, e cila duhej t’i bindej burrit. Duke deduktuar në kohë përparësinë e Adamit, kjo ishte

provë e superioritetit të tij, për pasojë, e lindur nga brinja e Adamit, gruaja si e tillë, nuk mund të ishte “imazh i Zotit”. Ajo u krijua për t’iu nënshtruar sundimit mashkullor.

Jezusi, Pali dhe roli i gruas

Jezusi nuk hezitoi t’i sfidonte zakonet e kohës së tij që e vendosnin gruan në një gjendje inferioriteti. Në një kohë që ai pohonte parapëlqimin e tij për të varfrit, ai shkeli ndalesat ligjore për t’ia drejtuar mesazhin e tij edhe grave, deri në atë pikë sa armiqtë e tij e akuzuan si të papastër dhe skandaloze sjelljen e tij. Ai i pranonte edhe gratë në rrethin e dishepujve, ai u fliste personalisht, hynte në shtëpitë e tyre dhe shërbehej prej tyre (Maria dhe Marta te *Luka*, 10.38). Tekstet e shenjta na japin shumë episode që na tregojnë lirinë e Jezusit përballë një situatë të tillë socio-kulturore. Aluzionet mbi tre Maritë, Maria, nëna e Jezusit, Maria e Bethanisë dhe Maria e Magdalasë, dëshmojnë për rolin që ato zënë në jetën publike të Jezusit. Këto «gra shenjto», më guximtare se disa apostuj, e shoqëruan Jezusin deri në ekzekutimin e tij në kryq. Ato shpallën të parat besimin te ringjallja (*Gjoni*, 2.4, 19.26, 20.15, etj.). Qëndrimi i Jezusit ndaj tyre ka si qëllim që të tregojë dinjitetin e barabartë të gruas ndaj burrit. Kështu, ai vendosi parimin e një revolucionit të vërtetë moral, realizimi i të cilit që i pamundur, pasi një ndryshim i tillë kulturor në atë kohë ishte i pamundur dhe i pamendueshëm. Në fakt, kultura hebreje dhe ajo pagane ndikuan në mënyrë të tillë te krishterimi, sa u detyrua të përshtaste qëndrimet dhe gjykimet në lidhje me gratë si reduktimin e gruas në funksionin e riprodhimit, ose të një objekti dëshire. Kundër gruas qëndronin përbuzja e filozofive spiritualiste, morali stoik si dhe etika hebreje. Edhe pse prezente në darkën e fundit, gratë nuk u pranuan si apostuj: «Të gjithë këta ishin të përqendruar prore së bashku në uratë me disa gra, me Marinë, Nënë e Jezusit, dhe me vëllezërit e tij» (*Veprat e Apostujve*, 1.14). Megjithatë, Jezusi kurrë nuk kërkoi që, ashtu

si kërkonte ligji hebre, gratë të përjashtoheshin nga shërbimi për Zotin.

Roli i shën Palit, jo vetëm ndaj grave, por edhe nëpërpunimin e një refleksioni teologjik, ka qenë mjaft i madh, prandaj ka rëndësi ky ndikim. Shën Pali u linte një vend të rëndësishëm grave në përhapjen e *Ungjillit* jashtë Palestinës. Në këtë zgjerim të parë misionar, gratë ndodheshin në një pozicion të barabartë me burrat. Pali, duke u shkruar Galatasve, nuk hezitonte të shpallte se “Nuk ka më: hebre-grek! Nuk ka më: skllav-i lirë! Nuk ka më: mashkull-femër! Të gjithë janë Një në Krishtin Jezus!” (*Letër drejtuar Galatasve*, 3.28). Kjo do të thotë se të gjitha dallimet racore, statusit juridik dhe dallimet ndërmjet sekseve binin për shkak të unitetit të besimit. Në qoftë se nuk ka më dallim ndërmjet burrit dhe gruas, kjo nuk ishte rezultat i heqjes së dallimeve seksuale, siç mendonin atëherë gnostikët, por sepse barazia e tyre bazohej në të njëjtin besim, në të njëjtin pagëzim, në të njëjtin shpëtim. Por jeta e përditshme, në kohën e Palit, na paraqiste një pamje tjetër dhe, për më tepër, ai duhej të mbante parasysh edhe rregullat hebreje, që ishin tepër të fuqishme. Kjo duket në Letrën e parë drejtuar Korintianëve: “Gratë le të heshtojnë në Mbledhje: nuk është e lejueshme të flasim; por sikurse edhe Ligji e thotë, le të dëgjojnë. Po dëshiruan të mësojnë ndonjë send, le t’i pyesin burrat e vet në shtëpi, sepse nuk i ka hije gruas të flasë në Mbledhje” (*Letra e parë drejtuar Korintasve*, 34.35). Prej kësaj kemi ambiguitetin e pozicionit të tij, i cili, në të njëjtën kohë, pohon barazinë e gruas dhe varësinë nga burri. Parë në kontekstin historik, kjo skemë patriarkale e nënshtrimit të burrit ndaj gruas, synonte të zbuste tensionin ndërmjet komuniteteve të para të krishtera, shoqërisë hebreje dhe shoqërive pagane, të cilat u përballën me problemin e konvertimit të shpejtë të grave dhe skllavëve në fenë e re. Pavarësisht këtij fakti, ndikimi i Palit do të ishte përcaktues në marrëdhëniet ndërmjet krishterimit dhe gruas. Ai ka justifikuar segregacionin femëror

dhe, në njëfarë mase, mendimi i tij përbën një nga bazat e antifeminizmit të krishterë, sepse, duke e konceptuar gruan si trup të burrit dhe burri është koka, kryetari, ndaj të cilit duhej nënshtruar dhe duke e bërë këtë marrëdhënie alegori të marrëdhënieve ndërmjet Kishës dhe Krishtit, Pali shenjtëroi një situatë antifeministe, por që ishte vetëm kulturore⁷.

Sigurisht, origjinaliteti i krishterë, pavarësisht kontradiktave, ka qenë që të pohonte, bashkë me Palin, përparësinë e virgjërisë ndaj martesës. Vetëm një virgjëri e konsakruar mund të përfaqësonte një ideal të përsosmërisë engjëjlore, në të njëjtën kohë që kjo përbënte një mënyrë për ta çliruar gruan nga sundimi mashkullor. Por, duhet theksuar se zhvillimi i gruas konceptohej në të hequrit dorë nga ajo që përbën veçorinë e saj. Me fjalë të tjera, ndërsa te paganët gruaja përcaktohej përmes seksit të saj dhe funksionit të saj si nënë, te krishterimi ajo duhej të pushonte së qeni grua për të shkuar drejt perfeksionit të saj.

7 Shën Pali: «Nënshtrohuni njeri-tjetrit në frikën e Krishtit! Gratë le t'u binden burrave të vet sikurse Zotit. Sepse burri është kryet e gruas sikurse edhe Krishti është kryet e Kishës – Ai shëlbuesi i trupit. Pra, sikurse Kisha i nënshtrohet Krishtit, ashtu edhe gratë le t'u binden burrave të vet në gjithçka. Ju, o burra, doni gratë tuaja sikurse Krishti e ka dashur Kishën dhe e ka flijuar vetveten për të për ta bërë të shenjtë duke e pastruar me lamje dhe me fjalë, që të bënte gati për vete një Kishë të lavdishme, të panjollë, të parrudhë, pa ndonjë send si këto, të jetë e shenjtë dhe e patëmetë. Në këtë mënyrë duhet që edhe burrat t'i duan gratë e veta - porsi trupin e vet. Kush e do gruan e vet, do vetveten. Sepse askurrë askush nuk e urren trupin e vet, por e ushqen dhe kujdeset për të, porsi Krishti për Kishën. Sepse jemi gjymtyrët e Trupit të tij. *Për këtë arsye njeriu do ta lerë babën dhe nënën e do të jetojë bashkë me gruan e vet e të dy do të jenë një trup i vetëm.* Ky është mister i madh: e kam fjalën në lidhjen e Krishtit me Kishën. Shkurt, për sa u përket juve, secili prej jush le ta dojë gruan e vet porsi vetveten e gruaja le ta nderojë burrin e vet» (*Letra drejtuar Efesianëve*, 5.21-33).

Burri dhe gruaja nga Agustini në epokën moderne

Edhe antropologjia që zhvilloi Shën Agustini nuk bëri gjë tjetër veçse përforcoi këtë ambiguitet ndërmjet barazisë dhe varësisë. Për Shën Agustinin, nën ndikimin edhe të një rinie manikeane, te çdo qenie njerëzore duhet dalluar trupi i tij seksual dhe shpirti i tij, që është i aftë për inteligjencë dhe arsye. Kështu, te mashkulli nuk ka dualitet ndërmjet këtyre dy elementeve, por te gruaja, seksi i saj nuk pasqyron shpirtin e saj. Burri është plotësisht imazh i Zotit në tërë qenien e tij, trup dhe shpirt; gruaja është imazh i Zotit vetëm nga shpirti i saj, pasi feminiteti i saj është një pengesë në ushtrimin e arsyes. Kjo do të thotë se inferioriteti i saj është “natyror” dhe kjo është arsyeja pse i lejohej të ketë vetëm fëmijë. Tetë shekuj më pas, Thoma Akuini, duke rimarrë të njëjtën teori, pohonte se gruaja ishte krijuar më e papërsosur se burri, të cilit ajo duhet t’i nënshtrohet “sepse te burri, në mënyrë të natyrshme, shfaqet gjithnjë e më shumë qartësia e arsyes” (*Somme théologique I*, 92.1 dhe 2). Ky vizion totalisht negativ për gruan gjeti pasqyrim edhe në të drejtën kanonike.

Duke ndarë të njëjtin koncept të varësisë sociale dhe juridike që shoqëria i impononte gruas, teologët e krishterë theksonin se një situatë e tillë ishte pjesë përbërëse e krijimit, pra ishte një fakt natyror, prandaj edhe ishte i justifikueshëm nga pikëpamja teologjike. Kjo bazohej edhe te *Zanafilla*, i ndikuar edhe nga judaizmi rabinik, që e kalonte përgjegjësinë kryesore të gabimit fillestar tek Eva, gruaja e parë dhe të gjitha gratë më pas, bëheshin pjesë e së njëjtës fajësi: “Dhe nuk qe gënjyer Adami, por gruaja e gënjyer e theu urdhrin. Dhe do të shëlbohet duke lindur fëmijë, në qoftë se qëndron me urti në fe, në dashuri dhe në shenjtëri” (*Letra e parë drejtuar Timotheut*, 2.14-15). Kështu u përpunua ideja se gruaja, e paaftë për shkak të dobësisë natyrore t’i rezistonte tundimit të parë, ajo do të ishte gjithmonë joshëse dhe ndërmjetëse mes burrit dhe demonit. Kështu, kuptohet

konceptioni prej gati një mijë vjetësh, i tre gjendjeve jetësore që i ofroheshin gruas: virgjëria që është gjendja më e përsosur dhe më e lartësuar nga një literaturë e tërë edhe pse, në fakt, ishte mohim i veçorisë së gruas; gjendja e vejushës, pastaj në vend të tretë vinte martesë, e konceptuar si një kompromis i domosdoshëm me mëkatën e mishit dhe se vetëm lindja mund ta falë.

Mosnjohja e mekanizmave të seksualitetit deri nga fundi i shekullit XVII, si dhe ekzistencës së kromosomeve, që u njohën vetëm nga fundi i shekullit XIX, siguroi mbijetesën e idesë se vetëm burri luante një rol aktiv në vazhdimësinë e gjeneratave. Gruaja ishte thjesht një marrëse pasive e farës mashkullore, ajo shikohej thjesht si një “ushqyese e fekondimit”. Në një perspektivë të tillë dallimi seksual ndërmjet burrit dhe gruas ngrihej në rangun e një natyre biologjike dhe psikologjike nga ku detyrimisht buronte edhe pabarazia ndërmjet sekseve. Përdorimi abuziv i nocionit të natyrës çoi në mendimin se, ashtu si në shoqërinë civile, burri pranohej si qenia e vetme e plotësuar, po ashtu ai përfaqësonte tipin ideal të duhur dhe të realizuar nga Zoti Krijues.

Sigurisht evolucioni feminist bëri që të ndryshonte edhe qëndrimi i kishës së krishterë ndaj gruas. Duke marrë parasysh modernitetin, enciklika *Pacem in terris* e papës Gjoni XXIII (1963) dhe enciklikave të tjera më pas, si dhe punimet e Koncilit Vatikan II, kanë pranuar dinjitetin e barabartë ndërmjet burrit dhe gruas. Sigurisht paraqitja e këtij evolucioni pozitiv do të kërkonte një punim të veçantë.

Burri dhe gruaja në Islam

Islami solli një vizion të ri për komunitetin e individin dhe pati pasoja në transformimin e shoqërisë. Bindjet e reja fetare të përbashkëta, ritet e reja dhe normat etike bashkuan në një shoqëri të re arabe familjet, klanet dhe tributë, që më përpara kishin qenë të fragmentarizuara dhe shpesh në një antagonizëm të fortë

ndërmjet tyre. Megjithatë, këto struktura nuk u zhdukën, por u riinterpretuan. Muhamedi nuk donte t'i eliminonte strukturat ekzistuese, por ai donte t'i ndryshonte dhe përmirësonte, duke u paraqitur si reformator i thellë dhe novator. Ndër reformat e mëdha ishte dhe ajo familjare. Qëllimi ishte stabilizimi i lidhjes martesore dhe i familjes, për faktin se rreth sferës martesore dhe familjare në Arabinë para-islame nuk ekzistonte një sistem i qartë dhe i përcaktuar. Në epokën para Muhamedit predominonte një sistem afrie i tipit atëror, por ekzistonte edhe një sistem në linjën e nënës, ku llogaria bëhej nga linja e gruas, si dhe ekzistonte familja poliandrike, pra një grua kishte shumë burra në periudha të ndryshme, që krijonte problem me trashëgiminë. Ekzistonte edhe martesa me kohë, gjë që favorizonte prostitucionin.

Përkundrazi, në *Kur'an*, institucioni i martesës dhe familjes mori një rëndësi të veçantë. Familja, ndërmjet shumë gjërave që Zoti u dha njerëzve, u theksua në mënyrë të veçantë: “Allahu i ka krijuar për ju gratë nga lloji juaj e nga gratë tuaja ju jep djemtë e nipat dhe ju furnizon me ushqime të mira” (16.72). Parë në tërësi, *Kur'ani* i solli një stabilizim familjes dhe kjo duket në disa drejtime. Më së pari, përcaktoi rregulla strikte kundër incestit, të cilat ishin të rëndësishme jo vetëm për trashëgiminë biologjike, por edhe për krijimin e lidhjeve martesore ndërmjet familjeve të ndryshme: “Ju ndalohet martesa me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave, me nënat (gratë) që ju kanë dhënë gjë, me motrat tuaja, që kanë thithur prej një gjiri, me nënat e grave tuaja, me vajzën e gruas suaj që gjendet nën kujdestarinë tuaj, nëse me atë grua keni pasur marrëdhënie bashkëshortore; e, nëse nuk keni pasur marrëdhënie bashkëshortore, atëherë nuk ka pengesa. Ju ndalohet martesa me gratë e bijve tuaj dhe t'i bashkoni dy motra, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar.” (4.23).

Në të njëjtën kohë dënoi martesën poliandrike, sepse ajo prishte në themel stabilitetin familjar. Ndërsa ndaj çështjes se

martesës poligame nuk ka një qëndrim analog. Sot kjo është një çështje e debatueshme në shumë rrafsh.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua përcaktimit të atësisë, prandaj *Kur'ani* përcakton periudha pritjeje në rast divorci. Por, cili është qëllimi i martesës? Qëllimi i parë është lindja e pasardhësve, që korrespondon me rrënjë të përcaktuara nga burri, por që ishte më rëndësi jetësore për klanin apo tribunë, që për kohën ishte me rëndësi vendimtare. Lindja e fëmijëve korrespondonte me vullnetin e Zotit, i Cili është Krijuesi i vërtetë i të gjithë fëmijëve që lindin⁸. Nuk mund të mos theksojmë edhe një tjetër marrëdhënie interesante të *Kur'anit* me seksualitetin, që fatkeqësisht nuk përmendet shumë në kohën tonë. Vlen të përmendet këtu ngjashmëria me *Dhiatën e Re* për vëmendjen që Jezusi u kushtonte fëmijëve.

Një qëllim tjetër i familjes është edhe jeta në bashkësi ndërmjet burrit dhe gruas, ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Lidhja ndërmjet burrit dhe gruas është një shenjë e Zotit brenda krijimit të Tij: “Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (30.21).

Një qëllim i tretë kryesor i martesës, duke marrë parasysh situatën e Arabisë para-islame, është kënaqësia, institucionalizimi

⁸ Kur'ani: “Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës,¹³ e pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër).¹⁴ E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin)...” (23.12-14). “Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri? A s’ka qenë një pikë fare që derdhej, pastaj u bë droçkë gjaku e më pas Allahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara, e prej tij bëri çiftin: mashkullin e femrën?!” (75.36-39). “Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar: është krijuar prej një lëngu që hidhet e që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve.” (86.5-7).

dhe rregullimi i marrëdhënieve seksuale. Beqarët dhe beqaret “të përmbajnë veten”⁹. Marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore nuk lejohen (*Kur’ani*, 70.31). Megjithatë, burrave u lejohej një numër i pakufizuar konkubinash, që vinin nga robëreshat e tyre, por edhe disa gra. Kjo përbën një pikë të vështirë për t’u kuptuar nga jomyslimanët.

Një element tipik islam ishte pranimi i poligamisë megjithëse ky ishte një fenomen shumë i përhapur në Lindjen e lashtë, siç e tregon edhe Bibla hebraike. Në debatet e shumta për këtë çështje mund të sjellim disa argumente nga komente të përpunuara nga komentues të ndryshëm të *Kur’anit*. Poligamia, në një shoqëri luftarake, kishte si qëllim të kujdesej për gratë e veja nga lufta dhe t’i ndihmonin me ndihma të mëdha. Në *Kur’an* për poligaminë thuhet: “Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimëve, atëherë, martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e, nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua ose me atë që e keni në pushtetin tuaj. Në këtë mënyrë do t’i ruheni padrejtësisë më lehtë.” (4.3).

Shpesh si justifikim, jepet argumenti se *Kur’ani* në këtë mënyrë do të kufizonte poligaminë (martesën me shumë gra), që ishte diçka e pranuar në Arabi. Kështu, jo vetëm që ka të dhëna se poligamia ka qenë fenomen i zakonshëm në Arabinë para-islame, por edhe edhe poliandria, martesa me shumë burra, ishte një fenomen i njohur. Për më tepër, *Kur’ani* vendosi një kufizim, pasi

⁹ *Kur’ani*: “Ata që nuk kanë mundësi për martesë, le të përmbajnë veten, derisa Allahu t’i begatojë me dhuntinë e Tij. Ata skllever që gjenden në pushtetin tuaj e që kërkojnë të lirohen me shpërbllim dhe ju kërkojnë aktlirimin, ua jepni e, nëse e dini që janë të mirë, jepuni diçka nga pasuria juaj, të cilën ju ka dhuruar Allahu. Mos i detyroni skllavet tuaja të bëjnë kurvëri, që të arrini ju dobi të përkohshmetë kësaj bote, nëse ato dëshirojnë jetë të ndershme. Nëse ndokushi detyron ato, Allahu do të jetë Falës dhe Mëshirëplotë për to.” (24.33).

tradita e shkruar thotë: “martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër”. Por krahas faktit që myslimani mund të ketë deri në katër gra legale, nuk thuhet asnjë fjalë mbi konkubinat legale me numër të pakufizuar robërshash, i cili do të jetë një vendim i mëvonshëm i juristëve islamë. Atëherë cili është roli i gruas sipas *Kur’anit*?

A është vlerësuar apo diskriminuar gruaja në *Kur’an*?

Një risi që solli *Kur’ani* dhe shenjë pozitive për gruan ishte se në një shtëpi (dhomë) nuk mund të qëndronin të gjitha gratë së bashku, por se burrat duhet t’i vizitonin ato me radhë. Për më tepër, shumë gra (burrat e të cilave kishin vdekur në konfliktet e shumta) duhej të banonin në shtëpinë e një burri, duke pasur hapësirat e veta (poligami e kufizuar), për të pasur një mbështetje dhe mbrojtje të përshtatshme.

Në thelb, në *Kur’an*, burri dhe gruaja janë të barabartë para Zotit, pasi të dy janë krijuar prej Tij¹⁰. Ashtu si *Bibla* edhe *Kur’ani* pranon superioritetin e burrave ndaj grave¹¹. “Cilido mashkull apo femër, që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë” (16.97). Vlen të theksohet se, në historinë e origjinës, gruaja nuk paraqitet si joshëse e burrit. Është e vërtetë se ekziston një mëkat fillestar, që kreu çifti i parë i njerëzimit, që shkaktoi dëbimin nga parajsja, por nuk është një

10 *Kur’ani*: “Është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm (Ademit), prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij (Havanë), që të gjente qetësi tek ajo...” (7.189).

11 *Kur’ani*: “Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre. Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësinë që ka urdhëruar Allahu. Sa i përket grave që ju i druheni mosbindjes dhe sjelljes së keqe nga ana e tyre, këshillojini, (e nëse kjo s’bën dobi) mos i pranoni në shtrat dhe (në fund) i rrihni ato (lehtas). Por, nëse ato ju binden, atëherë mos i ndëshkoni më...” (4.34).

mëkat fillestar i trashëgueshëm, që i transmetohet çdo fëmije përmes aktit seksual, që në fillim të jetës. Ashtu si burri edhe gruaja ka të drejtën e iniciativës të lejojë ose të ndërpresë një martesë, megjithatë burri ka një zë qendror në çështjet financiare dhe çështje të tjera.

Por, nga pozicioni juridik i burrit, tepër i privilegjuar, nuk duhet të mos pranojmë faktin se në *Kur'an* kërkohet një respekt i madh dhe një ndjeshmëri reciproke, që duhet të vlerësohet edhe nga një pavarësi relative e individit brenda lidhjes familjare, ku grave u sigurohen të drejta, që në periudhën para-islame nuk i kishin. Kështu, gruaja mund të zotërojë të mira, që i përkasin asaj dhe këto nuk duhej të kontribuonin në mbajtjen e familjes; gruaja ka të drejtën të trashëgojë një të katërtën e pasurisë së burrit; gjatë një divorci të detyrueshëm ose vullnetar, kërkohet një kohë para se të kryhet, një pajtim dhe një ndërmjetësim nga ana e familjeve; në rast divorci gruaja mban pajën e saj.

Nga kjo kuptohet pse shumë gra myslimane të emancipuara sot kërkojnë një rikthim të *Kur'ani*, për faktin se disa kufizime juridike aktuale, në realitet nuk derivojnë nga *Kur'ani*, por derivojnë nga norma juridike, që janë vendosur më pas nga njerëzit. Kështu, për shembull, në *Kur'an* nuk flitet për përdorimin e burkës, që konsiderohet sot nga myslimanët dhe jo myslimanët si tipike islame. Në fakt, këto probleme aktuale duhen trajtuar me kujdes dhe kjo del jashtë synimeve të këtij punimi. Të mos harrojmë se edhe myslimanët jetojnë një kohë evolucioni të diktuar nga koha moderne.

Në vend të konkluzionit

Në këtë punim u ndalëm vetëm në paraqitjen e problemit të burrit dhe gruas siç i gjejmë në librat e shenjtë të tri feve të mëdha monoteiste, pa u ndalur në perspektivën e tyre historike, pasi kjo do të kërkonte një studim më vete. Trajtimi i marrëdhënieve ndërmjet burrit dhe gruas në perspektivën e

fenomenit fetar është një çështje e rëndësishme ekzistenciale e njeriut. Një njohje e tillë duhet t'i shërbejë edhe kuptimit të debatit të sotëm politiko-fetar në lidhje me shumë fenomene që, jo rrallë, i bëjnë një përdorim abuziv shkrimeve të shenjta, duke e rënduar akoma më shumë ekzistencën njerëzore, sepse, siç shkruan Mircea Eliade, një njohës i shquar i fenomenit fetar, “Ekzistenca e njeriut, si ekzistencë historike, merr një vlerë në mos menjëherë fetare, të paktën ‘trans-humane’”¹².

Duhet theksuar se kuptimi i teksteve të shenjta kërkon edhe një vështrim hermeneutik dhe këtu bëhet fjalë jo vetëm për një hermeneutikë të librave të shenjtë, por edhe të një hermeneutike filozofike. Është e vërtetë se hermeneutika u përdor për të kuptuar *Dhiatën e Vjetër*, por ajo ka marrë një zhvillim që shkon në funksion të “kuptimit të qenies së qenies sonë”, sipas shprehjes së Heidegger, pra, të kuptimit të thelbit të qenies sonë si njerëz, me qëllim që e keqja të mos e shkatërrojë ekzistencën tonë. Dhe këtu nuk mund të mos i japin të drejtë Kantit që e shikon shpëtimin e njerëzimit në një rinovim radikal të lirisë, dhe për të, feja është më e mira. Por, ajo mund të jetë objekt deformimesh kur praktikatat e kultit dhe lutja e humbasin finalitetin e tyre thelbësor, i cili është se si t'i ndihmojë njerëzit për të jetuar të vetmen të dhënë që ka rëndësi: dashurinë e Zotit për të afërmin tënd dhe këtu konsiston ushtrimi i moralitetit.

Prandaj, jo rastësisht, Paul Ricoeur, bën thirrje që t'i rikthehemi kritikës së Kantit. Sipas Ricoeur, doktrina e së keqes nuk u zgjidh në esenë e Kantit “Ese mbi të keqen radikale”, që hap filozofinë e fesë së tij, por ajo e shoqëron tejprtej këtë filozofi. “E keqja e vërtetë, shkruan Ricoeur, e keqja e të keqes, nuk është shkelja e një ndalese, shkelja e ligjit, mosbindja, por mashtrimi në punën e totalizimit. Në këtë kuptim, e keqja e vërtetë mund të

12 Mircea Eliade, *Traité d'histoire des religions*, Payot, Paris, 1953, f. 394.

shfaqet vetëm në fushën ku prodhohet feja, domethënë në këtë fushë të kontradiktave dhe të konflikteve të përcaktuara, nga njëra anë, nga kërkesa e totalizimit, që karakterizon arsyen, njëherësh teorike dhe praktike dhe, nga ana tjetër, nga iluzioni që ngatërrojnë, përmes hedonizmit të shkathët, që prish motivimin moral, së fundi nga ligësia, që korrupton ndërmarrjet e mëdha njerëzore të totalizimit. Kërkimi i një objekti të plotë të vullnetit, në thelbin e saj është antinomik. E keqja e së keqes lind në vend të kësaj antinomie... Prandaj feja e vërtetë është gjithmonë në debat me fenë e rreme, domethënë, për Kantin, fenë statutore”¹³.

¹³ Paul Ricoeur, *Le conflit des interprétations*, Seuil, 1969, f. 414.

**Matilda Likaj Shaqiri¹⁴ - Analizë sociologjike e fesë,
edukimit dhe familjes: Shembulli i rolit të gruas në Islam**

Abstrakt

Në literaturën sociologjike dhe të shkencave të ndryshme sociale, familja, edukimi dhe feja janë ndër institucionet kryesore sociale më të rëndësishme të një shoqërie. Në funksionim të rregullit dhe solidaritetit social, të tre këta institucione ndërthuren në funksionimin e shoqërisë. Edukimi është një nga institucionet më të rëndësishme shoqërore në cdo shoqëri, e cila promovon dhe mundëson transmetimin e njohurive dhe aftësive nëpër gjenerata. Edukimi në vetvete ndahet sipas formave të tij, formale dhe jo informale. Edukimi formal (i cili zhvillohet në institucione arsimore) u mundëson fëmijëve të përvetësojnë aftësi profesionale, por edhe rregullat shoqërore që kontribuojnë në funksionimin e shoqërisë. Sipas Durkheim, edukimi luan një rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve, sepse fëmijët fitojnë një kuptim të vlerave të përbashkëta në shoqëri, duke bashkuar një mori individësh të veçantë. Edukimi joformal, që njihet dhe si procesi i socializimit, fillon në familje (si institucion social) dhe e ka vazhdimësinë deri në fund të jetës së individit. Gjatë këtij procesi, aktori social mëson rregullat kryesore të familjes, rreth mënyrës së organizimit të jetës si dhe marrjen si shembull modelet kryesore të pjesëtarëve të saj, vecanërisht të prindërve. Gruaja, si nënë luan një rol shumë të rëndësishëm gjatë procesit të socializimit, por edhe gjatë gjithë jetës së individit. Ashtu si

¹⁴ Dr. Matilda Likaj Shaqiri, Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durrës.

edukimi dhe familja, edhe feja është një institucion social shumë i rëndësishëm për tu analizuar nga qasjet sociologjike. Ky institucion paraqet besimet fetare me dimensione sa individuale aq edhe shoqërore në jetën e përditshme të individëve. Parsons argumenton se feja është shumë e rëndësishme jo vetëm për solidaritetet personal, por edhe për solidaritet dhe stabilitet social. Sipas tij, një ndër qëllimet kryesore të fesë është dashuria për njerëzit, jetën, të ardhmen etj. Rolet kryesore për këtë transmetim e realizojnë prindërit, nëpërmjet modeleve që paraqesin gjatë periudhës së socializimit.

Në këtë studim, do të realizohet analizimi deskriptiv sociologjik, sipas qasjeve moderne, rreth institucioneve kryesore sociale edukimi, familja dhe feja, duke marrë si shembull rolin e gruas në fenë islame.

Fjalë kyce: *edukimi, familja, feja, grua në Islam*

HYRJJE

Institucionet sociale janë baza kryesore e strukturës së shoqërisë. Ato nuk kontribuojnë vetëm në ndërtimin dhe funksionimin e shoqërisë, por edhe pasurojnë formën kulturore dhe elementët e saj, si dhe mundësojnë transmetimin e saj në shtrirje të gjera kohore. Për të arritur një analizë të suksesshme të shoqërisë (përmbajtja, funksionet, zhvillimi historiko-kulturor, problemet, lidhjet midis institucioneve, strukturën, etj.) është e domosdoshme analizimi i institucioneve sociale.

Nga qasje të ndryshme sociologjike, institucioni social është pjesë e kulturës e cila reflekton nëpërmjet mënyrës së jetesës, i cili përmbledh sjelljet që kanë shumë prej aktorëve social, rrugët që të çojnë drejt përmbushjes së normave dhe sjelljeve të kulturës. ‘ Për të realizuar një përcaktim disi më të përmbledhur të institucionit social, duhet të përmenden disa elemente që përmban në vetvete siç janë:

1-Institucioni social ka si objektiv realizimin e qëllimit të tij;

2-Përgjatë historisë njerëzore, qëllimet i ka realizuar me sukses;

3-Për realizimin e qëllimit, ka bashkëpunuar me institucione të tjera sociale;

4-Pavarësisht bashkëpunimit, institucioni social ka strukturë të pavarur;

5-Institucioni social në vetvete përmban kodet normative të kulturës të shoqërisë ku funksionon, si rrjedhojë merr një rëndësi të vecantë (Aydin; 2000:16)

Në strukturën e shoqërisë, ndodhen shtatë institucione kryesore sociale (megjithatë ky kategorizim ndryshon sipas kushteve të jetesës, gjeografike, rëndësisë që u jep shoqëria, dhe funksioneve që mbartin) dhe shumë institucione të tjera emergjente, të cilat lindin dhe e zhvillojnë aktivitetin e tyre social sipas kushteve sociale bashkëkohore. Shtatë institucionet kryesore sociale mund të radhiten si familja, edukimi, ekonomia, politika (sistemi qeverisës), sistemi shëndetësor, sistemi ushtarak dhe feja. Pavarësisht se institucionet sociale mbartin funksione të ndryshme (siç janë të radhitura më poshtë), ato kanë ndërthurje të përbashkëta dhe funksionojnë në vartësi të nevojave të shoqërisë. Për shembull, edukimi si institucion social, ndërthuret në funksionet e tij dhe me institucione të tjera sociale që kryejnë funksionin e edukimit siç është familja dhe feja.

Disa prej funksioneve kryesore të institucioneve sociale janë:

1-‘Të lehtësojë sjelljet sociale të individit (i orienton individët drejt normave dhe rregullave social të rregullit social në shoqëri).

2-I mundëson shoqërisë vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e kulturës.

3-Mundëson lokalizimin e deviancave dhe anomive sociale, nëpërmjet kontrollit të sjelljeve sociale, me qëllim të ruajtjes së rregullit social' (Aydin; 2000:16).

Bazuar në konceptin e institucioneve sociale sipas perspektivës sociologjike, është shumë e rëndësishme të theksohet se mekanizmat e funksionimit të shoqërisë bazohen te institucionet. Nëse e analizojmë nga perspektiva strukturaliste-funksionaliste, shoqëria është si një organizëm e gjallë, e cila zhvillohet për të ruajtur rregullin social. Sipas Merton, disa prej strukturave sociale (Merton përfshin edhe institucionet sociale në këto struktura) kanë ndikim të dukshëm te përshtatja dhe sjelljet e duhura (sjellje konformiste) të individëve (Merton; 1983: 672 at Poloma; 1993:36). Ky lloj funksionimi njihet edhe si postulati i dytë i funksionalizmit universal, që përcaktohet si funksioni pozitiv. Pikërisht dhe ky artikull do të fokusohet te funksionalizimi universal pozitiv i bashkëpunimit të tre institucioneve social familja, edukimi dhe feja, për promovimin e solidaritetit social.

Bazuar në këto çështje është e rëndësishme të theksohet se feja ka një rol të rëndësishëm në mekanizmat për solidaritetin social, megjithatë ndonjë herë bëhet e pandashme nga konceptimi social i jetës shoqërore dhe kulturore. Kjo ndodh si shkak i procesit të edukimit (sidomos procesit të socializimit, ku aktori social përtej perceptimeve personale, i plotëson perceptimet sociale sipas strukturës sociale dhe kulturore të ambientit ku ai jeton (Likaj Shaqiri; 2017:137).

Koncepti i rrjedhës së jetesës, ndryshe prej ciklit të jetës, pasqyron se ekziston ndryshim i konsiderueshëm në shoqëritë e ndryshme në shtrirje kohore të gjata, që ndikojnë në jetën e individëve dhe perceptimet e tyre në jetën sociale. Rrjedhja e jetës dhe faza të ndryshme që paraqiten në ciklin e jetës, u mundësojnë individëve të jenë të hapur për pranimin e ndryshimeve kulturore dhe rrethanave material/jomateriale të jetës së tyre (Giddens;

2009:295). Ndryshimet sociale, kulturore, ekonomike dhe politike ndikojnë në ndryshimin e strukturës sociale dhe institucioneve sociale që ajo mbart. Megjithatë, në strukturën sociale të një shoqërie, një vend shumë të rëndësishëm zë konsensusi social. Konsensus nënkupton dakordësinë e individëve në vlerat bazë të shoqërisë, stabilitetin social, ruajtjen e kontrollit social etj. Familja, edukimi dhe feja janë institucionet sociale të cilët mundësojnë ruajtjen e konsensusit social të një shoqërie.

Pikërisht fokusi i këtij punimi do të jetë te ndryshimet sociale, ndryshimet e rrjedhës së jetës dhe lidhja e tre institucioneve sociale, siç është familja, edukimi dhe feja, pavarësisht se ka ndryshuar në rrjedhën e jetës, përsëri ka ndikim të fort në jetën e aktorit social. Ndikimi reflektohet nëpërmjet roleve që mbart roli i individit edukues (në këtë rast, femra si nënë) dhe reflektimi i këtij roli në brezat e rinj.

Ky artikull do të zhvillohet duke u bazuar në trajtesat sociologjike të institucioneve sociale si edukimi, familja dhe feja, si dhe analizimi i rolit të gruas në një ndër tre fetë kryesore, siç është Islami.

Edukimi, familja dhe feja si institucione sociale

• *Edukimi si Socializim*

Edukimi është një nga institucionet më të rëndësishme shoqërore në çdo shoqëri, e cila promovon dhe mundëson transmetimin e njohurive dhe aftësive nëpër gjenerata. Edukimi në vetvete ndahet sipas formave të tij, formale dhe jo informale. Edukimi formal (i cili zhvillohet në institucione arsimore) u mundëson fëmijëve të përvetësojnë aftësi profesionale, por edhe rregullat shoqërore që kontribuojnë në funksionimin e shoqërisë. Sipas Durkheim, edukimi luan një rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve, sepse fëmijët fitojnë një kuptim të vlerave të përbashkëta në shoqëri, duke bashkuar një mori individësh të veçantë. Edukimi joformal, që njihet dhe si procesi i socializimit,

fillon në familje (si institucion social) dhe e ka vazhdimësinë deri në fund të jetës së individit. Gjatë këtij procesi, aktori social mëson rregullat kryesore të familjes, rreth mënyrës së organizimit të jetës si dhe marrjen si shembull modelet kryesore të pjesëtarëve të saj, vecanërisht të prindërve. Kështu që Durkheim fokusohet te roli i edukimit si institucion social, në përgatitjen e fëmijëve si aktor social. Edukimi luan një rol shumë të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve, për ti përgatitur për rolin që ata do kenë në shoqëri, për të mësuar solidaritetin dhe vlerat kulturore. ‘Për Emile Durkheim, edukimi luan një rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve për shembull, fëmijët fitojnë një kuptim të vlerave të përbashkëta në shoqëri, duke bashkuar një mori perceptimesh individuale dhe të veçantë. Këto vlera të përbashkëta përfshijnë besimet fetare dhe morale, si dhe ndjenjën e vetëdisiplinës’ (Giddens; 2009:834).

Edukimi në vetvete ndahet në dy forma, formal dhe jo formal. Edukimi formal është i planifikuar dhe realizohet në institucione formale në shoqëri. Ndërsa edukimi jo formal, ndryshe e njohur si socializim realizohet si rrjedhojë e ndikimit të insitucioneve sociale sic janë familja, feja, etj. Socializimi nënkupton veprim sistematik dhe të qëllimshëm, i cili e orienton individin drejt vlerave dhe strukturimit të roleve në të ardhmen si i rritur. ‘Sipas Parson socializimi është proces i brendshëm i orientimeve përkatëse, për plotësimin e pritshmërive të shoqërisë. Ndryshe prej Parson, Durkheim e cilëson socializimin si ruajtës të qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së shoqërisë (Zenelaga & Cenaj; 2012: 45).

Sipas sociologëve, socializimi është procesi në të cilin fëmija gradualisht bëhet një person i vetëdijshëm, i ditur, i aftë për përvetësimin e elementëve të kulturës ku jeton. Socializimi i të rinjve formon fenomenin më të përgjithshëm të riprodhimit social, proces ku shoqëritë përvetësojnë vazhdimësi të strukturës socio-kulturore. Gjatë rrjedhës së socializimit, sidomos në vitet e

hershme të jetës, fëmijët mësojnë vlerat, normat dhe praktikat e tyre shoqërore. (Giddens; 2009:285). Ndërveprimet sociale e kanë bazën e zhvillimit në institucionin social sic është familja.

- ***Familja si institucion social***

Në procesin e shoqërizimit/socializimit, mjedisi i parë social i individit është familja. Familja është ambienti social ku individ përballet me mënyrën e jetesës dhe lidhja që ajo ka me vlerat. Gjatë procesit të socializimit, familja është institucioni themelor shoqëror si mjedisi i parë social, në të cilin fëmija përvetëson vlerat e shoqërisë dhe zakonet e jetës. Vlerat (ose gjykimet e vlerës) dhe normat (p.sh. normat morale) që janë më të larta të shoqërisë ku jeton, i përcillen fëmijës për herë të parë në familje. Familja nuk ndikon vetëm në formimin e personalitetit të individit, njëkohësisht i mëson individit vlerat, normat, traditat, zakonet etj të shoqërisë dhe strukturës socio-kulturore të saj. E shprehur me fjalë të tjera, familja ka rëndësi të madhe në përcjelljen e kulturës, vlerave, normave, traditave, zakoneve, zakoneve, traditave, etj. tek gjeneratat e reja. Mësimi i rregullave të shoqërisë, vlerave dhe përvetësimit të gjykit të vlerave prej një të riu, e ndihmon atë në formimin e një stili jetese që është e përshtatshme me shoqërinë ku ai jeton. Kjo e ndihmon të riun të konsiderohet si anëtar i kësaj shoqërie, si dhe të bëhet pjesë e mekanizmit të ruajtjes dhe transmetimit të këtyre elementëve në brezat e ardhshëm. Në këtë rast, i riu luan një rol aktiv në vazhdimin e kulturës dhe elementëve të saj, të transmetohen nga brezi në brez. Siç duket, funksioni kryesor i familjes është që të siguroj përfshirjen e fëmijës në socializim dhe në përvetësimin e funksioneve të kulturës.

‘Familja është një grup personash që kanë lidhje gjaku ose martesore, ku të rritur kanë si detyrë kryesore dhe përgjegjësinë e përkujdesjes ndaj fëmijëve (Giddens; 2009:331). Familja i organizon detyrat familjare në mënyrë tepër individuale, si dhe

mundëson lidhjen e kësaj hapësire me një ambient më të gjerë social (Giddens; 2009:339).

‘Në të gjitha shoqëritë, familja është vendi i parë dhe më i rëndësishëm për socializim (një agjent i socializimit). Familja në të cilën ne lindim na jep karakteristika sociale të tilla si klasa sociale, raca, etnia dhe prejardhja fetare. Familjet tona janë mësuesit tanë fillestar të sjelljeve, gjuhës, njohuri kulturore, vlera dhe aftësi sociale. Ato janë gjithashtu qendrore për rolin gjinor socializimin. Me fjalë të tjera, familja siguron socializimin tonë primar’ (Spickard;1992: 145). Për rrjedhojë mund të thuhet se familja gëzon dy role kryesore si vazhdimësia e brezave dhe formimi i sistemit të standardizimit duke u bazuar në kushtet sociale dhe kulturore të shoqërisë ku ndodhen. ‘Familja, si një institucion social, ka si funksione vazhdimësinë e brezave, transmetimin e kulturës kombëtare dhe fetare, socializimin e fëmijëve, plotësimin e nevojave ekonomike, biologjike dhe psikologjike (Aydin; 2000:35). Nisur prej këtyre funksioneve dhe bazuar te Mead, është e rëndësishme të theksohet se individ i formon vetveten sociale (social self) dhe konshiençën sociale (social consciousness). Ambienti ku aktori social e realizon vetveten sociale, është institucioni i familjes. Nëpërmjet ndërveprimeve sociale në familje formohet edhe riprodhimi kulturor.

Bourdieu e përcakton prodhimin kulturor si transmetimin e brezit kulturor vlerat, normat dhe përvoja, mekanizmat dhe proceset përmes periudhës së socializimit. ‘Bourdieu përdor konceptin e riprodhimit kulturor duke marrë parasysh vlerën themelore siç është 'habitus', e cila mund të përshkruhet si sjellje, mënyra e të folurit ose mënyra e të menduarit, dhe mënyra e të vepruarit. Këto sjellje miratohen nga aktorë të tjerë social, që gjenden në të njëjtat kushtet shoqërore (Likaj Shaqiri; 2017;4). Këta aktorë social janë pjesëtarët e familjes, prindërit (sidomos nënat), motrat dhe vëllezërit, si dhe të farefisi shumë i afërt.

- **Feja si institucion social**

‘Fetë e mëdha, ndikojnë fuqishëm tej individit’ (Freyer; 2015:108). Ndoshta, Freyre ka qenë i ndikuar prej filozofisë së Hume, ku feja ndikon në formimin e shpresës dhe të frikës së individit. Nëse, sipas Freyre, feja ka ndikim kaq të madh te individit (kjo është relative dhe shumë e diskutueshme), atëherë bëhet e detyrueshme përcaktimi sociologjik i konceptit dhe praktikës së fesë (shkurtimisht).

Sociologët e përcaktojnë fenë si një sistem kulturor të besimeve dhe ritualeve të përbashkëta që sigurojnë një ndjenjë të kuptimit dhe qëllimit përfundimtar, duke krijuar një ide të realitetit që është i shenjtë, gjithëpërfshirës dhe mbinatyrore.

1-‘Feja është një formë e kulturës. Kultura përbëhet nga besimet, vlerat, normat dhe idetë e përbashkëta që krijojnë një identitet të përbashkët në mesin e një grupi njerëzish. Feja përmban të gjitha këto karakteristika.

2-Feja përfshin besime që marrin formën e praktikave të ritualizuara. Të gjitha fetë kanë një aktivitet të veçantë dhe sistem sjelljesh, në të cilin besimtarët marrin pjesë dhe që i identifikojnë si anëtarë të bashkësisë fetare.

3-Ndoshta më e rëndësishmja, feja siguron një ndjenjë qëllimi - një ndjenjë që në fund të fundit jeta është kuptimplote. Kjo i mundëson shpjegim në mënyrë koherente dhe bindëse atë që tejkalon ose lëkund jetën e përditshme, në mënyrën ndryshe prej aspekteve të tjera të kulturës (si sistemi arsimor ose besimi në demokraci) (Giddens; 2009:677).

Feja në vetvete (përvec përcaktimit sociologjik të sipërpërmendur) ka një lidhje të fortë me shoqërinë, grupet sociale ose komunitetet. Feja si një fenomen social, reflektimet dhe ndikimet e saj janë indikator në jetën shoqërore dhe strukturën sociale. Feja, si të gjitha institucionet e tjera sociale, ka funksionet e saj. Funksionet e fesë janë të lidhura ngushtë me funksionet e

institucioneve të tjera sociale. Funkzionet sociale të fesë nuk mund të operojnë të pavarura prej institucioneve sociale dhe strukturës shoqërore, megjithatë ato ndryshojnë nga një vend në tjetrin. ‘Parsons supozon se feja ka disa funksione në shoqëri. Së pari, feja ndihmon anëtarët e shoqërisë për t'u marrë me ngjarje të paparashikueshme dhe të pakontrollueshme, siç është vdekja e hershme. Së dyti, nëpërmjet riteve feja u mundëson individëve të jetojnë me pasigurinë. Feja i jep kuptim jetës dhe shpjegon fenomenet që ndryshe do të duket e pakuptimtë, siç është vuajtja dhe problemi i së keqes. Në këtë mënyrë, feja zbut tensione që përndryshe do të shqetësonin rendin shoqëror dhe ndihmon në ruajtjen e stabilitetit shoqëror’ (Likaj Shaqiri; 2017: 135). Kështu që, feja si institucion social, jo vetëm që luan një rol stabilizues te aktori social (kjo nuk mund të jetë absolute në të gjitha fetë) por ndikon në ndërveprimin social dhe formimin e habitus (termi i përdorur prej Habermas) me institucione të tjera sociale (në këtë rast janë familja dhe edukimi). ‘Gjithashtu, Parsons e përcakton fenë shumë të rëndësishme jo vetëm për solidaritetin personal, por edhe për rendin dhe solidaritetin shoqëror (Likaj Shaqiri & Aydemir; 2013: 24).

Në përgjithësi, të gjitha fetë përmbajnë besime, rituale, formimin e komuniteteve, rregulla, norma, etj. Duke qenë se feja është sa personale aq edhe shoqërore, transmetimi në breza të këtyre elementëve është pjesë e natyrshme e mënyrës së jetesës por edhe e procesit të socializimit. Si fillim, familja është institucioni kryesor që e kryen këtë detyrë. Në vazhdimësinë e këtij punimi do të diskutohet për transmetimin e elementëve të fesë në familje, sidomos fokusi do të jetë te gruaja si nënë gjatë procesit të prindërimit dhe edukimit.

Këndvështrim sociologjik i rolit të gruas në fenë Islame

Vlerat, qëllimet dhe normat e shoqërisë dhe mjetet e institucionalizuara të krijuara prej strukturës sociale,

përvetësohen gjatë procesit të socializimit dhe shpeshherë përdoren prej individëve gjatë jetës së tyre. Socializimi është burimi i parë i fitimit dhe përvetësimit të vlerave të individit, proces ky i cili në fillim zhvillohet në familje. Në socializimin e fëmijës, rol shumë të rëndësishëm luajnë nëna, babai, motrat, vëllezërit, gjyshërit, të afërmit etj.. Gruaja, si nënë luan një rol shumë të rëndësishëm gjatë procesit të socializimit, por edhe gjatë gjithë jetës së individit. Në familje, prindërit, vëllezërit e motrat, i transmetojnë individit, disa forma të sjelljes, vlerave themelore dhe normave të shoqërisë. Roli më i rëndësishëm në periudhën e socializimit të fëmijës, i përket nënës (Taşdelen 2000; në: Özensel; 2004:33).

Roli i gruas si nënë, është shumë dominant dhe ndikues te edukimi i fëmijës. Fëmijët nuk gjenden vetëm nën ndikimin e tyre si individ me personalitet të ndryshme, por ndikohen prej tyre si aktor social që mbartin dhe përfaqësojnë zakonet, traditat, vlerat sociale dhe kulturore etj të shoqërisë ku jetojnë. Këtu përfshihen edhe format të ndryshme të fesë, elementët, ritualet, besimet, etj. ‘ Besimet dhe vlerat e përfaqësuara nga të rriturit, që në këtë rast janë nënat dhe baballarët, gjatë periudhës së socializimit i transmetojnë ato te individë duke ndikuar edhe te super-egoja e tij (Güngör; 2000: 58). Për këtë arsye përvetësimi i normave dhe vlerave janë pjesë e procesit të shoqërizimit/socializimit. Përtej mësimi të vlerave, përparësi merr mësimi i funksionimit të shoqërisë (e cila në mënyrë indirekte i mëson vlerat sociale dhe kulturore një individ (Güngör; 2000:70).

Si rrjedhojë, socializimi është periudhë shumë e rëndësishme, e cila i mundëson fëmijës të përvetësojë në mënyrë konshiente ose jo konshiente, elementë të strukturës sociale dhe kulturore. Përvetësimi i këtyre elementëve mundëson vazdimësinë e kulturës së vendit të origjinës së individit, të praktikave fetare dhe të fesë, që ai i përket.

‘Edukimi i vërtetë unik arrihet nëpërmjet stimulimit të forcave të fëmijës më anë të kërkesave të situatave shoqërore në të cilat ai do të gjendet’(Dewey; 2003:11). ‘Njerëzit krijojnë ndërveprimeve shoqërore. Ndërsa ndërveprojmë me të tjerët, ne vazhdimisht flasim, dëgjojmë, vëzhgojmë, vlerësojmë dhe gjykojmë situatat bazuar në mënyrën se si jemi shoqëruar për të kuptuar dhe reaguar ndaj tyre. Nëpërmjet këtij procesi të vazhdueshëm të perceptimit dhe përcaktimit të ngjarjeve, ne "interpretojmë" realitetin dhe "e negociojmë" kuptimin (Stolley; 2005: 69). Individët formojnë një realitet social që ka nevojë për tu përvetësuar në dobi të individëve të tjerë dhe të shoqërisë. Këtë funksion të edukimit e luan gruaja, nëpërmjet rolit të prindërimit. Në këtë kontekst, vihet re ndërthurja që kanë me njëra tjetrën institucionet sociale si familja, edukimi dhe feja. ‘Feja në vetvete është produkti i mjedisit socio-kulturor. Feja nuk është mbinjerëzore. por hyjnore. Struktura e fesë islame është rezultati i kushteve sociale që prodhon shoqëria. Shoqëria si determinuese e të gjithë përbërësve shoqëror, qofshin ata material ose shpirtëror, ndikon në riprodhimin e vetvetes’ (Pajaziti; 2012:69).

Edhe B. Turner e përcakton fenë e islamit si një sistem besimi dhe prodhim të strukturës socio-kulturore. Ky prodhim nuk është rastësi, por vjen natyrshëm nëpërmjet procesit të socializimit dhe rolit të gruas në transmetimin e këtij sistemi te brezat e rinj. Roli i gruas në fenë islame zë një vend shumë të rëndësishëm.

Në Kuran dhe hadithe, shpesh trajtohen barazia e burrave dhe grave. Në ajetet rreth krijimit të njeriut, nuk është përcaktuar asnjë virtyt për dallimin gjinor të burrave dhe grave. Gratë janë para së gjithash qeniet njerëzore dhe ka shumë të drejta themelore, veçanërisht e drejta për të jetuar në mënyrë të denjë dhe të japin kontributin e tyre në shoqëri (Gürhan; 2010: 71). Duke qenë se gruaja ka një rol të rëndësishëm dhe të barabartë me burrin, ajo mund të jetë modeli më i mirë edukues për fëmijët. ‘Urdhëresat e Kur'anit janë jodiskriminuese mes burrave dhe grave, dhe 750

ajetet që flasin për shkencën, adresojnë burrat dhe gratë pa bërë dallim. Profeti i Islamit, Muhammedi (as) është një profet i dërguar të të gjithë njerëzit, që i ka këshilluar dhe udhëzuar burrin dhe gruan se si të edukojnë brezat e rinjë (Kayadibi; __: 25).

Kjo tregon qartë mbështetjen dhe promovimin e veprimtarisë së gruas si në ambientin familjar ashtu edhe në hapsirën publike. Një nga të drejtat që Islami ua jep grave është fakti se u ka siguruar të ruajnë personalitetin e tyre. Gruaja ka të drejtën të shprehë atë që ajo mendon , duke përdorur plotësisht vullnetin e lirë. Profeti Muhammed a.s është shprehur se grua, e cila nuk e ka izoluar veten nga jeta e shoqërisë, ka demonstruar se ajo është një individ me personalitet që mbron veten dhe të drejtat e saj' (Gürhan; 2010:74). Gruaja në këtë rast mund të vlerësohet si aktor social po aq aktiv sa një burrë, megjithatë nuk duhet harruar dhe roli i saj si nënë. 'Në fakt, nëna është konsideruar të jetë mësuesi i parë i fesë dhe babai edukatori i parë. Për këtë arsye, është e sigurt se prindërit kanë ndikimin më të rëndësishëm në edukimin e fëmijës duke praktikuar parimet e fesë. Metoda më ideale në edukimin fetar është "të mësosh fëmijën të adhurojë, të adhurojë së bashku me prindin dhe të shpjegojë çështjet e fesë nëpërmjet bisedimeve'(Ay; 2005:374).

Shkurtimisht, grua në islam, jo vetëm që ka një rol shumë të rëndësishëm në hapsirën publike, por është aktori kryesor social që ndikon nëpërmjet ndërveprimit social dhe paraqitjes së modelit prindëror të brezave të rinjë. Në periudhën e socializimit parësor, por edhe dytësor, grua si nënë është transmetuesi kryesor i vlerave të besimit fetar, modelit fetar, por edhe praktikës fetare të fëmijës.

PERFUNDIM

Durkheim besonte se funksionimi i institucioneve sociale kishte si fokus promovimin dhe ruajtjen e kohezionit dhe unitetit social. Ndërveprimësia midis institucioneve sociale është e

pashmangshme dhe gjendet në të gjitha shoqëritë (këtu duhet të theksohet se çdo periudhë kohore dhe cdo strukturë sociale ka ndryshim në ndërveprimësitë midis institucioneve sociale. Megjithatë, sic u diskutua më sipër, institucionet sociale si familja, edukimi dhe feja kanë një lidhje të fortë midis njëra tjetrës. Nëpërmjet procesit të socializimit (proçes shumë i rëndësishëm në institucionin social të edukimit), fëmijët mësojnë në familje se si të marrin modele të caktuar fetare, mësojnë vlerat, normat, rregullat dhe besimet fetare. Rëndësia e familjes ndaj fëmijës nuk është vetëm për shkak të nevojave financiare dhe materiale që ata kanë. Nevojat materiale të fëmijës mund të plotësohen në mënyra të ndryshme. Megjithatë, është shumë e vështirë të sigurohet një mjedis emocional dashurie dhe besimi në vende të tjera, larg familjes. Sidomos për fëmijët, dashuria e nënës është shumë e rëndësishme. Mungesa e dashurisë së nënës përcillet me sjellje të paqëndrueshme psikologjike të fëmija (të cilat e shoqërojnë gjatë gjithë jetës) (Aydin; 2003:127). Kështu që rolin kryesor në peridhën e socializimit e kryen më së shumti nëna. ‘Përveç rëndësisë psikologjike, pedagogjike dhe sociologjike të familjes, gjithashtu dihet se familja është faktori më i rëndësishëm në trasmetimin e fesë të fëmijët’ (Ay; 2005: 374). Si përfundim, në këtë studim me qasje të analizës deskriptive, është e rëndësishme të nxirret si konkluzion, se feja si insitucion social, merr forma të ndryshme sipas kushteve shoqërore. Nëse orientimet e shpjegimeve sociologjike deskriptive do të orientohen te praktika sociale atëherë do të ngrihen polemika dhe dilema të shumta, të cilat do formojnë debate mbi këtë temë. Nëse, analiza sociologjike deskriptive do të analizohet duke u bazuar te literatura bazë teologjike e fesë islame, do të vihet re se institucionet sociale edukim-familje-fe, kanë një lidhje shumë të fortë me njëra tjetrën, por do të dallohet se roli i femrës si grua dhe si nënë, është dominante dhe shumë ndikues.

BIBLIOGRAFI

- AY, Mehmet Emin; 2005; *Ailede Verilecek Din Egitiminde Genel Prensipler: Islamda Aile Ve Cocuk Terbiyesi*; Karmat Yayin Evi: Istanbul
- AYDIN, Mehmet Zeki; 2003; *Ailede Ahlak Egitimi*; Cumhuriyet Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi Vol: VII, pp.125-158: Sivas
- AYDIN, Mustafa; 2000; *Kurumlar Sosyolojisi*; 2nci Baski; Vadi yayinlari: Konya
- DEWEY, John; 2003; *Shkolla Dhe Shoqeria*, Përkth; A. Bubesi; Plejad: Tirane
- FREYER, Hans; 2015; *Sociologjia e Fese*, Përkth. A.Pajaziti, LOGOS-A: Shkup
- GIDDENS, Anthony; 2009; *Sociology*; 6th Edition; Polity Press: UK
- GÜNGÖR, Erol; 2000; *Değerler Psikolojisi Üzerinde Araştırmalar, Ahlak Psikolojisi, Ahlaki Değerler ve Ahlaki Gelişme*; Ötüken yayınevi: İstanbul
- GÜRHAN, Nazife; 2010; *Toplumsal Cinsiyet Ve Din*; e-Şarkiyat İlmi Araştırmalar Dergisi - Vol IV, pp. 58-80
- KAYADİBİ, Fahri, *Kadin Eğitiminin Önemi ve Kalkınmadaki Rolü*, <http://dergipark.gov.tr/download/article-file/101022>, pp 19-31
- LIKAJ SHAQIRI, M.& AYDEMİR, M. A.; 2013; *Religion and Spirituality as Important Issues on Social Capital: Albanian Society Case*; BJH; VOL 2; pp 21-35
- LIKAJ SHAQIRI, Matilda; 2017; *Hermeneutics As The Interpretation Of Religion In Cultural Context: Sociological Perspective Of Albanian Culture*; BJES vol 14, number 1; pp 131-142
- LIKAJ SHAQIRI, Matilda; 2017; *Social Conflicts, Violent Extremism And Education: How To Combat 'Hate Speech' Through Counter And Alternative Narratives*; BJES; Vol. 15 & 16, pp. 1-16
- ÖZENSEL, Ertan; 2004; *Türk Gençliğinin Değeri (Liseli Gençlik Üzerine Bir Araştırma)*; Yayınlanmamış Doktora Tezi, Sakarya
- PAJAZITI, Ali; 2012; *Nje Interpretim Sociologjik i Religjionit dhe Islamit: Rasti W.M.Watt*; LOGOS-A: Shkup
- POLOMA, Margaret; 1993; *Cagdas Sosyoloji Kuramlari*; cev: H.Erbas; 2nci Baski; Gundogan Yayinlari: Ankara

SPICKARD, James V.; 1992; *For A Sociology Of Experience*; University of Redlands: The Journal for Near-Death Studies, vol. 3, no.2; pp137-155;

STOLLEY, Kathy S.; 2005; *The Basics Of Sociology*, Greenwood Press: Londo

ZENELAGA, B. & CENAJ, E.; 2012; Manual per Kursin Sociologji Edukimi; MIRGEERALB: Tirana.

SEANCA E DYTË SHKENCORE:

“Të drejtat e gruas në shoqërinë moderne”

Moderator: **Tidita Abdurrahmani** - Dekane e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit, KU Bedër

1. **Gëzim Tushi** - Shërbimi Social Shtetëror,

“Gratë në kohën e tyre. Rreth problemit të barazisë gjinore në shoqërinë e sotme shqiptare”

2. **Natalia Tampega** - Universiteti St. Petersburg

“Roli i gruas në aktivitetin e organizatave fetare myslimane në Rusi”

3. **Zenepe Dibra** - Presidente e Shoqatës “Gruaja Intelektuale Shkodrane”

“Kontributi patriotik, emancipues dhe kultural i gruas myslimane në historinë e Shqipërisë”

4. **Ana Uka** - Kolegji Universitar Bedër,

“Divorci dhe dhuna në familje, plagë të shoqërisë moderne”

5. **Ilirjana Kaceli** - studiuese

“Roli i gruas në edukimin e brezave, bazuar në revistat kulturore islame”

6. **Besa Ismaili** - Bashkësia Islame e Kosovës

“Rolet e ndryshueshme të grave në shoqëritë myslimane”

7. **Fatma Karaj** - Përgjegjëse e Zyrës së Gruas, Komuniteti

Mysliman i Shqipërisë

“Të drejtat e gruas në Islam”

Gëzim Tushi¹⁵ - “Gratë në kohën e tyre dhe beteja për barazi gjinore”

Çështjet që kanë të bëjnë me “botën e gruas”, me situatën problematike të barazisë gjinore, mund të duken të thjeshta në dukje, por shumë të ndërlikuara në thelbin e tyre. Personalisht jam marrë gjatë, kam shkruar edhe një libër të plotë për këtë temë. Jo vetëm pse sociologjiksht kjo është shumë e gjërë, komplekse dhe historikisht interesante, por dhe sepse gjithnjë kam patur idenë se në shoqërinë tonë pabarazia dhe diskriminimi i grave është një “plagë sociale”, një patologji evidente, tregues sintetik të natyrës së shoqërisë tonë të së kaluarës. Reminishencat e së cilës, për fat të keq ende janë të forta, virulente.

Pse ndodh kështu? Çfarë ka shoqëria jonë që nuk i arrin dot rezultatet e pritshme dhe të dëshiruara në fushën e “barazisë gjinore”? Ku pengohet dhe pse nuk ecën procesi me ritmet e duhura? Mund të ketë shumë arsye komplekse që mund të zbulohen duke bërë analiza sociologjike, ndarje grupe dhe prerje të ndryshme gjinore. Por duhen dalluar ato që momentalisht janë pengesat kryesore të këtij procesi të madh, të kësaj sfide madhore të qytetërimit tonë. Koncepti i barazisë gjinore është i gjërë, kompleks, shumë i ndërlikuar. Thelbi i të cilit është përtej frazeologjisë dhe demagogjisë, sepse është brendësuar në “limfën sociale” historike të shoqërisë shqiptare, e lidhur me mentalitetin masklist të “burrave” të këtij vendi, që edhe sot kur flasin për barazi gjinore e reduktojnë konceptin në anën e jashtme të gjërave, duke e parë çështjen të thjeshtëzuar.

¹⁵ Mjeshtër i Madh, Shërbimi Social Shtetëror.

Padyshim, barazia gjinore ka pjesën e saj që është e lidhur me transformimin politik dhe demokratik të shoqërisë shqiptare, garantimin e lirive, të drejtave ligjore, garancive kushtetuese. Por ajo së pari duhet parë si një proces social specifik, i lidhur me ca të drejta të tjera të limituara apo të munguara të femrës, që gëlojnë hapur e fshehtas në “moralin e dyfishtë” të familjes dhe shoqërisë. Në luftën për barazi gjinore, duket sikur ka diçka që nuk varet nga ne, që nuk është në dorën tonë, një element që prodhon rezistencë ndaj procesit të nevojshëm të ndryshimeve që duhen bërë në fushën e barazisë gjinore.

Duke menduar se cili mund të jetë ky element konservator që pengon, ngadalëson apo e deformon procesin e barazisë gjinore, më duket se në radhë të parë janë ekzistenca e disa paradigmeve dhe “normave kulturore”, me të cilat është ushqyer dhe frymëzuar shoqëria jonë në të kaluarën, recidivat e së cilës nuk janë kapërxyer plotësisht as në ditët tona.

Forca e mentalitetit gjinor maskilist është e koracuar, e oksiduar keq nga koha dhe nuk është e lehtë që t’i heqësh asaj ndryshkun e trashë të maskilizmit. Kjo për fat të keq nuk është vetëm “difekt kulturor”, por më shumë “deformim ideologjik” i shoqërisë që vazhdon të shfaqet tepër virulent në kohën tonë. Problemi i barazisë gjinore është parë dhe vlerësuar gjithnjë nga këndshikimi politik i saj, dhe rrallë në prizmin e pengesës kulturore me të cilin tradicionalisht përballet ky proces në shoqëri. Normat e vjetra kulturore, janë paradigma sociale të forta, që kanë forcë të madhe ndikuese në jetën shoqërore. Qoftë në formën e zakonit, traditës, rutinës apo në çdo formë tjetër alternative, normat kulturore kanë peshë sociale determinante mbi gratë, të cilat siç thotë profesori i Universitetit të Oksfordit David Miller, “mbeten skllave të normave kulturore të kahershme të shoqërisë së tyre edhe atëhere kur ato nuk janë të shtrënguara fizikisht për t’iu përmbajtur atyre”.

Çfarë janë këto “norma kulturore” që i detyron ende gratë të bëhen kaq të nënështuara dhe shoqërinë tonë të shfaqet me një fundament kaq të fortë maskilist, që krijon terren të determinuar për të kornizuar dhe kufizuar përmasat e “botës së femrës”? Ato në të vërtetë janë ca rregulla të shkuara dhe të pashkuara, që kanë të bëjnë dhe lidhen me diktimin e sjelljes, paraqitjen e jashtme, mënyrën si i vendos ajo marrëdhëniet me meshkujt në familje dhe shoqëri. Të gjitha këto kanë një forcë ndikuese dhe inerci sociale në pozitën sociale të femrave. Normat kulturore janë stereotipe dinamike që vendosen mbi femrën që në vogli. Ato kanë fuqi dhe qëndrueshmëri të tillë që nuk mund të çrrënjosen me lehtësi më pas.

Në shoqërinë shqiptare kanë ndodhur ndryshime të mëdha. Megjithatë, nuk mund të themi se kornizat kulturore maskiliste që determinojnë pozitën e femrave në shoqëri, nuk kanë më efekt pengues për to. Megjithëse më të lira për të bërë zgjedhjet e tyre në shumë fusha të jetës, me më shumë hapësirë për punësim, besim fetar, stil jetese në një kuptim më të gjërë, ato janë të kondicionuara nga një lloj përcaktimi kulturor, social dhe familjar të “kufijve të femërores”.

Në terrenin politik dhe mediatik, në ambientet e shoqërtisë civile në shumë raste për këtë problem ka një kakofoni perceptimesh, të shoqëruar me propagandime pa “bosht të qartë”, pa orientim të sigurt për atë që kërkojmë të gjejmë dhe ku duam të dalim në fushën e barazisë gjinore. Sepse nuk janë fort të qarta strategjitë, objektivat, taktikat që duhen ndjekur për të siguruar barazinë gjinore.

Ka një spontaneitet rutinor, që vjen nga ideja pasive se pavarësisht ndryshimeve të kohës, tema e gruas është ajo që ka qënë. Po ato janë dhe problemet konceptuale dhe shqetësimet empirike që ato kanë. Situata në shoqërinë tonë, megjithë ndryshimet që kanë ndodhur, ka akoma shumë pengesa, të cilat gratë duhet të luftojnë që ti kapërxejnë, duke qënë të bindura për

ta bërë me vendosmëri luftën e tyre për barazi gjinore. Natyrisht që ka pengesa: Së pari të jashtme, që vijnë nga paragjykimet gjinore të shoqërisë tonë që është me substrat të fortë maskilist e patriarkal, dhe së dyti, pengesat e brendshme, që lidhen me konceptete, mentalitete dhe paradigmat gjinore që kanë gratë për veten e tyre.

Sepse akoma nuk është bërë pjesë integrale e kulturës sonë, mënyra e të menduarit që integron në sjelljen sociale një “dimension gjinor” të qartë. Rolet gjinore tradicionale, të cilat janë ende të forta dhe të përhapura në shoqërinë shqiptare, janë pengesë për gratë, barazinë gjinore dhe evidentimin e plotë të “rezervave të femërores” në shoqëri dhe familje. Kështu që është koha të flitet edhe për çështje të tjera, akoma më të holla gjinore, sikurse janë çështjet shqetësuese të rritjes së përmasave të divorcit, zgjerimi i epidemisë sociale të shthurjes së martesës, liberalizimit in extremis të seksualitetit përmes përhapjes së ideve dhe pranimit si normë e postmodernitetit të kakofonisë së marrëdhënieve seksuale, problemet e “reja” të orientimit seksual, të cilat në një farë mënyre lidhen me botën e femrës, më të drejtat e saj integralisht humane.

Kjo është arsyeja pse besoj që edhe kjo konferencë e nderuar e organizuar nga Komuniteti Mysliman, ka mundësi të japër kontributin e vet në mënyrë që të mund të ndajmë fenomenet që janë thelbësore por dhe ato që janë operative. Situata e grave në shoqërinë tonë është e tillë, që nga përmasat, gjërësia dhe intensiteti, problematika e barazisë gjinore ka peshë sociale, e përshkon tejprtej shoqërinë, që prek direkt apo në mënyrë të tërthortë të gjithë shtresat e shoqërisë. Sepse kemi në shoqëri që kultivon pabarazinë e situatave gjinore, që cënojnë të drejtat e grave, si pjesë integrale e të drejtave të njeriut.

Gjithnjë e kam shqetësimin që duhet treguar kujdes kur bëjmë dallimin e qëndrimeve tradicionale, moderne e postmoderne në trajtimin e kësaj teme. Sepse ka gjëra që janë

thelbësore e mbipërcaktuese për botën e femrës në tërësi, ashtu sikurse ka shumë probleme që janë kalimtare e operative, që lidhen me qëndrimet individuale e sjelljet e personalizuara të grave konkrete.

Ndaj duhet të studiojmë shkaqet, pengesat që determinojnë këtë pozitë sociale të diskriminuar të femrave në raport me privilegjet gjinore dhe jo vetëm që kanë meshkujt në shoqërinë tonë. Kjo do të thotë që të mos merremi me fjalë të kota por të përcaktojmë politika dhe masa sociale, që shmangin shkakun duke krijuar medoemos “kushte të jashtme të lirisë”, të cilat në shoqërinë e vërtetë demokratike, janë të njëjta si për burrat dhe për gratë.

Ndaj sfida për të zhveshur shoqërinë nga korraca e seksizmit dhe ideologjia e dominimit mashkullor, është detyrë e dorës së parë. Ajo mbetet imperative. Gratë kanë qënë dhe akoma në një masë të dukshme janë përballë sulmit frontal dhe “solidaritetit maskilist”, i cili ka qënë dhe vazhdon të mbetet një forcë e madhe me natyrë ideologjikisht antifeministe, që përdoret si argument për të vërtetuar rolin dhe rëndësinë primordiale të meshkujve.

Çfardo fjalësh të themi dhe sado të mburremi për progresin që kemi shënuar në betejën e gjatë për barazi gjinore, duhet të pranojmë se nuk ka ndryshuar sa duhet esenca sociale e raporteve gjinore midis femrave dhe meshkujve, sepse ende shoqëria jonë mund të tipizohet pa frikë si shoqëri e stratifikuar mbi bindjen dhe parimin funksionues të “elitizmit mashkullor”. Ky paragjykim marginalizues ka rënduar dhe vazhdon të rëndojë mbi gruan, pozita sociale e së cilës është interpretuar gjithnjë duke u nisur nga ndikimet degraduese që ka patur kjo paradigmë.

Në debatin që zhvillohet në shoqërinë tonë shpesh ka konfondime konceptuale dhe nominale të problemit të barazisë gjinore. Kjo nuk është çështje e thjeshtë, as problem terminologjik. Ka një konceptim jo gjithnjë të drejtë, sepse kjo

çështje nuk shikohet si tregues esencial, derivat i të drejtës së njeriut, por shikohet si një problem i jashtëm, të cilin shoqëria duhet t'a garantojë për femrat më shumë si “detyrim” dhe “lëmoshë”.

Kjo është arsyeja që ka një inerci konceptuale nënvleftësuese e shqetësuese që “prodhon” diskriminim, pabarazi, inferioritet për femrën. Problemet konsiderohen simbolike dhe trajtohen me raste të veçanta. Ky qëndrim ka një fundament social negativ antifeminist, që bëhet pengesë në rrugën e vazhduar të emancipimit social të shoqërisë. Kultura e dominimit të mashkullit në politikë, shoqëri, ekonomi dhe familje është ende shumë e fuqishme.

Lufta për barazi të vërtetë gjinore duhet të bëhet pa hipokrizi, pa maska dhe frazeologji iluministe. Mbi të gjitha jo si tolerancë dhe mëshirë burrash në shoqëri, familje, politikë, shtet apo pushtet.

Gratë dhe “demokracia shtëpiake...”

Tejet shqetësuese është gjithashtu optika sociologjike, mënyrat empirike si trajtohen problemet e gruas në familje. Ato shikohen dhe vlerësohen në mënyrë të fragmentuar. Zakonisht kur shtrojmë problemin e “barazisë gjinore” të gruas, analizën e reduktojmë tek pabarazitë sociale, me të cilat përballlet në dy këndet publike të “trekëndëshit diskriminues”, në jetën politike dhe situatën ekonomike. Fare pak vlerësojmë problemin kompleks të pabarazisë në “këndin e tretë” të këtij trekëndëshi, që ka të bëjë me rolin dhe pozitën e tyre në raport me “demokracinë shtëpiake”, pozitën, statusin gjinor të gruas në familje. Kjo nuk është harresë sociologjike. Ideja e diferencimit, padrejtësisë seksiste që gjelojnë në familjen shqiptare, janë “plagë të vjetra” të shoqërisë, shumë të forta, e kalcifikuara nga mentalitetet e së kaluarës.

Shoqëria dhe qytetërimi ynë ende janë të frymëzuar nga “ideologjia maskiliste”, tërësisht djallëzore, me qëllime të maskuara për ta mbajtur gruan të nënështuar, të lidhur me “burgun shtëpiak”, por dhe mjet që përpiket të justifikojë këtë pozitë me argumente “historike dhe biologjizante”. Pozita e diskriminuar e gruas në shtëpi, nuk konsiderohet shumë si problem social dhe shoqëria jonë nuk e percepton me shqetësim këtë mentalitet sundues maskilist. Në analizat politike, sociologjike dhe mediatike që i bëhen problemit të barazisë gjinore në trajtesat janë me natyrë të vlerësimit “makro” të problemit. Dhe shumë më pak lidhur me shfaqjet e pozitës së gruas brenda mureve të shtëpisë. Në shumë punime teorike dhe shkrime gazetash, problemet e gruas trajtohen në formë të përgjithshme, jashtë realitetit tonë konkret empirik.

Ende media, shtypi, politika, opinionioni publik dhe vetë gratë, nisen në vlerësimin e situatës së barazisë gjinore në familje nga platforma e vjetër e mentalitetit tradicionalist për rolin e femrës në hapësirën familjare. Kjo kulturë diskriminuese është kuintesenca e ideologjisë maskiliste që dominon në shtëpinë shqiptare, në këtë “kështjellë” të fortë të mbajtjes gjallë të kulturës së maskilizmit. Ndërhyrjet emancipuese gjinore në këtë ambient janë të vështira, sepse “shtëpia” është mësuar që këto role tradicionalisht me destinacion biologjik dhe këtë moral të destinuar për femrën, shoqëria shqiptare e ka bërë esencë të moralit të vet. Madje këto “role grash”, i ka shenjtëruar në maksimum. Shoqëria jonë tërësisht në të kaluarën por pjesërisht edhe sot, e ka parë femrën në dy “role”: si zonjë shtëpie dhe në pozicionin edukativ të nënës. Sipas mendimit tim ky perceptim i thjeshtëzuar i rolit social të femrës është faktori më organik që sjell pabarazi sociale në familje.

Trajtimi i tillë i problemit të konceptimit të deformuar të rolit të gruas në shtëpi, determinimi kulturor në familje i përgjegjësisë ekskluzive të shërbimit dhe edukimit, është e

kondicionuar nga paradigma me të cilën vlerësojmë realitetin e vërtetë të “mundit suplementar” të grave.

Pse duhet të disfavorizohen gratë duke i ngarkuar vetëm ato me në punët dhe përgjegjësi të shtëpisë? Pse duhet konsideruar destinacion i mbyllur gjinor rritja, edukimi i fëmijëve dhe punët e shtëpisë? Pse “misioni shtëpiak” që është detyrë e përbashkët e çiftit, vazhdon të jetë mjet për marginalizimin familjar dhe social të grave? Megjithëse juridikisht femra shqiptare i ka të gjitha liritë dhe të drejtat të barabarta me burrin në jetën publike dhe botën e punës, në të vërtetë këto barazi publike nuk e japin impaktin privat tek gratë dhe shpesh kthehen në padrejtësi sociale për to, pikërisht nga që ato kanë mbi supet e tyre disa detyrime suplementare ekskluzive në familje, që bëhen pengesë në realizimin meritokratik të drejtave publike të garantuara nga ligji (megjithëse edhe këtu ka shumë probleme).

Rishikimi i “roleve gjinore”, ndryshimi i paradigmeve të vjetra të diferencimit gjinor dhe padrejtësisë sociale mbi femrat, dalja e tyre nga trekëndëshi fatal maskilist “shtëpi-guzhinë-fëmijë” është sfidë madhore për shoqërinë dhe gratë tona. Problemi nuk zgjidhet duke parë rolin e grave në familje me optikën e vjetër të funksionimit të familjes.

Padyshim, nuk është e lehtë që të krijohet një kulturë e re në këto marrëdhënie apo që të zgjerohet sa duhet hapësira e lirisë, sovranitetit të gruas në raport me burrin pa krijuar problem dhe pa dalë nga koncepti i “gruas së mirë”. Kjo do të thotë se koha moderne ka sjellë ndryshime të konceptit dhe nevojën e rishikimit të traditës patriarkale dhe nevojës së rivendosjes së “kufijve të rinj” në raportet gjinore midis burrit dhe gruas.

Zgjidhja e problemit nuk është e lehtë, prandaj dhe përcaktimi i konceptit se si duhet të sillet një grua në raport me veten dhe burrin, për të qenë në të njëjtën kohë “grua e mirë” nuk është deri në fund e qartë. Sepse nuk është e lehtë për gruan që të jetë në martesë, dhe në të njëjtën kohë të garantojë pavarësinë

sociale dhe të ruajë identitetin social nga mashkulli me të cilin ka lidhur martesë. Koncepti tradicional i gruas dhe i bashkëshortes, nuk është shkak dhe as argument që të mund të pengojë gruan që të garantojë dallimin e saj si “qenie më vete” nga mashkulli me të cilin ka intimitet dhe bashkëshortësi. Sepse gruaja është bashkëshorte por jo “pronë”, as “skllave” apo qenie e dorës së dytë në këtë lidhje bipolare. Këto determinime të tepërta për femrën nuk tregojnë fare për ndonjë cilësi të moralit të shoqërisë dhe familjes shqiptare. Përkundrazi.

Në këto kushte diskutimet për problemet e funksionimit të familjes dhe problemet e reja të trajtimit të femrës, kanë nevojë të bëhen një nga objektet sociale që duhet diskutuar si çështje publike e sociale më vete. Sepse problemet që kanë gratë shqiptare në familje nuk janë plagë individuale që i përfshijnë “disa gra”, por dimensionin është i gjërë, sociologjikisht dhe shoqërisht tejet shqetësues.

Është fjala për një ndërtim ndryshe të roleve dhe konceptim modern të përbërësve kulturorë të familjes funksionuese, të cilat duhet të jenë përtej kornizave të ngushta, arkaike të koncepteve të maskilizmit tradicional. Familja shqiptare megjithë ndryshimet që ka pësuar në rrugën e transformimit dhe demokratizimit të saj, akoma për fat të keq mbetet një “çerdhe e despotizmit” maskilist të sjelljeve të burrave mbi gratë dhe fëmijët e tyre. Çlirimi i grave nga determinimet maskiliste dhe kornizat e ngushta të rolit të tyre tradicional, nuk mund të bëhet pa çlirimin e domosdoshëm të burrave nga konceptet e deformuara, roli i tyre shpesh herë destruktiv mbi gratë dhe fëmijët e tyre.

Jemi në kohë tjetër. Gruaja nuk është në pozicion normal në familjen e demokratizuar, përkundrazi është në pozitë të marginalizuar në se si femër duhet të jetë “robinë e shtëpisë” e determinuar nga të ashtuquajturat role gjenetike dhe rrethuar nga mentalitetet maskiliste. Që të ndryshojmë pozitën sociale të grave,

që t'i ndihmojmë ato për të shmangur “mundimet e tepërta” që i ngarkon shtëpia, burri dhe shoqëria, duhet të fillojmë të ndryshojmë konceptet kulturore dhe standartet maskiliste që sundojnë në shoqërinë tonë.

Kjo nuk bëhet menjëherë pa punë dhe luftë social-educative në familje, shkollë, komunitet, media, në institucionet fetare e kudo mundemi. Në se nuk përpiqemi që në familje, shkollë, në institucionet fetare dhe jetën publike të ndryshojmë konceptin kulturor dominant për destinacionin socio-biologjik të gruas në familje, nuk mund të kemi sukses të vërtetë në fushën e barazisë gjinore në Shqipëri. Në këtë drejtim duhet të lëvizë më shumë politika, institucionet politike, Parlamenti, Qeveria, shoqëria civile, institucionet juridike e sociale për të frenuar pabarazinë gjinore në shtëpi që rëndon gratë dhe shton padrejtësitë sociale ndaj tyre.

Barazia gjinore dhe pengesat sociale

Të mos harrojmë një të vërtetë që duhet ta themi me zë të fortë tani. Në se në se duam të ndryshojmë situatën, që të mos bëjmë të njëjtat punë me rendiment të ulët dhe rezultat minimal gjinor, duhet të ndryshojmë dhe të drejtojmë “goditjen gjinore” jo në ajër dhe me frazeologji boshe e stereotipike, por aty ku duhet. Nga viti në vit diskutimi për këtë temë ka sjellë disa rezultate, por nuk ka perceptim të ndryshuar të realitetit në mënyrë që puna të jetë adekuate me kohën, të sjellë realisht ndryshim në nivelin e barazisë gjinore në Shqipëri. Në se nuk bëjmë atë që duhet, në se nuk ndalemi në shkaqet që sjellin këtë pasojë, situata e grave ka për të qënë po ajo ose ndryshimet do të jenë përsëri të ngadalta.

Sipas mendimit tim tre janë shkaqet më themelore që determinojnë këtë pozitë inferiore të femrave në raport me meshkujt në shoqërinë tonë dhe ku duhet të përqëndrohet me përparësi shteti, politika, media dhe vetë gratë. Së pari, duhet të bëjmë gjithçka për të ndryshuar pozitën e vështirë ekonomike të

grave në tregun e punës, inferioritetin lidhur me të ardhurat që sjellin në familje për shkak të raporteve të padrejta me punën. Kjo pozitë i detyron ato që të pranojnë superioritetin financiar të burrit si “shtyllë e shtëpisë”, garant i të ardhurave për të mbajtur familjen. Papunësia e grave megjithë ndryshimet vazhdon të jetë shumë e lartë.

Së dyti, kjo papunësi gjinore ka sjellë si pasojë reduktimin e pozitës sociale të grave në misionin e thjeshtë e tradicional të “zonjës së shtëpisë” dhe detyrave e përgjegjësi të edukimit të fëmijëve. Kjo situatë po ushqen me intensitet psikologjinë që ka rikthyer bujshëm stereotipin e vjetër gjinor, që redukton rolin social të grave, duke e motivuar pozitën e tyre si qenie sociale inferiore, e destinuar të jetojë në “burgun shtëpiak” dhe të përballojë ndarjen e padrejtë të punëve të shtëpisë.

Dhe së fundi, liria e grave, të drejtat e tyre integralisht humane janë të cënuara nga fakti se mbi to ushtrohet me lehtësi dhunë fizike, verbale, emocionale pse jo edhe seksuale, nga meshkujt e shtëpisë por edhe nga ata që janë përtej kufijve të mbyllur të saj. Ky është ende realitet flagrant, tejet i shëmtuar. Lufta në këto “tre fronte” të barazisë gjinore është objektivi, pa plotësimin e të cilit, gratë nuk mund të presin ndryshime të dukshme në situatën e tyre.

Konkluzion

Sfida dhe beteja shoqërore për barazinë gjinore në shoqërinë tonë është e hapur dhe do të jetë e tillë deri kur barazia e vërtetë midis gruas dhe burrit të bëhet NORMË SOCIALE. Kjo luftë është e gjatë dhe e papërfunduar. Mbase do vazhdojë akoma gjatë derisa të krijohen kushtet e duhura ekonomike, sociale e morale në të cilat duhet të bëhet e mundur shpalosja e aftësive të gruas në familje e shoqëri!

Zenepe Dibra¹⁶ - Kontributi patriotik, emancipues dhe kultural i gruas muslimane në historinë e Shqipërisë

Gruaja shqiptare ka luajtur një rol thellësisht të gjërë dhe të gjithanshëm në historinë e kombit tonë, në luftën e madhe patriotike për çlirim kombëtar, për emancipimin e shoqërisë në drejtim të lëvizjeve arsimore, kulturore, sportive dhe në çdo fushë tjetër të zhvillimit shoqëror. Në këtë zhvillim të vrullshëm të shoqërisë shqiptare një rol të rëndësishëm ka luajtur gruaja muslimane shqiptare që krahas të gjithë grave shqiptare të religjioneve të tjera dhe në një bashkëpunim dhe bashkëveprim tolerant të respektimit të çdo ideje, ka vënë një gur brilant në edukimin patriotik, kulturor të brezave të rinj. Kjo për arsye se ato të edukuara në familjet muslimane, kanë trashëguar traditat më të mira shqiptare që në përputhje me parimet e besimit islam dhe me zakonet më të mira shqiptare, janë inkurajuar dhe motivuar për qëllimet më të mira në jetë, në drejtim të përkrahjes së luftërave për çlirim kombëtar, në zhvillimin e arsimit shqip në Shqipëri, në dhënien e shembullit të madh të zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Janë këto gra dhe nëna shqiptare muslimane që linden dhe edukuan burrat të mëdhej të kombit shqiptar me kontribute të patjetërsueshme në historinë e tij dhe personalitete në luftë, arsim e kulturë, si **Vëllezërit Frashëri, Ismail Qemali, Faik Konica Mit-hat Frashëri, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Vehbi Agolli, Hafiz Ali Korça, Daut Boriçi, Idriz Seferi, Mic Sokoli, Haxhi Zeka, Bajram Curri, Ali Pashë Guxia, Adem Jashari** e dhjetra të tjerë. Por nëqoftëse ne themi që shoqëria shqiptare ka patur

¹⁶ Dr. Zenepe Dibra, Presidente e shoqatës “Gruaja Intelktuale Shkodrane”.

vështirësitë në zhvillimin e saj, lufta e gruas ka kaluar sfida akoma më të mëdha deri në të jashtëzakonshme. Duke trashëguar një prapambetje të madhe patriarkale nga shumë kushte që kanë përcaktuar zhvillimin e saj, gruas i është dashur të përballojë sfida deri në sakrifikim duke përshkruar një rrugë sa të gjatë aq edhe të vështirë.

Kontributet në luftërat për çlirim kombëtar.

Gruaja shqiptare në përgjithësi dhe ajo muslimane në veçanti, para së gjithash mbi çdo gjë dhe para gjithçkaje, punoi dhe kontriboi për çlirim kombëtar duke kuptuar që për të fituar lirinë në shoqëri duhet hequr zgjedha e huaj që pengonte jo vetëm zhvillimin e vendit por edhe çlirimin shoqëror të saj. Kontributet e gruas në këtë luftë janë të pallogaritshme sepse ato mbështeten idealet e bashkëshortëve dhe bijve të tyre në këtë luftë, i ndihmuan dhe iu bashkuan idesë së lirisë dhe bashkimit kombëtar. Edhe kur ato nuk moren pjesë direkt në këtë luftë, ato i shëndruan banesat e tyre në spitale ambulante, mjekuan plagët në sheshin e betejës, fusha e male, rriten shkallët e shërbimit ndaj fëmijëve dhe jo vetëm të familjes së tyre por edhe të kojshive, dhe luftëtarëve të tjerë kudo ku ato ndodheshin. Këtë luftë gratë e bënë në emër të Zotit, duke marrë bekimin e tij për drejtësinë e kësaj lufte në mbrojtje të atdheut, duke rënë edhe shehid (dëshmore).

Gratë shqiptare në luftërat kundër turqve realizuan akte të larta, lavdia e të cilave jo vetëm u përmend nga opinioni kombëtar, por edhe ai ndërkombëtar. Kështu për trimëritë e tyre shkruanin gazetatat turke, greke dhe italiane duke i quajtur malësoret trime “**Amazonat shqiptare**”. Pukëvili (1770 - 1838), mjek, natyralist, diplomat, historian e arkelog francez, që njihet si historiani më i rëndësishëm i çerekut të parë të shek. XIX për Pashallekun e Janinës, do të shkruante: “*Fryma popullore ishte aq luftarake sa edhe vetë gratë ditën e rrezikut e ndanin entuziazmin e përgjithshëm duke luftuar shpesh krah për krah me burrat,*

vëllezërit dhe fëmijët e tyre". (1) Në rezistencën që u bënë shqiptarët forcave turke të Dervish Pashës në Malësinë e Gjakovës, në mbrojtjen e Ulqinit dhe në betejën e Slivovës kontribut të pashoq dhanë edhe gratë e fshatrave të këtyre rrethëve.

Në rrjedhjen e gjithë ngjarjeve luftarake të zhvilluara gjatë organizimit të Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren më 10 qershor 1878 pranë luftëtarëve trima, si: Sulejman Vokshi, Shuaip Spahiu, Mic Sokoli, Ali Ibra e tj, qëndruan heroikisht edhe gra trime të Kosovës, Dibrës dhe krahinave të tjera të Shqipërisë. Në luftërat për autonominë kombëtare të kësaj periudhe gratë e këtyre anëve jo vetëm që ishin aktive por morën pjesë drejtpërdrejt në aksione luftarake. Në vargjet e këngës popullore këndohet trimëria e motrës së luftëtarit të shquar nga Rugova, **Zhuj Selmanit**:

*"Jakup Ferri kur ka liftue
Katër vetë i ka pre një grue
S'a kenë grue por a kanë ni çikë
Motra e Zhujës qafë kapricë
Katër vetë i preu n' sakicë"* (2)

Kontribut të madh kanë dhënë edhe gratë kosovare të Karadakut, në luftën e Grykës së Kaçanikut (prill 1910) ku është zhvilluar një betejë e madhe nën drejtimin e Idriz Seferit, kundër ushtrisë osmane të kryesuar nga Shefqet Turgut Pasha. Një ndër këto gra ishte **Baftie Seferi**, bashkëshortja dhe bashkëluftëtarja e denjë e prijësit Idrizi Seferit, nënë e 12 fëmijëve, e cila përkrah të shoqit dhe me gratë e krahinës luftoi në frontin e luftës, duke iu siguruar trimave municione, duke mjekuar plagët dhe duke gjurmuar lëvizjet e armikut. Rapsodi popullor e lartësoi me këngë:

...

*Kaçaniku paska lëshue
Kur ka ba per me u farue*

Duel Kosova burr e grue




Baftie Seferi, bashkëshortja dhe bashkëluftëtarja e denjë e prijësit Idriz Seferit, nënë e 12 fëmijëve

Vetë Idriz Seferi, ky luftëtar i guximshëm i luftërave të përgjakshme kundër turqve, më

parë kishte vlerësuar kontributin dhe rolin e grave dhe fëmijëve shqiptarë duke thënë: *“Pa gra nuk ka dyrnja, pa fmi nuk ka Shqipni”* (3)

Një grua heroike në luftërat për çlirim kombëtar ishte **Sado Hamza Koshena**(1855-1955)

Me thirrjen e Qeverisë së Ismail Qemalit, më 27 dhjetor të 1912, së bashku me dy djemtë e saj Bejan dhe Metën, mbasi kishte ngjeshur gjerdanin me fishekë dhe mauzerin në dorë luftoi në Llogara kundër forcave greke që kishin zbritur në Himarë dhe që synonin të zgjeronin zonën e tyre të pushtimit. Edhe kur ishte në moshën 65 vjeçe, ajo ishte vullnetare në çetën e Dukatit me tre



djemtë e saj. Shkon me çetën prej 13 vetësh që e drejtonte vetë, në Llogara ku më 4-5 qershor të 1920 shpartallojnë një garnizon italian. Ajo ditën luftonte me çetën kurse në mbrëmje shkonte në Dukat ku merrte armë e municione për çeten e saj. Pas dorëzimit të garnizonit italian më 8 qershor 1920, Sadoja me 12 qershor niset në Drashovicë për të marrë pjesë në çlirimin e Vlorës, ku aktivizohet në disa përpyekje derisa u çlirua Vlora. Një nga luftërat më të përgjakshme ku ka marrë pjesë Sadoja është lufta në malin e Shushicës më 18-19 korrik 1920 kundër hordhive italiane. U dallua për guxim dhe trimëri të rrallë në luftën e Qafës së Prallit (afër Dukatit) dhe si shembull kurajoje dhe frymëzimi.**(4) (5)**. Gratë muslimane kanë dhënë kontribute kolektive në luftën heroike për çlirim kombëtar, jo vetëm në pjesëmarrjen e drejtë përdrejtë në këto luftëra së bashku me gratë tjera simotra por edhe si familje ku dallohen ato të familjes së Buletinëve dhe familjes Jashari në Kosovë.

Heroizmi i grave të familjes Boletinëve në Mitrovicë të Kosovës është një rast i rrallë kur një familje, jo vetëm burrat dhe djemtë, por edhe gratë qëndrojnë stoike në mbrojtje të çështjes kombëtare, duke kaluar peripecitë më sublime të një qëndrese të pashembullt. Ishin gra të thjeshta, malësore të fshatit Boletin të Mitrovicës (Kosovë) që vunë gjithçka për çështjen kombëtare: familjen, pasurinë, fëmijët, burrat, pa ju mposhtur kurrë karakteri i tyre fisnik. Gjashtë herë ju djeg kulla e tyre, në 1750, 1830 për të vazhduar më 1892, 1895, 1908 dhe 1912. Pasi ja dogjën dhe plaçkiten shtëpinë, ato u bajtën me fëmijë në krah, ashtu të dërmuara dhe të stresuara, por krenare për shërbimin ndaj atdheut. Morën rrugët për t'u strehuar në shtëpitë tjera të fshatarëve që i përkrahën pa masë. E përcollën Isa Buletinin në luftëra, beteja të përgjakshme, deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë kur ai shkon si përfaqësues i Kosovës për ngritjen e flamurit në Vlorë.

Tentuan t'i largonin, t'i internonin, por, **Qamilja**, bashkëshortja e Isa Boletinit, vuri para serbëve bidonin me vajguri duke preferuar më mirë djegjen gjallë të robërve të saj se sa daljen nga shtëpia. E mbi të gjitha qëndronte si burrneshë **nëna e Isait - Ajshe Boletini**, gruaja, nëna shqiptare, që krahas punës që bënte si bashkëshorte dhe si nënë, mbante të ndezur në shpirtin e saj patriotizmin e flaktë. Nënë Ajsheja ishte shembull tipik i gruas shqiptare, një grua malësore e thjeshtë, trime dhe e mençur, që në momentet më të vështira të luftës kundër turqve dhe serbëve, u qëndroi afër bijve të saj duke u dhënë kurajo, ndihmë materiale, shpirtërore, në përkujdesje të plagëve të tyre që merrnin herë pas here në beteja. E paepur si gjithnjë, me kobure në brez që nuk e lëshoi kurrë, ishte ajo që qëndroi stoike përballë mizorive që armiku i bëri kullave të Boletinëve. Ajo inkurajoi gratë dhe fëmijët e familjes, duke qëndruar denjësisht e vendosur në përkrahje të luftës që bënin bijtë dhe njerëzit e saj kosovarë, pa ju trembur syri dhe pa marrë parasyshë vështirësitë që i shkaktoi kjo qëndresë. Shumë rapsodë popullorë i kushtuan vargje kësaj nëne të paepur:

*Isa begu del në kep
Si rrufeja po pisket
Hej moj loke, mos ki dert
Qëndro loke e ban gajret
Kena le na per me dek... (6)*

Në luftën kundra malazezëve dhe serbëve që më 1912 rrethuan dhe sulmuan Shkodren dhanë kontribut shumë gra muslimane. Tregohet se **Halime Hasani** në Malin e Kakarriqit lë vdekur për tokë dy sulmues malazezë. Por në këtë luftë gratë kanë luajtur role të ndryshme jo vetëm në ballë të luftës krah për krah me burrat dhe vëllezërit, por edhe në prapavijë, si zbuluese, në ndihmë të plagosurve, etj.

Lufta e grave të Vlorës, (me pjesëmarrjen edhe të shumë grave të tjera nga Gjirokastra, Mallakastër, Elbasani), nga Dukati, Smokthina, Bolena, Salaria, Tragjasi kundër italianëve më 1920,

përbën një epopë të lavdishme të shkruar me gërma të arta në historinë shqiptare, ku u dallua jo vetëm **Sado Koshena** por edhe **Safe Musai** nga Salaria e Tepelenës, kunata e heroit Selam Musait, e cila kur përcolli kunatin për në Smokthinë, mobilizoi gjithë gratë e fshatit për të ndihmuar luftëtarët në llogore. **Zekije Krasta**, grua patriote nga Elbasani dhe infermierja e parë e këtij qyteti, mori pjesë gjallërisht në rradhët e vullnetarëve për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë më 1920 dhe ishte infermiere në ekipin shëndetësor që mjekonte në fushën e betejës luftëtarët e plagosur. Kur mëson se i vritet i biri, ajo rrëmben pushkën dhe rreshtohet në vendin e tij. (7).

Lahe Rexhepi nga rrethi i Kukësit, përkrah vëllait të saj luftoi me heroizëm të rrallë kundër pushtuesve italianë më 1919, që pas Luftës së Parë Botërore, përpiqeshin të mbanin të pushtuara tokat e Shqipërisë.

Rast i rrallë ka qenë bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në jetë por më e rëndësishmja edhe në luftë e **Shote Galicës** me bashkëshortin, **Azem Galica**, që gjithë jetën ia kushtuan luftës për lirinë e Kosovës. **Shote Galica** për 12 vjet rresht luftoi kundër pushtuesve serbë, austro - hungarezë e bullgarë. Mori pjesë në 60 operacione luftarake për dymbëdhjetë vjet luftime në aksione kundër armikut duke treguar një heroizëm të rrallë.(4), (8). Edhe vajza e **Mazllum Qafa, Sulltanja** nga fshati Qafë të Gostivarit tregoi një trimëri të rrallë në luftën kundër serbëve sepse me gërshërë mbyti dy xhandarë serbë.(9) Një rast i ngjashëm me çiftin luftëtar **Shote dhe Azem Galica**, do të përsëritet në Luftën e Kosovës së vitit 1998, kundër forcave serbe, ku **Xhevë Lladrovci** (1955-1998), një intelektuale e shquar Kosovare me dy fakultete gjuhë letërsi shqipe dhe shkenca juridike do të binte dëshmore së bashku me bashkëshortin e saj **Fehmi Lladrovci**, më 22.09.1998, në afërsi të fshatit Shkabë (ish Gllanasellë). Pas rënies SHP(shtabi i përgjithshëm) i UÇK, i dha gradën gjeneralkolonel (10)

Pjesëmarrja në Luftën Nacionalçlirimtare ka qenë pjesëmarrja më masive, më e organizuar dhe më heroike e grave shqiptare në luftërat për liri e çlirim shoqëror. Aty u shfaq një heroizëm masiv i të rejave, që luftonin krah për krah me partizanët, i grave që ndihmonin dhe organizonin, që merrnin pjesë në demonstrata dhe aksione, i nënave që frymëzonin bijtë duke i kthyer shtëpitë e tyre në baza të lëvizjes. Në shumë lagje të qyteteve, në shumë komuna dhe fshatra u ngritën këshillat antifashiste si dhe organizatat antifashiste të të rejave dhe grave. Shumë shkolla fëmërore dhe të përziera u kthyen në qendra të propagandës antifashiste ku roli i të rejave shqiptare ishte i konsiderueshëm në aktivitete, si: greva, protesta dhe demonstrata. Ranë në këtë luftë në mes shumë heroinash edhe shumë vajza të reja muslimane, të shpallura **“Heroina të Popullit”**, si : **Shejnaze Juka, Bule Naipi, Ylbere Bilibashi, Qeriba Derri, Inajete Dumi, Fato Berberi, Mine Peza**, kurse në Gjakovë të Kosovës do binte dëshmore **Ganimet Tërbeshi. (11)**

Pjesëmarrja e gruas dhe vajzave kosovare në luftërat e viteve 1998-1999, në UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës), kur forcat serbe kryen masakrat më të mëdha ndaj popullsisë kosovare, ka qenë një nga pjesëmarrjet më aktive, më e ndërgjegjshme, më e organizuar dhe më heroike e gruas kosovare. Mbas krijimit të kësaj force luftarake në të morën pjesë si formacion i rregullt ushtarak edhe afro 200 gra dhe vajza, (statistikat e rregullta mungojnë). Shumë gra dhe vajza bënë rezistencë në shtëpitë e tyre në mbrojtje të fëmijëve dhe të afërmëve duke i kthyer kullat e tyre në fuçi baruti. Jo vetëm ato që morën pjesë direkt në luftë, por shumë gra dhe vajza ndihmuan në mënyra të ndryshme ushtrinë çlirimtare të Kosovës, duke i kthyer shtëpijat e tyre në baza të luftës, të furnizimit me ushqime e municione, në shtëpi ambulante të mjekimit të plagosurve. Në këtë luftë kanë rënë dëshmore shumë gra dhe vajza. Ato që kanë marrë statusin e dëshmores janë mbi 40.

Në këtë luftë një rast të rrallë dhe heroik treguan gratë e **familjes Jashari**, kur serbët më 1998 sulmuan kullat e tyre. Nga fisi i Jasharëve në luftën kundër serbëve, në vitin 1998, në mësymjen që serbët u kanë bërë kullave të tyre, janë vrarë 48 persona. Nga familja e ngushtë e Adem Jasharit, në mars të 1998, janë vrarë 20 vete, prej të cilave 12 gra e vajza (midis tyre 3 të mitura): si *Adilja (40 vjeç)*, *Afetja (17 vjeç)*, *Blerina (7 vjeçe)*, *Feridja (43vjeçe)*, *Fatimja (9vjeçe)*, *Hidajetja (18vjeçe)*, *Igbalja (11vjeçe)*, *Lirija (14vjeçe)*, *Selvetja (20vjeçe)*, *Valdetja (15vjeçe)*, *Zahidja (74)*, *Zarifja (49vjeçe)*. **(1)**. E para ndër gratë është vrarë **Adilja**, e shoqja e **Adem Jasharit** duke i dhënë municion Ademit. Pastaj, me një predhë topi të kalibrit të madh, janë goditur përnjëherë të gjithë. Këto gra nuk kanë pranuar të dalin jashtë rrethimit që u kanë bërë serbët megjithëse u është afruar një gjë e tillë, duke deklaruar se ne nuk na duhet jeta pa burrat dhe fëmijët tanë. Ka qenë një rast i pashembullt i trimërisë, besës, bashkimit, unitetit dhe sakrificës së gruas kosovare kundër armikut. Këto gra, vajza të reja adoleshente dhe të mitura shkuan më tej se trimëria e Oso Kukës me shkodranët e tjerë që u vetflijuan në kullën e Vraninës, duke treguar se në luftë kundër armikut edhe pse janë gra, nëna, motra dhe bija vetflijohen në këto akte sublime pa ju dhimsur jeta, rinija dhe fëmijëria.

Një nga gratë e shquara të fisit Jashari në Kosovë e cila dha një kontribut të jashtëzakonshëm në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ishte edhe **Salë Jashari**. Ajo ishte grua e thjeshtë, e lindur në Kopiliç të Mileshit dhe e martuar me Hamit Jasharin në Prekaz të Drenicës. Gjatë aktivitetit të UÇK ajo u dha një ndihmesë ushtarëve që luftonin në male duke iu larë rrobat, duke i furnizuar me ushqime dhe materiale që u nevojiteshin. Shtëpia e saj ka qenë një nga bazat më të rëndësishme të UÇK ku anëtarë të kësaj ushtrie, me në krye Adem Jasharin, organizonin takime, mbledhje dhe kordinonin aksionet luftarake. Në mars të 1998 ajo ra heroikisht në kullën e saj në

Prekazi, duke luftuar me armë në dorë kundër serbëve në mbrojtje të lirisë, truallit të vet dhe Kosovës. Nga populli i Kosovës u quajt *“Tringa e Prekazit”* (12).



Kulla e Jasharëve, kthyer në monument historik të shqiptarëve kundër barbarisë serbe, ku u sakrifikuan edhe 12 gra, vajza dhe fëmijë të familjes Jashari.

Rezistencë të pashoqe kanë bërë gratë muslimane të krahinave veriore dhe verilindore nga gjenocidi serbo-malazez, gratë çame nga gjenocidi grek, nga persekutimi i pamëshirshëm komunist.

Gjenocidi serbo malazes ka qenë me vite një inkursion i këtyre forcave shoviniste që torturuan, vranë dhe përdhunuan me mijëra gra shkodrane, dibrane, matjane. Ky gjenocid do të arrinte kulmin në vitet 1998-1999, kur ato jo vetëm tentuan t'i largojnë nga vendi por edhe t'i torturojnë duke iu vrarë burrat, fëmijët, motrat e vëllezërit, duke i djegur shtëpitë, duke i plagosur dhe vrarë vetë ato duke kaluar edhe në aktet më çnjerëzore me therjen e fëmijëve në bark të nënave shtatzëna. Ato me forcen e një morali që i ka karakterizuar ndër shekuj dijen t'i përballojnë këto situata, për të mbetur si heroina të kombit tonë në ballë të një historie që do nuk do harrohet kurrë.

Gjenocidi ndaj popullsisë çame ku vuajtjen më të madhe e pësuan gratë muslimane të këtij komuniteti, të larguara me forcë nga trojet e tyre si Paramithi, Filati, Spatari, Voshtina, Parga, Margllëçi, Solopi, Gumenica, etj., që i pashembullt në historinë populjeve. Gratë u përdhunuan në mënyrë masive dhe individuale, në sy të fëmijëve, burrave dhe njerëzve të tjerë. Ato u rrahën, u varen, u pushkatuan pa marrë parasysh moshën që nga 12 vjeçe e deri në 70 vjeçe. Por ato qëndruan stoike këtyre masakrave, ato rezistuan duke i edukuar fëmijët e tyre me traditat e guximit, trimërisë dhe patriotizmit shqiptar që kurrë mos ta harrojnë vendin e tyre dhe origjinën nga kanë ardhur.

Por për afro 50 vite, gjenocidi komunist do ishte ai që do të rrëronte shumë gjëra në karakterin e shqiptarit e sidomos të gruas nënë, bashkëshorte, motër. U vranë, u plagosen, u internuan u futën në burgje me qindra gra. Sipas të dhënave nga 5157 të vrarë nga diktura 89 ishin gra, nga 952 që vdiqën në burgje 7 ishin gra. Humbën aftësinë mendore 273 njerëz prej të cilave 29 ishin gra, u burgosën si të dënuar politikisht 17900 njerëz prej të cilave 450 ishin gra; u internuan 30383 njerëz gjysma e të cilëve ishin gra dhe fëmijë. U dëbuan nga qyteti e rajone kufitare me qindra familje në mes të cilave ishin gra të reja dhe të moshuara, shtatzëna dhe të sëmura, intelektuale dhe të shquara në fusha të ndryshme. Gratë dhe vajzat e dënuara në këto vite e kalonin jetën e tyre në 23 burgje dhe 48 kampe internimi të ndërtuara në vendet më të izoluar të Shqipërisë. Me mijëra janë vajzat të cilave nuk u dha e drejta për të vazhduar shkollat e larta. Persekucion u ushtrua edhe ndaj intelektualëve muslimane, më të shquara të vendit, si: Musine Kokolarit, Drita Kosturit, Sebiha Kasematit. (1), (13)



Musine Kokalari Sabiha Kasemati Drita Kosturi

Ndër këto intelektuale Musine Kokalari konsiderohet si femra e parë që arriti t'i bëjë opozitë rregjimit komunist. Ishte pedagoge në Institutin Nana Mbretëreshë, autore e dy librave “*Rreth vatrës*” që e boton më 1944 dhe të librit “*Sa u tund jeta*”, që e botoi në janar të 1945, një nga themelueset e të parës Parti Social - demokrate shqiptare dhe një nga drejtueset e gazetës politike “*Zëri i lirisë*”. Sabiha Kasemati, e para shkencëtare jo vetëm muslimane por edhe shqiptare, ishte e para vajzë që ka mbaruar Liceun francez në Stamboll, ndër të parat vajza shqiptare që mbaron në Fakultetin e Shkencave Biologjike në Torino, më 1941. Drita Kosturi, një ndër vajzat intelektuale me një kulturë të lartë, me tre gjuhë të huaja, antifashiste dhe veprimtare e spikatur intelektuale, ishte një nga monumentet e qëndresës së gruas shqiptare ndaj persekutimit komunist. Persekutimin do ta ndiqnin edhe shumë intelektuale të tjera, si Ganimet Toptani e diplomuar në Vienë, Austri, që mban titullin e lartë mbas vdekjes “*Fisnike e drejte*” nga shteti Izraelit bashkë me bashkshortin për ndihmesën karshi hebrenjve në Tiranë. Do të kryente 3 vjet burg, i shoqi Atifi 5 vjet burg, do t'i merrej gjithë pasuria e tundshme dhe e patundshme. Familjeve Beshiri me vajza të shkolluara në Itali do i konfiskohej pasuria. Kështu Qerime (Struga) Tufina ishte shkolluar në Institutin Nana Mreteshë në Tiranë, Ballkiz

Nallbani ishte e motra e tenistit të parë shqiptarë Sali Nallban, e cila i vuri qëllim vetes duke ecur fort në hapat e të vëllait. Deri në mes vitesh 40-të Saliu dhe Ballkizja morën pjesë në shumë evenimente tenistike brenda e jashtë vendit.. Meleqe Preza mbasi mbaroi shkollën Nana Mretreshë në Tiranë vazhdoi studimet në Romë, të cilat nuk i përfundoi për shkak të luftës. Me “çlirimin” e Shqipërisë do të shërbente si mësuese, por Partia shumë shpejt do ta hiqte duke e degdisur puntore krahu tek fabrika e pllakave dhe tullave meqë kishte një vëlla të arratisur. (14)

Në tërbimin komunist, që kishte si bazë ateizimin, rezistencë të brendshme shpirtërore bënë gratë muslimane që nuk e harruan kurrë Zotin, iu luten atij, besuan tek Ai me gjithë mohimin e madh që iu bë Atij. Shumë prej tyre e falen nemazin fshehtas, agjëruan pa i treguar kuj edhe kur ishin në punë të shtetit, u luten për popullin, për gjenocidin e çnjerëzor që iu bë atij,. Në të gjithë vendin por sidomos në Shkodër gratë muslimane treguan vlera të mëdha të karakterit të tyre, duke i ndjekur burrat në burgje, duke kaluar edhe vetë me fëmijët vitet të tëra në internime, duke bërë sakrifica të paimagjinueshme për të mbajtur familjet, duke bërë edhe akte të guximit në gjyqet komuniste në mbrojtje të drejtave të shumë njerëzve. Qëndruan burrërisht gratë e familjes së Kazazëve, Pipajve, Bushatejve, Koplikeve, etj të përshkruara me shumë emocion në librat e Fatbardha (Mulletit) Saraçi, mësueses dhe shkrimtares së persekutuar, “Dhimbje 1”, Dhimbje 2”, dhe “Kalvari i grave në burgjet komuniste”.

Lufta dhe kontributi për arsim dhe emancipim

Ishte një luftë e gjatë e gruas shqiptare për zhvillim dhe emancipim. Duke ditur rëndësinë e madhe të rolit të gruas në shoqëri, në edukimin e brezit të ri dhe pjesëmarrjen e saj në shoqëri intelektualët e kohës e shtruan këtë problem për zgjidhje. Mehdi Frashëri shkruante: *“Ta bindim gruan se gjëndja e saj, po të rrijë kështu siç është, shtie në rrezik jetën e popullit”*. Kurse në

librin e tij “*Plagët tona*” që u botua më 1924, (15) ai analizoi dhe kritikoi gjëndjen në të cilën ndodhej femra në marrëdhëniet martesore, pozitën e saj të pabarabartë me burrin në familje e shoqëri, duke e konsideruar si një nga plagët më të rënda të vendit. Të gjitha këto probleme intelektualët i shtruan në disa organe të shtypit demokratik përfshirë këtu edhe organet e shoqërive të grave. Në këto organe shkruan artikuj intelektualë të shquar, si: **Mehdi Frashëri, Kristo Floqi, Nebil Çika, Ferit Vokopola, Dhimitër Berati etj.** Me romanin e tij “*Sikur të isha djalë*”, **Haki Stërmilli** vë në qender të vëmendjes vajzen dibrane Dijen, e cila vuan për të drejtat dhe çlirimin shoqëror të saj kundër zakoneve shekullore që e mbanin larg jetës. Me shpalljen e pavarësisë kombëtare populli do të fitonte atë që kishte patur ëndrrën e sa viteve: të drejtën për arsimimin në gjuhën shqipe për djemtë e vajzat e tij. Veçanarisht për femrën muslimane kjo e drejtë e mohuar prej shumë vitesh, do të ishte tashmë në qendrën e kujdesit të qeverisë së re të dalë mbas shpalljes pavarësisë. Kështu në Shkodër në vitin shkollor 1916-1921 hapen disa shkolla femërore si ajo tek Xhamia Begas, Rus, Dudas, Parrucë, etj., E para mësuese, muslimane në Shkodër që jep mësim në këto shkolla në vitin 1920, është **Seher Anamali**, bashkëshorte e Mësuesit të Popullit, Ismail Anamali. Një shembull sinjifikativ në këto vite do të japin, edhe tre mësuese muslimane, motrat **Hajrije, Meliha dhe Sanije Kraja**, të shkolluara në Stamboll dhe me një bagazh intelektual dhe emancipues të konsiderueshëm. Këto tri motra janë një shembull sinjifikativ për kontributin e tyre jo vetëm në arsimimin e qindra vajzave shkodrane, por ato punuan dhe kontribuan edhe në kurset kundra analfabatizmit ku moren pjesë shumë gra analfabete shkodrane pavarësisht nga përkatësitë etnike apo fetare. (16)



Shefikat Narazani Hajrije Kraja Shadije Bogdo

Shefikat Narazani (1898-1972), ishte mësuesja e parë në Elbasan, e arsimuar në Stamboll (17) dhe që e la atë vend për të mësuar fëmijët shqiptarë, dhe për të përhapur mësimin e gjuhës shqipe te gratë muslimane të Elbasanit. Edhe pse duke mbajtur “perçe”, ajo nuk e iu shmang asnjëherë qëllimit të saj. Jo vetëm ajo por edhe mësuese të tjera në këtë qytet, si **Alemshah Dylgjeri**, **Hajrie Saraçi (Zaimi)**, **Fadile Çeka (Dedej)**, **Zeqine Krasta**, **Mynevere Zaimi**, e të tjera, punuan për hapjen e shkrimit e leximit të gjuhës shqipe përmes mbledhjeve të grave bektashiane, në qytetin që tashmë njihet për nivelin intelektual të bektashizmit shqiptar.



Mësuesja Shefikat Narazani me nxënësit e saj dhe me shoqet e tjera arsimtare

Në fushen e arsimit vullneti i gruas muslimane pavarësisht nga konceptet patriarkale dhe idetë konservatore të shoqërisë e frenonin, arriti të tejkalojë situatën duke u bërë në shumë raste inisiatore të përhapjes së dritës së diturisë. Janë dy vajza në Shkodër **Zenepe (Golemi)Ashiku**, vajza e Hafiz Abaz Golemit dhe **Xhemaliqe (Shkreli) Gjylbegu** që të parat do të rregjistrohen në shkollën femërore të Tiranës “Nana Mbretëreshë” për të vazhduar pastaj si mësuese dhe veprimtare shoqërore. Bile Xhemaliqa do të vazhdonte edhe Universitetin e Firences në Itali, Fakulteti Letërsi-Filozofi ku si rezultat i këtij shkollimi të lartë do të ishte një zë femëror në shtypin periodik të kohës duke shkruar artikuj kryesisht për çlirimin shoqëror të gruas me pseodonimin “Posttribsja”.

Shadije Bogdo, vajza libohovite, ishte pjesëmarrëse në kongresin arsimor të vitit 1922, duke përcjellë përvojën e saj, në hapjen e të parës shkollë të vajzave në Libohovë. Në kongresin e arsimit të vitit 1924, figura e saj merr vlera, si inisiatore, organizatore e këtij kongresi. Një tjetër propozim i Shadijes, bëri të hapej më vonë Instituti “Nëna Mbretëreshë”. Kreu një punë të jashtëzakonshme në Libohovë për të çelur të parën shkollë të femrave në tetor të vitit 1920. Më 1923 ishte drejtoresha e Shkollës Femërore të Tiranës . **(18) (19)**.

Disa nga mësueset e dalluara muslimane, pishtaret e para të përhapjes së arsimit femëror mund të përmenden: Sabiha Serezi, **(Korçë)**, Hasibe Harshova, Naxhije Hoxha, Xhemile Bilali **(Gjirokastrë)**, Ikbale Çika **(Sarandë)**, Paqize Bejleri **(Vlorë)**, Shefikat (Sefa) Narazani, Alemshah Dylgjeri, Hajrie Saraçi, Fadile Çeka, Zeqine Krasta, **(Elbasan)**, Emine Shehdulla **(Kavajë)** Areti Gjata, Nazmie Pasholli **(Dibër)**, Motrat Hajrije, Sanije dhe Meliha Kraja **(Shkodër)**

Duke patur si primare arsimimin e femrës e sidomos asaj muslimane, për të rritur shkallen e ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe gruas, në Shqipëri krijohen shumë shoqata të grave ku në

drejtimin e tyre kishte mjaft gra intelektuale muslimane. Këto gra nuk krijuan kurrë shoqata me baza fetare, por me shkallen e emancipimit të tyre, ato bashkëpunuan edhe me shoqata dhe shoqe të tjera intelektuale të besimeve të ndryshme, duke punuar me një qëllim të përbashkët, me tolerancë, mirëkuptim dhe bashkëpunim. E rëndësishme ishte se ato nuk mbeten kurrë prapa në pikpamjet e tyre intelektuale, në organizmim, menaxhim të problemeve si dhe në botimin e shumë shkrimeve në shtypin e tyre periodik por edhe atë demokratik të kohës. Mbas krijimit të shoqatës së parë të grave në Korçë nga motrat Qiriazit, asaj në Vlorë dhe Shkodër, **“Gruaja shqiptare” (1920-1924)** ishte shoqëria e parë e grave e krijuar në Tiranë më 27 dhjetor 1920, qëllimi kryesor i së cilës ishte të ndihmonte gratë shqiptare të përparojnë në arsim, si dhe mbledhja e ndihmave për nevojat kombëtare të ditës. Përveç **Parashqevi Qiriazit** që ishte shpirti i kësaj shoqërie, në drejtimin e saj ndihmuan edhe **Emine Toptani, Znj. Erebara** etj., si dhe gra të tjera nga familje të pasura, si: **Libohova, Stërmasi, Toptani** etj., që herë pas here organizonin mbledhje dhe biseda me anëtarët e shoqërisë për probleme të kohës të gruas shqiptare. Kontributi i tyre për zhvillim dhe emancipim që kaq i madh sa **Emine Toptani** është vlerësuar me dekoratën “Oficer” të Urdhërit Skënderbeu, kurse **Emine Nazif Baholli** me medaljen “Kavalier” të Urdhërit të Skënderbeut nga qeveria e Zogut **.(20)**. Shoqata **“Përlindja”**, e krijuar më 6 prill 1921 në Korçë, ku kryetare kishte **Evthoksi Gërmenjin**, bashkëshorte e Themistokli Gërmenjin, kishte në gjirin e saj aktivistet muslimane, si **Humajan Dishnica, Zarife Myftiu, Vako Frashëri dhe Hajrie Pojanin**, duke u bërë kështu një nga inisiatorët e punës me gratë fshatare, si dhe duke krijuar edhe shumë degë në fshatrat Pojan, Zëmlak, Plasë, Dishnicë, Mborje, Pogradec, Bilisht, Proger, etj. Edhe në përbërjen e shoqatës “Gruaja shqiptare”, të krijuar në Shkodër më 1920, kishte në drejtimin e saj gra muslimane, si **Habibe Bekteshin, Qamile Bushati, Marta e Sadetin Begut, Adile**

Bekteshi, etj. Më 28 mars 1924, krijohet shoqata “Shqiptarka”, qëllimi i së cilës, përveç kërkesave për arsim dhe kulturë, ishte edhe ndryshimi i pozitës shoqërore të gruas dhe ngritja e personalitetit të saj në familje dhe shoqëri. Këshilli drejtues kryesisht përbëhej nga gra intelektuale muslimane me kryetare **Behixhe Elbasanin**, nënkryetare **Shadie Bogdon**, sekretare **Naxhije Vllamasin**, arkëtare **Fatime Ypin**, këshilltare: Zj. **P. Qirjazi**, **Hilmije Selenica**, **Hamide Berati**, **Qefsere Njaziu**, **Sadet Pejani**. Qëllim tjetër ishte të rriste edukatën në mes të anëtarëve dhe simpatizantëve të saj për respektimin e institucioneve dhe ligjeve, për të rrënjësuar ndër to ndjenjat dhe njësinë kombëtare. Shoqëria kishte qëllim edhe ndihmën ndaj të varfërve, mësimin e mjeshtërive artizanale tek gratë. Ajo mori edhe nismën për të organizuar krijimin e shoqërive të reja në qytete të tjera. Statuti ngarkonte këshillin e përbërë prej 9 vetësh me qëndër në Tiranë, të organizonte degët në çdo qytet. Këshilli i përgjithshëm do të drejtohej nga kryetarja, nënkryetarja, sekretarja dhe një arkëtare. Zgjedhja do të bëhej çdo vit nepërmjet votës së fshehtë. Shoqëria ka organizuar edhe disa aksione politike të kohës, si: protesta kundër vrasjes së Avni Rustemit, demonstratë në përkrahje të Qeverisë Demokratike të vitit 1924, protestën drejtuar Lidhjes së Kombeve në Gjenevë kundër ndërhyrjes jugosllave në Shqipëri etj. (21) “Çvillimi” ishte shoqëria e grave korçare e krijuar në qershor të 1922 me kryetare **Sabiha Vërlerin**. Ndryshe nga shoqëritë e tjera të grave që kishin si qëllim kryesor arsimimin e femrës, kjo shoqëri kishte edhe karakter mirëbërës. “Qëllimi kryesor i - theksohej në kanunore - është të ndihmojë materialisht nxënësit e vobektë të qarkut të Korçës”.

“Gruaja shqiptare” (1928-1938) ishte organizata më e madhe, më e organizuar e gruas në vitet 1928 - 39, me një shpërndarje të degëve në të gjithë Shqipërinë. Ajo u krijua nën drejtimin e **Sanije Zogut**, motrës së Mbretit Shqiptar, Ahmet

Zogu. Statuti iu shpërnda të gjithë prefekturave. Në paragrafin e dytë theksohej se qëllimi i shoqërisë ishin aktivitetet edukative, higjienike e të bamirësisë që do të lartësonin femrën shqiptare. Në nenet 18 e 19 caktohej rregulli i zgjedhjes së kryetares së shoqërisë e cila do të ishte gjithmonë Kryetarja e Kryqit të Kuq që do të dekretohej nga mbreti. Kjo shënonte një hap prapa me mënyrën e zgjedhjes së kryetares të shoqërive të grave gjatë viteve 1912 - 1924 ku vota e fshehtë jepte mundësira që kryetarja të zgjidhej nga vetë anëtarët. Këshilli drejtues i shoqërisë, zgjodhi kryetare **Sanije Zogun**, nënkryetare **Emine Toptani**, sekretare **Parashqevi Qiriaz**i, kontrollore **Emine Beshiri** dhe **Hilmije Selenica**, këshilltare **Ismiha Alizoti**, **Marie Serreqi** dhe **Nedime Delvina**. Kjo shoqëri në prill të 1929 krijoi degët e saj edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, si Elbasan ku kryetare ishte **Faikat Karagjozi**, , në Pogradec me kryetare **Vixhdan Xh. Starova**, Berat me kryetare **Evdhoksina Mamushin**, në Shkodër me kryetare **Qamile Bushatin** dhe sekretare **Ilda Melgushin**, në Gjirokastrë me kryetare **Urani Rumbon**, në Korçë **Aleksandra Tashko**, në Durrës me kryetare **Hatixhe Siri Leskovikun**. U formuan degë edhe në Vlorë, Bilisht, Fier, Delvinë, Kavajë, Lushnjë, Libohovë, Burrel, Kukës, Peshkopi etj., gjithsej 20 degë. Shoqëria “*Gruaja shqiptare*”, organizimi më i lartë i gruas deri atëherë, kishte edhe një degë në Bullgari, me qendër në Sofje, me kryetare **Qanie Asllanin**. Këshilli i përgjithshëm i shoqërisë “*Gruaja shqiptare*”, i kushtoi kujdes edhe lidhjes me lëvizjen femërore ndërkombëtare. Nënkryetarja e shoqërisë në Tiranë, **Emine Toptani**, kryesoi delegacionin e parë panballkanik të grave që u zhvillua në Athinë. Gratë e angazhuara në shoqëritë e grave për herë të parë nxorren edhe revistat e tyre ku shtronin problemin e emancipimit të grave. Një ndër më të rëndësishmet ishte revista “**Shqiptarja**”, organ i shoqërisë mbarëshqiptare të gruas, “*Gruaja shqiptare*” e cila u bë një tribunë e problemeve reale që shqetësonin në atë kohë gruan shqiptare, duke i paraqitur

si probleme të kombit shqiptar që koha kishte ardhur, t'i sillte në vëmendje. Revista, doli në fund të vitit 1929. Kjo revistë vazhdoi të botohet deri më 1933, me 18 numëra. Qëllimi, siç shkruhet në numrin e parë të saj, ishte fillimi i një përpjekjeje për të ngritur lart vendin e gruas shqiptare, duke mbrojtur të drejtat e saj dhe duke i dëftuar udhën që duhet të ndjekë. Drejtoreshë dhe përgjegjëse e botimit të kësaj reviste ishte **Emine Toptani**. Shumica e shkrimeve të revistës mbanin autorësinë e intelektualëve të shquara të asaj kohe, si të **Sevasti Dakos, Parashqevi Qiriazi, Kaliopi Plasarit, Ikbale Çikës, Afërdita Erbapit, Emine Toptanit** etj. Por në revista dhe gazetë të kohës kanë shkruar edhe **Selvxhe Broja**, me pseudonimin *Kolombja* si dhe **Xhemaliqe Shkreli** me pseudonimin "Postrribsja".

Një problem që shtrohej para grave muslimane ishte heqja e perçes, zakon ky aziatik i imituar edhe nga gratë muslimane shqiptare. Problemi për heqjen e perçes është ngritur nga rilindasit e shquar Naim dhe Sami Frashëri qysh në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Në fillim të viteve 20, në kuadrin e demokratizimit të jetës së vendit u ngrit problemi i mbulimit të femrës me ferehe dhe perçe si një problem shoqëror që pengonte zhvillimin dhe emancipimin e saj. Kjo në fillim u ngrit në gazetën "*Drita*", të Gjirokastrës, revistën "*Agimi*" të Shkodrës, në organe të tjera si "*Paqja*", "*Bashkimi*", "*Dielli*" etj. Ngritja e problemit të perçes u shtrua edhe nga lëvizja reformatore brenda komunitetit mysliman duke theksuar se perçja nuk është e përcaktuar në normat e kuranit. Po kështu ky problem është ngritur edhe në seancat parlamentare të Parlamentit shqiptar të vitit 1923, ku deputetët **Ali Këlcyra, Bahri Omari, Stavro Vinjau, Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Hilë Mosi** ngritën çështjen e veshjes së gruas me ferehe e sidomos mbulimin e fytyrës me perçe. Në periudhën e Qeverisë Demokratike të Fan Nolit, nuk u arritën të zgjidheshin shumë probleme të gruas si dhe heqja e perçes, megjithëse shtypi i përparuar i asaj kohe nuk rreshti së shkruari për këtë problem.

Më 1929 një nga promotorët e lëvizjes për heqjen e perçes ishte edhe kryetari i Komunitetit Mysliman i asaj kohe, **Bexhet Shapati**, i cili u përkrah nga intelektualët e kohës, klerikë të tjerë përparimtarë , nga kryetari i bashkisë së Gjirokastrës **Sami Kokalari**, kryetari i Bashkisë së Tiranës **Selaudin Blloshmi**, ministri i drejtësisë **Hiqmet Delvina**. Ky propozim u përshëndet dhe u mor parasysh edhe nga Qeveria e Zogut, që më 14 gusht 1929 nxori vendimin sipas të cilit ndalohej qarkullimi i grave nepër rrugë zbathur dhe të mbuluara nga koka në këmbë me ferexhe. Për zbatimin e këtij vendimi qeveria urdhëronte autoritetet e vendit, që të gjithë ato prindër vajzash dhe burra grash që do të guxonin t'i nxirrnin gratë me ferexhe e symboluar, të ndëshkoheshin. Vendimi i qeverisë nuk u shtrua në parlament për të marrë formë ligjore në mënyrë që popullsia të përgatitej për këtë vendim. Më vonë, me që ky vendim nuk gjeti zbatimin e duhur, nën ndikimin e forcave demokratike, të shtypit dhe intelektualëve të shquar myslimane, qeveria shtroi në parlament projekt-vendimin për të marrë formë ligjore. Kështu më 9 mars 1937, Mbreti Zog, mbas aprovimit në parlament, dekretoi ligjin me shtatë nene ku guas i ndalohej dalja me perçe, duke lënë jashtë ligjit, ndalimin e ferexhesë. Në këtë ligj gjobiteshin deri në 500 franga ari të gjithë kundravajtësit. Këtë vendim e përshëndeten edhe shumë intelektualë muslimanë shkodranë ku **Xhemal Naipi** mbajti një fjalim, ku cilësoi që në Kuran fytyra nuk quhet *auret* (mbulesë) (21). Gjithashtu 90 gra muslimane shkodrane, me prirje intelektuale, gra të nëpunësve të Qeverisë Zogut i dërgojnë Mbretit Zog një letër falenderimi dhe mirënjohje për përpjekjet që ai po bënte për emancipimin e femrës muhamedane.



Parakalimi i grave që hoqën të parat perçet në Shkodër

Shoqëria “*Gruaja shqiptare*” javën e dytë të muajit mars e shpalli “*Festë të Shqipërisë*” në përkujtim të datës historike për heqjen e perçes. Me këtë rast ajo organizonte koncerte, ditë pazari me punimet më të mira të dorës, konferenca të ndryshme etj.

Një punë të madhe kanë bërë gratë mësuese dhe aktiviste të shoqatave të grave në drejtimin e kurseve kundër analfabetizmit ku gratë muslimane ishin të parat që i ndoqen ato, për të hequr këtë plagë shekullore të mungesës së arsimit të tyre. Në periudhën 1925-1938, princeshat, motrat e mbretit Ahmet Zogu luajtën një rol emancipues në shumë zhvillime social –kulturore të asaj kohe në vendin tonë, ku moren edhe drejtimin e disa sektorëve. Kështu **Sanije Zogu**, ka qenë e ngarkuar me detyrën e drejtimit të Kryqit të Kuq Shqiptar. Në këtë organizatë ajo dha ndihmesë për strehat vorfnore të fëmijëve të varfër dhe jetimë. Më 1928, me një urdhëresë të qeverisë së Zogut dhe nën drejtimin e saj ajo krijon shoqatën “*Gruaja shqiptare*”, organizimi më i madh i deri atëherëshëm i gruas shqiptare, degët e së cilës u përhapen në të gjithë Shqipërinë. **Myzejen Zogu**, princesha që iu caktua

ndjekja dhe zhvillimi i sporteve në vendin tone, dha një ndihmesë për ngritjen e kësaj veprimtarie në të gjithë Shqipërinë; **Ruhije Zogu**, princesha që ndoqi zhvillimin e arteve në Shqipëri, duke marrë pjesë dhe inkurajuar shumë veprimtari artistike të vendit, si: ekspozita, shfaqje teatrale etj. Me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1937, ajo organizoi të gjithë aktivitetet artistike që u bënë me atë rast. Po kështu ajo ka inaguruar në Tiranë objektin “*Monumenti i lirisë*” i pari i këtij lloji në vendin tonë deri atëherë. **Maxhide Zogu**, princesha që ndoqi problemet e zhvillimit të turizmit në vendin tonë dha ndihmesën e saj në ngritjen e shumë pikave turistike dhe ideoi perspektivën e zhvillimit të tij në të ardhmen. Pavarësisht detyrave që i ka ngarkuar oborri mbretëror, nga dokumentë të shumta tregohet se ato kanë marrë përsipër shpesh herë edhe organizimin e aktiviteteve dhe marrjen e iniciativave të përbashkëta ku mund të përmenden: vizitat dhe ndihmat që kanë dhënë në zonat e jugut me rastin e tërmetit të vitit 1930, vizita në Amerikë në vitin 1938 (ku janë pritur edhe nga Faik Konica, Fan Noli, si dhe presidenti i Amerikës Franklin D. Rusvelt), organizimin e aktiviteteve të përbashkëta bamirësie, inagurime shkollash, garash, festash, organizim mbrëmjesh, etj. Së bashku princeshat kanë organizuar edhe gara me kuaj në Durrës.(1)



Në kurset kundër analfabetizmit

Një punë të madhe në këtë periudhë ka bërë **Ikbal Çika**, gazetarja e parë shqiptare dhe e para pronare femër (botuese) e revistës ekonomike-letrare “Java” në 1937. Ishte intelektuale e shquar, gazetare me penë të mprehtë, publiciste që zë një vend shumë të rëndësishëm në historikun e gazetarisë shqiptare. Ajo ka qenë kryeredaktorja dhe administratorja e parë e gazetës “Arbëria”. Nga pasioni i madh për shtypin, ajo mori përsipër përgjegjësi akoma më të mëdha duke u bërë pronare e disa revistave, si: “Java”, “Shpresa Kombëtare”, “Ylli i Mëngjesit” dhe “Gruaja Shqiptare”. Ishte gazetare aktive me funksione drejtuese

te revista “Minerva”, si edhe në disa të tjera të përkohshme, si: “Arbenia”, “Rilindja e Arbërisë”, “Vullneti i Arbërisë” etj. Ikbajla dha një kontribut të rëndësishëm për ngritjen e nivelit arsimor, edukativ e kulturor dhe sidomos atij emancipues për gratë dhe vajzat.(1)(22)

Ikbaj Çika



Mbas çlirimit të vendit dhe në sajë të politikës së masivizimit, numuri i vajzave muslimane si rezultat i ngritjes së dhjetrave shkollave 7 e 8 vjeçare , të mesme dhe profesionale dhe të larta, erdhi duke u rritur nga viti në vit, ku kontributi i tyre ishte në vazhden e kontributeve që dhanë të gjitha vajzat dhe gratë shqiptare në të gjitha fushat pavarësisht të një mungesë të theksuar lirie të mendimit, veprimit e organizimit.

Një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe gratë muslimane në diasporë, në vitet kur familjet e tyre emigrojnë jashtë vendit. Ndër to **Safet Sofia Juka**, (vajza e Musa Jukës, ish ministër në qeverinë e Zogut, emigruar në Egjipt e më vonë Amerikë) një intelektuale e shquar shkodrane, estete, vizionare, politologe, historiane dhe humaniste, kritike e thellë e arteve pamore dhe e krijimtarisë letrare botërore, një erudite e vërtetë shqiptare me një kurajo dhe guxim shkencor të pakundërshtueshëm, me një patriotizëm të flakët luftoi për mbrojtjen e çështjes shqiptare dhe dimensionit tragjik të Kosovës. Ajo ka përkthyer nga gjermanishtja në një anglishte të përkryer



Safet Sofie Juka



Nexhmije Zaimi

një libër të vitit 1913, shkruar dhe botuar nga deputeti, gazetari dhe shkrimtari austriak Leo Freundlich, “*Albanian’s Golgotha*”(Golgota shqiptare) ku tregohet gjenocidi serb ndaj shqiptarëve kurse në vitin 1984, nxjerr në shtyp librin e shkruar në anglisht: “*Kosova - The Albanians in Yugoslavia in light of Historical Documents*”,(Kosova-shqiptarwt nw Jugosllavi nw driten e dokumentave historikë) libër ky i mbushur me dokumenta shkencore të pakundërshtueshme, që kanë ndikuar në sqarimin dhe në konstruktimin e një dijeje të vërtetë për Kosovën, që çuditi kancelaritë e mëdha diplomatike të botës.**(1)(15) Nexhmije Mustafa Zaimi**, ishte një nga gazetaret më me emër në mediat amerikane, duke spikatur sidomos mes kolegëve vendas të “*Zërit të Amerikës*” dhe “*CNN*”, “*Evropës së lirë*” për ta lartësuar personalitetin e vet me shërbimin profesional në “*Office of Strategic Services*” (Zyra e Shërbimit Strategjik të SHBA). Ajo është regjistruar në memorien e institucioneve të rëndësishme amerikane si gazetarja që përcolli e para gjëndjen e mjeruar të një milion refugjatëve palestinezë në vitet 50. Ajo ka qenë në të rrallat punonjëse të mediave amerikane që ka sjellë për shtypin në SHBA raportet e para nga pasojat e konfliktit arabo – izraelit.**(1) Nermin Vlora Falaski** është dalluar për një veprimtari të gjerë dhe të shumanëshme për të cilën e ka ndihmuar edhe njohja e gjuhëve të

huaja, frënge, italiane, angleze, spanjolle, turke. Përveç se është auore e katër librave me vjersha, katër romaneve, ajo ka bërë shumë studime të antikitetit dhe të qytetërimit parakolumbian “*Chibchanë*” për të cilat ka marrë dekoratën e lartë “*Oficial de la Orden di San Karlos*” të qeverisë së Kolumbisë (1981), që është dekorata e parë dhënë një gruaje të huaj. **Feime Pipën, (motra e Arshi Pipës)**, do ta shohim si një publicitare të shquar, të botojë shumë artikuj në “Shejzat” e Ernest Koliqit, me brendi arsimore, në fushën e historisë dhe arsimit. Veçanarisht të rëndësishme janë botimet e saj për zhvillimin e arsimit shqiptar me titull “*Një shekull shkollë shqipe 1861-1961*” ku bën historinë e arsimit tonë kombëtar.(1)

Në fushën e mjekësisë gratë muslimane kanë zhvilluar një aktivitet human shumë njerëzor në ndihmë të sëmurëve, të plagosurve në luftë, në familje apo edhe në një rreth më të gjërë. Veçanarisht ndihma e grave mami popullore, në mungesë të mjekëve ka qenë e një rëndësie të veçantë. Në fillim si mjekë popullore duke shfrytëzuar potencialin e bimëve mjekësore që rriteshin në vendin tonë, por edhe traditën në këtë fushë, ato dhanë një ndihmesë të jashtëzakonshme. Por kishte edhe nga ato që vazhduan shkollat e larta. **Xhanfize Basha** është diplomuar në mjekësi në “*The Woman’s Medical College of Pensylvania*” në Filadelfia (1936), duke u bërë kështu, studentja e parë shqiptare që kryen studimet në Amerikë. Ishte ndër katër mjeket që morën medaljen e artë në universitetet e SHBA. Ajo konsiderohet si pediatria e parë shqiptare që vuri bazat e para të pediatriisë shqiptare. Qemoran Toptani, njihet si kirurgia e parë femër shqiptare e diplomuar në Austri dhe Itali. Ishte e bija e patriotit Fuat Toptanit. Rushen Golemi do të jetë e **para kirurge femër** në vendin tonë, që fillon punën më 1957 në spitalin civil të Tiranës dhe pas saj **Zyliha Kraja** që punon si e para kirurge në qytetin e Shkodrës. Por dhe shumë të tjera në këtë fushën mjekësore moren

edhe grada dhe tituj shkencorë, si prof. **Ruzhdiqe Qafmolla**, etj.(1)

Në fushen e artit dhe kulturës kombëtare kontributi i grave shqiptare muslimane zë një vend nderi në kulturen kombëtare. **Vaçe Zela**, është vlerësuar me titujt “Artiste e Popullit”, “Mjeshtre e Madhe e Punës”, “Nderi i kombit”, për vlerat të rralla si artiste shqiptare në interpretimin e muzikës së lehtë shqiptare. Është futur në gratë e shquara të botës nga Instituti Amerikan i Biografive; këngëtarja nga Kosova, **Nexhmije Pagarusha**, është quajtur “*bilbili i Kosovës*”, këngëtares **Fitnete Rexha**, **Naile Hoxha**, **Merita Halili**, **Myfarete Leze**, **Mukades Çanga**, **Mihrije Brahja**, **Fatime Sokoli**, **Ermira Breçani**, gratë e familjes **Zyberi**, **Hafsa**, **Fatma**, etej. Janë të njohura aktoret e Teatrit si **Drita Pellingu**, **Drita Agolli**, **Esma Agolli**, **Zyliha Miloti**, **Aishe Starja**, **Behije Çela**, **Luiza Vorfi**, **Yllka Mujo**, shkencëtares **Mimoza Hafizi**, **Ruzhdiqe Qafmolla**, **Myzejen Boriçi**, etj. valltares **Ganimet Vendresha**, **Lili Madhi (Këlliçi)**, **Mediha Lubonja**, **Lili Cingu**, **Besa dhe Ikbal Morina**, etj..dirigjentja **Suzana Turku**, pianistja **Lili Tafaj**, **Lejla Agolli**-kompozitorja e parë e muzikës simfonike shqiptare etj. Në Kosovë **Melihate Ajeti**, **Naxhije Deva**, **Meriban Shala**, **Hyrije Hana**, **Belxhyzare Fejzo**, **Safete Rugova**, **Vera Balaj**, **Igballe Gjurmaj**, etj..

Gruaja muslimane ka një pjesëmarrje dinjitoze edhe në politikë: **Rushen Golemi**, **Edita Tahiri**, **Flora Brovina**, **Natasha Shehu**, **Makbule Çeço**, etj. Kulmin e kontributit të gruas shqiptare muslimane në politikë e arrin **Atifete Jahjaga**, e cila është e para presidente femër në Kosovë, por edhe në rrafshin kombëtar, në periudhën 7 prill 2011 – 7 prill 2016. Ajo gjithashtu është presidentja e parë femër në historinë moderne të Ballkanit.



Ajo ka shërbyer si zëvendës drejtoreshë e Policisë së Kosovës, duke mbajtur gradën e gjeneral majorit, grada më e lartë në mesin e grave në Evropën Juglindore. Jahjaga ka kontribuar në ndryshimin e imazhit të Kosovës jashtë vendit, promovimin e agjendës evropiane dhe euroatlantike, bashkëjetesës dhe tolerancës, normalizimin e marrëdhënieve me vendet fqinje dhe tërheqjen e investimeve të jashtme. Gjatë katër viteve në zyrë, ajo ka ridefinuar rolin e Presidentit në ndërtimin e jetës pluraliste dhe institucionale të Republikës së Kosovës, duke jetësuar parimet kushtetuese që përbëjnë bazën e demokracisë dhe garantojnë qëndrueshmërinë e një shteti. Ka themeluar Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit më 14 shkurt 2012.

Bibliografia

1. Zenepe Dibra “Fjalor enciklopedik i gruas shqiptare”, Shkodër 2009
2. Drita Bakija “*Gratë dhe lidhja e Prizrenit*: Kumtesë, Tiranë, 1978
3. Shaban Braha: “*Idriz Seferi*”, monografi, Tiranë.
4. Wikipedia
5. Hanëmshahe Ilazi: “*Gra të njohura të trojeve shqiptare*”, Prishtinë, 2016
6. Sabile Keçmezi Basha: “*Gratë e familjes Buletini*”, studim
7. Idajet Jahaj: “*Heroikë, gra vlonjate në histori*”, Vlorë 2004
8. Aida Shehu: “*Shota –Shqiponja e Kosovës*”, Shqiptarja e re 1988/1
9. Alban Dobruna: “*Kontributi i femrës në pavarësinë e Shqipërisë*”, Zemra shqiptare , 22.12.2010)
10. Fjalori Enciklopedik shqiptar, zëri “*Xhevë Lladrovci*” dhe zëri “*Fehmi Lladrovci*”, Tiranë 2008
11. “*Gruaja shqiptare në Luftën Nacionalçlirimtare*”, Tiranë, 1975
12. Riza Greiçevi” Tringa e Prekazit”, Prishtinë, 2005
13. Fatbardha Saraçi (Mulleti) “*Kalvari I grave në burgjete komunizmit*”, Tiranë, 2013
14. Marsida T Najdeni, “*Femrat 'e prapambetura' tiranase... sipas Partisë së Punës sot e 70 e kusur vjet*”, syri.net
15. Mithat Frashëri “*Plagët tona*”, Tiranë, 1924
16. Zenepe Dibra “*Bijat e Rozafës –gra të shquara të hapësirës shkodrane*”, Shkodër 2004
17. Hyqmet Zane: “*Shefikat Narazani Mësuesja që la Turqinë për Shqipërinë*”, Revita Kultplus, 15.07.2017.
18. Iljaz Goga : Rekuem për një mësuese pioniere : *Shadije Bogdo intelektualja dhe drejtoresha e Shkollës Femërore të Tiranës më 1923*”, Korrieri. - Nr. 113, 17 maj, 2005, f. 13
19. Brikena Bogdo “*Requiem gruas shumë dimensionale Shadie Bogdo*”, Revista “Kuvendi”, 7.03.2015
20. Gazmend A. Bakiu “*Dekoratat shqipatre në vitete 1925-1939*” Gazeta shqiptare, 2.04.2012
21. Fatmira Musaj: “*Gruaja në Shqipëri (1912-1939)*”, Tiranë, 2002

22. Raina Kovaçi “*Ikbal Çika –gazetarja e parë shqiptare*”, Gazeata
Telegraf, 2.03.2018, marrë nga Revista “Psikologjia”

**Dr. Ilirjana Kaceli¹⁷ - Roli i gruas në edukimin e brezave,
bazuar në revistat kulturore islame**

Abstrakt

Në të gjithë periudhat historike si dhe në të gjitha shoqëritë roli i gruas në familje dhe shoqëri mbetet i pazëvendësueshëm. Ato janë shquar jo vetëm në detyrën e tyre si nënë, grua, motër, bijë por dhe si dijetare, prijëse dhe udhëheqëse të shtetit. Ato janë përpjekur dhe kanë arritur të edukojnë breza të cilët me veprat e tyre lanë shenjë dhe gjurmët në histori. Ato i rritën fëmijët e tyre me dashurinë dhe sakrificën për atdheun, i pajisën me kulturën e duhur dhe edukatën për të qenë bij të denjë dhe besimtarë të devotshëm. Ato luajnë rolin kryesor në familje e cila është baza e shoqërisë dhe si e tillë mund të themi që shoqëria dhe shteti lulëzojnë e përparojnë vetëm prej disiplinës, rregullit, bashkimit dhe paqes si dhe nga individë të edukuar dhe mirëarsimuar. Figura e gruas dhe roli i saj në edukimin e brezave ka zënë një vend të rëndësishëm në revistat kulturore islame si Zani i Naltë, Kultura Islame, Njeriu, Dituria Islame, Drita Islame të botuara në viset shqiptare. Këto revista pasqyruan gjerësisht veprimtarinë e gjerë, misionin human, përkushtimin, besimin dhe cilësitë e rralla të shumë nënave, motrave dhe grave myslimane.

Hyrje

Gruaja është njëri prej dy elementëve kryesorë nga të cilat formohet familja dhe shoqëria. Roli i saj është i pazëvendësueshëm në edukimin dhe transmetimin e cilësive të

¹⁷ Dr. Ilirjana Kaceli, Kolegji Universitar Bedër.

njeriut me virtyte të larta në shekuj brez pas brezi. Gratë përbëjnë gjysmën e shoqërisë dhe ato janë përgjegjëse për të edukuar, udhëzuar dhe reformuar brezat që do të vijnë. Ato u përpoqën dhe arritën ti rrisin fëmijët e tyre me dashurinë dhe sakrificën për atdheun, i pajisën me kulturën e duhur dhe edukatën për të qenë bijë të denjë dhe besimtarë të devotshëm. Roli i gruas si bijë, motër, nënë dhe bashkëshorte është me të vërtetë i fuqishëm sepse është forca tek e cila mund të mbështetemi, të gjejmë forcë dhe besim, nga ku presim të përfitojë jo vetëm familja e ngushtë por dhe komuniteti dhe gjithë shoqëria. Pra mund të themi se “Gruaja është ura lidhëse e të gjitha shoqërive dhe çelësi i sekretit të mbarëvajtjes së tyre”¹⁸.

Të flasësh për rolin dhe pozitën e gruas si asaj myslimane por edhe të feve të tjera patjetër duhet ti referohesh historisë. Pozita e saj në shoqëritë e vjetra do të dallonte sipas institucioneve shtetërore, ligjeve dhe shoqërive. Në disa vende ajo kishte arritur të ngrihej në shkallët më të larta, madje arrinte të drejtonte dhe udhëhiqte shtetin në pozitën e mbretëreshës si në Egjipt (Kleopatra) apo në Iliri mbretëresha Teutë. Ndërsa në disa vende të tjera të botës së lashtë femra mbyllej në shtëpi, varrosej për së gjalli, apo trashëgohej si plaçkë, siç ndodhte në shoqëritë induse, romake, etj. Si të gjitha gratë e botës edhe gruaja shqiptare dhe historia nëpër të cilën ka kaluar ka qenë e gjatë dhe e mundimshme¹⁹. Që nga lashtësia e deri më sot gruaja ka marrë pjesë aktive në jetën e vendit. Krahas burrit, gratë kanë luftuar dhe kanë treguar heroizëm të rrallë në beteja dhe luftra të ndryshme për mbrojtjen e atdheut. Veprimtaria e tyre është aq e madhe dhe e fuqishme sa që rilindasi Sami Frashëri iu kushtoi atyre një vepër të plotë me emrin “Gratë” (Kadinlar). Ai në këtë broshurë me të

¹⁸ <http://www.dritaislame.al/nga-Valmira-Demaj/>

¹⁹ Dr. Sabile Kecmezi-Basha, “*Roli i femrës në ruajtjen e identitetit kombëtar*” botuar në: Dituria Islame, nr.44, f.30

drejtë do të vlerësojë figurën e gruas si shtyllë e familjes dhe e shoqërisë, botëkuptimi i tij është tejet interesant dhe tepër përparimtar, pavarësisht rrethanave dhe kohës në të cilën u shkrua vepra. Ai thekson se: *“Përparimi i shoqërisë njerëzore varet nga edukata e grave. Atëherë pra lipset që mësimi i parë i qytetërimit e i përparimit të jetë edukimi i grave.”*²⁰

Në libër ai rrëfente të drejtat që ka gruaja për shkollim dhe punësim, duke na dhënë edhe qëndrimin e islamit ndaj gruas dhe të drejtat dhe detyrat që ai ia parashtron asaj²¹. Ai e shpjegon edukimin e grave nëpërmjet dy argumentave ; e para meqë gjysma e popullsisë së globit tokësor përbëhet nga gratë dhe duke edukuar ato edukohet gjysma e racës njerëzore. E dyta, nëpërmjet edukatës familjare dhënë nga gratë trashëgohet kultura dhe edukata në të ardhmen e racës njerëzore²².

Samiu më tej shtonte se materia e kësaj broshure është shumë e gjerë dhe shumë e rëndësishme, meqë gratë përbëjnë gjysmën e njerëzimit. Ai thekson se është i vetëdijshëm se në një broshurë të tillë nuk mund të shpjegojë gjerësisht pozitën e saj (gruas) por se dëshiron të thotë disa fjalë mbi gjendjen dhe rolin e tyre në përgjithësi, dhe në veçanti për gratë myslimane, aq më parë kur në gjuhët tona, nuk është shkruar asgjë për këtë çështje të rëndësishme e cila në të vërtetë do të ishte shpëtim për shoqërinë. Samiu e përshkruan gjerësisht gjendjen e gruas në të kaluarën dhe rolin e rëndësishëm të saj në përgjithësi duke nënvizuar se *“Esenca dhe rëndësia e grave është kuptuar shumë vonë”*. Pasi përmend disa dallime natyrore midis burrit dhe gruas ai shton se gratë nuk duhen privuar nga të drejtat dhe detyrat që i kanë fituar burrat dhe

²⁰ Sami Frashëri, *Gratë* (vepra 15), Shtëpia Botuese, Logos-A, Prishtinë 2004, f.19.

²¹ Mr. Abdullah Hamiti, *Sami Frashëri për rolin e gruas në familje e në shoqëri*, botuar në , Dituria Islame, nr.72, f.26-27.

²² Sami Frashëri, *Gratë* (vepra 15), Shtëpia Botuese, Logos-A, Prishtinë 2004, f.20.

shton, se *“Gruaja është baza e shoqërisë njerëzore, shtylla e moralit publik, një e një lidhje të shenjtë, familjes, e cila e nxjerr njeriun nga errësira dhe e qytetëron. Ajo është lulishte e njerëzimit”*. Samiu gjithashtu vlerëson arsimimin dhe edukimin e gruas për të ardhmen e shoqërisë njerëzore duke theksuar se”.... *qytetërimi mund të arrihet me lehtësi e shpejtësinë më të madhe vetëm nëpërmjet edukimit të gruas”*.

Dihet që edukata e mirë është begatia e njeriut, prandaj nëpërmjet teorive dhe mendimeve pedagogjike shpjegohet se fëmija në fëmijëri është i lidhur më ngushtë me nënën dhe se hapat e para të shkollimit dhe të edukimit i merr nga vetë ajo. Prandaj Samiu shprehet se *“edukimi i fëmijëve varet nga gratë, sa më e edukuar të jetë gruaja në përgjithësi po aq është e edukuar edhe shoqëria njerëzore”* dhe më tej ai e shtjellon mendimin e tij në veprën *“Gratë”* kur thotë se: *“Krijuesi i Madhëruar, grave u ka dhënë butësinë të rrisin dhe të edukojnë fëmijë... pas dashurisë së nënës përkëdheljeve të saj, kur shkon në shkollë, edhe më e dobishme është që mësuesi i tij i mektepit (shkollës fillore) të jetë femër, ngase edukimi lehtësohet dhe shpejtohet”* duke bërë krahasimin me vendet e përparuara perëndimore. Sipas tij sa më e ngritur të jetë gruaja në familje aq më e shëndoshë është familja, aq më e fortë shoqëria dhe aq më i dashur do të jetë atdheu. Idetë e Samiut mbi të drejtën e gruas në Islam do të pasqyroheshin edhe në revistat kulturore islame që e filluan botimin e tyre në vitet 20-30 të shekullit kaluar në momentin kur elita politike shqiptare e kohës po përpiqej për të vendosur institucionet shtetërore mbi krizat politike të kohës.

Figura e gruas dhe roli i saj i rëndësishëm në edukimin e brezave u shtrua në artikuj të ndryshëm dhe nga pena të fuqishme të kohës në të gjitha revistat kulturore islame si *“Zani i Naltë”*²³,

²³Revistat kulturore islame *“Zani i Naltë”*²³ organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, u themelua në tetor të vitit 1923, menjëherë pas Kongresit të parë të

“Kultura Islame”, “Njeriu”, “Dituria Islame”, të botuara në viset shqiptare. Këto revista pasqyruan gjerësisht veprimtarinë e gjerë, misionin human, përkushtimin, besimin dhe cilësitë e rralla të shumë nënave, motrave dhe grave myslimane. Në revista janë botuar një numër i madh artikujsh me tematikë mjaft të gjerë dhe në shumë fusha e lëmi si filozofi, moral, letërsi, sociologji, historinë islame, shoqëri, ekonomi, familje, gruan, edukimin etj. Në këto revista botuan personalitete dhe intelektualë të fesë islame si Haki Sharofi, Salih Vuçiterni, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ali Kraja etj. Por krahas tyre botuan shkrime dhe bashkëpunëtorë të fushave të ndryshme intelektualë të elitës politike dhe asaj shoqërore të kohës si Ferit Vokopola, Mehdi Frashëri, Lumo Skëndo, Shefqet Muka etj.

Që nga nisja e botimit të saj në vitin 1923 revista “Zani i Naltë” i ka prirë edukimit të shoqërisë shqiptare jo vetëm në aspektin shpirtëror, por edhe në atë juridik, kulturor e social. Në ato vite kur shoqëria shqiptare kishte nevojë për një ringritje në të gjitha fushat, Zani i Naltë mori përsipër trajtimin e një sërë

Komunitetit Mysliman Shqiptar. Botimi i kësaj reviste zgjati deri në vitin 1939. Pas ndërpreprjes së saj në Shqipëri fillon të botohet revista “Kultura Islame” që zgjati nga 1 shtatori 1939 e deri në janar-shkurt të vitit 1946. Krahas tyre në Shqipëri u botuan edhe revista “Njeriu”, organ i organizëts “Drita Hyjnore”. Kjo revistë filloi të botohej nga muaji korrik i vitit 1942 deri në shtator 1944 nën drejtimin islam të Sherif Putrës.. Por fatkeqësisht me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri nga regjimi komunist, u ndaluan gjithë veprimtaritë fetare dhe publicistika islame në gjuhën shqipe u shua. Në Kosovë revista Dituria Islame e pa dritën e botimit në vitin 1986 si periodik tremujor kulturor-informativ edhe pse revistë e sapo lindur është një ndër revistat në të cilën shpalosen ngjarjet që bënë kthesat e mëdha për historinë më të re të popullit shqiptar, sidomos atij jashtë kufijve të Shqipërisë. Pas rënies së sundimit komunist në Shqipëri filluan të botohen “Drita Islame” në vitin 1992 dhe “Zani i Naltë” në 2012 si vazhdimësi i revistave kulturore të mëparshme dhe si tribunë ku do të shpalosen njohuritë e personaliteteve akademike nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

çështjeve duke shërbyer jo thjesht si revistë, por si një shkollë edukimi. Numri i parë I saj kishte të shkruar mbi kapak shënimin “*Revistë fetare, merret edhe me filozofi, moral, literaturë kombëtare, sociologji*”. Pra kishte fushë të gjerë studimi dhe trajtonte problematika të ndryshme. Në revistën “**Zani i Naltë**” krahas temave të mësipërme kishte rubrikë të veçantë edhe për gruan dhe problemet shoqërore në përgjithësi: Aty gjtën hapësirën dhe u botuan artikuj si: *Gruaja në myslimanizmë me disa pjesë, Ne demokrasit detyra sociale e gruas, Rëndësia e martesës, Gruaja duhet ta respektojë Kuranin më tepër se mashkulli, Vlera e diturisë, pozita e gruas në fenë islame, Edukata shoqërore e gruas në islam, Edukata morale, rregullat e mirësjelljes dhe të nxanët, Gratë e famshme myslimane në dituni, Pak fjalë më Prindërit (Haxhi Kalaja), Rregullat e mirësjelljes etj.* Numra të ndryshëm kanë qenë objekte të parashtrimit, analizave, diskutimit, debatit dhe detyrave. Janë trajtuar problemet e marrëdhënieve shoqërore e familjare, emancipimi i gruas myslimane, kuptimi i drejtë i civilizimit dhe progresit, lufta kundër veseve shoqërore, në përputhje me normat dhe etikën islame si dhe atë kombëtare.²⁴

Qasja e “Zanit të Naltë” ëshë ajo e vendosjes së një ekulibri, një të mesmeje të artë që i vlerëson vajzat dhe gratë në përputhje me pikëpamjet e islamit dhe njëkohësisht i’u njeh atyre të drejtën e aktivizimit në të gjitha fushat.

Në një nga shkrimet e posaçme të botuar në një nga numrat e revistës, të titulluar “Modeli islam në emancipimin e gruas”, thuhet se “Kjo qasje e mesme ndaj emancipimit të gruas dhe ruajtjes së feminitetit të saj, bazohet gjithashtu tek praktikat profetike që rridhnin nga logjika e Kur’anit. Këto praktika të cilat e emancipuan gruan myslimane dhe e çliruan atë nga varrosja për së gjalli, e shndërruan atë në një forcë aktive në ndërtimin e

²⁴ “90 vjet Revista “Zani i Naltë”, <http://www.dritaislame.al/90-vjet-revista-zani-i-nalte/-nga-Fatma-Karaj>

familjes, shtetit dhe civilizimit islam, e bënë atë pjesëmarrëse në të gjitha fushat e jetës dhe të fesë. Diçka të tillë e gjejmë që ditët e para të lindjes së diellit Islam.²⁵

Vëmendjen e “Zanit të Naltë” ndaj figurës së gruas e dëshmon edhe studiuesi Viron Koka në studimin e tij “Kultura islame shqiptare në vitet ’20-’30”, ku pohon se çështjet që kanë të bëjnë me pozitën e saj në familje dhe shoqëri zinin një vend të rëndësishëm në këtë revistë dhe rreth tyre diskutohej shpesh. Një problem tjetër social dhe kulturor me rëndësi ishte edhe qëndrimi ndaj gruas dhe familjes. Për këtë çështje, u debatua mjaft në këto vite dhe u kërkua emancipimi i gruas.²⁶

Nëpërmjet mendimeve të shprehura në faqet e saj kjo revistë, përveç dhënies së shpresës, dhe besimit, solli edhe siguri për brezat e ardhshëm, kur pohonte: *“Mos të kujtojë brezi i ri se për përparimin e njerëzisë, për mbarëvajtjen e jetës sociale brenda në kufij të moralit, nuk jemi përkrahësit e zhvillimit të gjithmbarshëm”*. *“Neve e dimë më shumë se të tjerët se me përdredhjen e kohës, ndryshohen edhe urdhërat, por këto urdhëra lëndorë duhet të përputhen kurdoherë me nevojat zhvillimore të mbrojtun shtyllën e moralit”*.

Në këtë kuadër u projektuan në Shqipërinë tonë një varg zhvillimesh²⁷ të rëndësishme, ku shquhen prirjet progresiste të “lëvizjes feministe”, që u shfaq si një shqetësim i shoqërisë së kohës për një rol dhe vlerësim më njerëzor të femrës shqiptare. “Zani i Naltë”, në numrin 3, të vitit 1926, do t’i thurte himn figurës dhe personalitetit të gruas: *“Gruaja asht krijuem me një fuqi*

²⁵ Dr. AMARE, Muhamed, *Modeli islam në emancipimin e gruas*, Zani i Naltë, <http://zaninalte.al/2015/06/modeli-islam-ne-emancipimin-e-gruas/>

²⁶ Viron Koka, “Kultura islame shqiptare në vitet ’20-’30” *tw* shekullit XX, botuar në revistën “Studime Historike”, viti 1992, nr.1-4, f.59.

²⁷ A. Bala, “Zani I Naltë- Revistë e orientimit drejt reformave dhe progresit shoqëror”, botuar në: “Zani i Naltë”, vëll. X (artikuj të zgjedhur), (2014), f. 231.

madhështore të cilën mund ta përdorim edhe në një mënyrë të dobishme për të gjithë, kaq sa vlefte e një kombi bazohet me atë të grave”, – shkruhej atje.

Më tej “Zani i Naltë” u trajtua edhe e drejta e pamohueshme e femrës shqiptare për arsimin: *“... të hapim shkolla varfnore mashkullore e femnore, - shkruan Salih Vuçiterni - që të mësohen e të edukohen e mbasi të kenë krem shkollën të jenë të zot secili prej tyre m’u marrë me lloj mjeshtrije qi asht si gjymtyrë të dobishme të bahen të dejun m’u përzi me shoqinë njerzore”*. “Zani i Naltë” e ka ngritur zërin, që gruas shqiptare t’i sigurohet e drejta e punës si realitet i rolit parësor të saj në shoqëri, si nënë dhe grua. *“Asht për t’u përmend, - shkruhej aty, se nuk ka ndalim për gratë e reja me mësue dituni e mjeshtri...si dhe me shkue me ushtrue mjeshtërinë ndër vendet e punimeve”*. Pa dyshim, një ndër problemet më të rëndësishme, që është trajtuar në revistë ka qenë pasqyrimi i atyre përpjekjeve kolosale, që kanë bërë forcat përparimtare në luftën për emancipimin e femrës myslimane shqiptare. Ferit Vokopola, në nr. 3, të vitit 1937, shkruante: *“Le të shpresojmë se me marrjen pjesë të grues në lamën e aktivitetit njerëzues, atdheu i jonë do të përparojë me hapa gjigande drejt sferave të lumnisë landore e shpirtnore”*. Në nr. 6 të kësaj reviste, F. Vokopola do të shkruante me frymë aq liberale sa do t’ia kishte lakmi edhe çdo revistë laike e kohës: *“... të rinjtë e të rejat që janë kandidatë për martesë, të kenë kujdes me zgjedhë të dashunin e tyne e të mos të gabohen nga influenza e parë e pasionit”*.

“Zani i Naltë” po merrte përsipër edhe thirrje të tilla. Në shumë artikuj të revistës është ngritur si problem për zgjidhje parimi islam i barazisë së plotë të gruas me burrin, atë që sot e quajmë “e drejta politike” e personit, deri në të drejtën e gruas për të marrë pjesë në drejtim. *“Nuk ka dallim për një grua, m’u bamë njeri i shtetit - shkruante “Zani i Naltë” - dhe tue u interesue në*

punë politike, me dhanë mendimin e vet për modifikimet që duhen me u bamë në formulim të ligjeve”.

Një vend me shumë rëndësi në revistë zë problemi i familjes dhe i rolit të saj edukativ i detyrave dhe i përgjegjësisë të saj në çdo fushë. Kësaj i kushtohen shumë artikuj, të botuara veçanërisht në rubrikat “Ç’duhet të bajmë”, “Edukatë morale”, “Këshillat e filozofëve” etj. Në këto rubrika e artikuj zbërthehen mësimet kur’anore për familjen, baza ekonomike, shoqërore e shpirtërore e krijimit të saj, kushtet e jetesës e të harmonisë bashkëshortore dhe marrëdhëniet e ndërsjella prindër fëmijë. “*Lumturia e një shteti – shkruan revista – bazohet në lumturinë e familjeve dhe lumturia e familjes mbështetet në harmoninë e pjesëtarëve të saj*”.

Gjerësisht do të trajtohet roli i nënës si edukatore e fëmijës duke theksuar se edukimi i fëmijës fillon që në barkun e nënës, se ai është pasqyra e saj, se nëna është ajo, që do të vendosi gurin e parë të edukatës së fëmijës, e pastaj do t’ia dorëzojë shkollës dhe shoqërisë për të ngritur ndërtesën edukative. Nga nëna kërkohet që t’i japë fëmijës bazat e para të formimit të një trupi të shëndoshë, të një mendje të hollë dhe të një karakteri të fortë. “*Nana – shkruan revista – duhet me i dhanë e me siguruar atdheut e mbretit ushtarë besnikë, të fortë, të shëndoshë e të fuqishëm*”. Artikujt që trajtojnë problemet e edukatës familjare dallohen për qartësi e kompetence pedagogjike, për njohje të saktë të nivelit të familjes shqiptare, të mangësive, të dobësive si dhe të nevojave të saj, për përcaktimin e drejtë të detyrave të prindërve, e sidomos të nënës në edukimin e fëmijëve dhe të marrëdhënieve reciproke.

Krahas revistës “Zani i Naltë” do të botohej edhe “**Kultura Islame**”, si revistë mujore fetare, letrare, diturore e artistike. Kjo revistë na ofroi mjaft studiues të rinj islamë shqiptarë të kohës të cilët ndikuan në rritjen e efikasitetit të saj formues e edukativ filozofik e moral të lexuesit shqiptarë

nëpërmjet artikujve si: *Detyra e gruas botuar në nr.1* nga Sashi, ku do të theksohej se çdo pjesëtar i shoqërisë ka një detyrë për të përmbushë, kështu edhe grueja. Detyra e saj është më delikate sepse sipas tij gratë e bajnë dhe e ruajnë shtëpinë²⁸. Krahas këtij artikulli janë botuar artikuj me titull si; *Hadixheja, Familja, islamizmi dhe gruaja, Mbi punën, Vajza Shkodrane* shkruar nga një vajzë me pseudonimin Postribësja dhe botuar në (nr.23/1940-1941), *Gruaja në islamizmë, Grueja myslimane nga pikëpamja kombëtare*, ku shkruhet se përparimi i vërtetë i njerëzimit kërkon “*division du travail*” pra ndarjen e detyrave dhe obligimeve që kanë duke mos lënë pas dore detyrat e saj në familje si edukuese e brezave si rregullatore e familjes si dhe interesimin e saj në të gjitha çështjet kombëtare, marrjen pjesë në luftë, pregatitjen e sendeve dhe veshjeve siç kishte bërë Zejnepi njëra prej grave të profetit të cilat më pas i dhuronë ato për bamirësi etj.

Ndërsa në revistën “**Njeriu**”, kishte një rubrikë vetëm për problemet femërore ku u botuan artikujt: *Detyrat e njeriut, Familja, Shembulli i Femnave, Gruaja në jetën Shqiptare, , A asht femna faktor kryesor i mabrëvajtjes së shoqërisë?, Të drejtat e burrit dhe të gruas, Zakone që na dëmtojnë, Martesat* etj. Rëndësi ka se në të dyja revistat e fundit botuan për herë të parë edhe autore femra me pseudonime si Madaleine apo Lulja-Blertë duke thyer tabutë e kohës.

Revista “**Drita Islame**” në çdo numër të saj ka pasur hapësirë për gruan. Kjo do të thotë që ajo e ka parë shumë të domosdoshme që çështjet e gruas të trajtohen denjësisht dhe shoqëria mbarë të ndërgjegjësohet. Jo vetëm kaq por Drita Islame ka shkruar për vajzat dhe gratë duke u kujdesur që të nxjerrë në pah vlerat më të bukura të tyre, të mbrojnë të drejtat dhe të nxisë emancipimin. Pra, “Drita Islame” me rubrikën e gruas ka dashur të ndriçojë dhe të zgjojë vetëdijen e lartë për lidhjet e shumëfishta

²⁸ Sashi, *Detyra e gruas*, botuar në: “Kultura Islame”, nr. 1. 1939-1940, f. 30.

të misionit hyjnor të gruas dhe të rolit të saj në përparimin e shoqërisë²⁹.

Krahas revistave të botuara në Shqipëri vend të rëndësishëm zë edhe revista **“Dituria Islame”** e cila botohet në Kosovë. Dituria Islame në faqet e saj i ka dhënë rëndësi të madhe shkrimeve rreth familjes dhe gruas, kjo vihet re që në fillimet e saj, në numrat e parë të vitit 1986. Aty jepen zgjedhja dhe mënyrat e duhura drejtuar fëmijëve për Zotin, duke u mbështetur në fjalët profetike Muhamedit (a.s) si bashkëshort vë theksin në formimin e familjes mbi baza të shëndosha e duke vazhduar më tej me tema të përshtatshme për gruan dhe familjen në përgjithësi, si: *Pozita e femrës në sistemet e ndryshme shoqërore dhe në sistemin islam, Femra-obligimi detyrat dhe problemet e saj, Sami Frashëri për të drejtat e gruas në Islam*³⁰, *Pozitën e femrës në Islam dhe në krishterizëm, Prindërit dhe fëmijët, Familja e shëndoshë, shoqëria e shëndoshë; Barazia gjinore sipas besimit Islam dhe barazia gjinore në Ballkan, Roli i gruas myslimane në familje dhe shoqëri* etj. Gratë myslimane kanë luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në përhapjen e dijes fetare. Gruaja e Muhametit a.s. Aishja r.a ishte një burim i rëndësishëm i hadithit ajo ishte një lule e mençurisë dhe dijeve të jurisprudencës islame. Në fakt thuhet se profeti me fjalën e tij ju tha idhtarëve se ata do të marrin gjysmën e fesë së tyre prej³¹. Dhe në të vërtetë ajo njihet si një nga transmetueset më të mëdha të fjalës dhe veprës së profetit a.s.

²⁹ Fatma Karaj, *Roli I “Dritës Islame” Në Ndërgjegjësimin E Gruas Myslimane*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore mbi 25 vjetorin e revistës *Drita Islame*, Tiranë, 28 shkurt, 2017.

³⁰ Sami Frashëri botoi librin “Gratë (Kadinlar) në Stamboll në vitin 1879.

³¹ Muzaqete Kosumi-Prishtina, “Gruaja dhe familja në revistën”, botuar në Revista “Dituria Islame” *Tri Dekada Jetë, Punë, Sfida dhe Suksese*” (Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor Prishtinë 18-20 nëntor 2016), Prishtinë, 2018, f. 119.

Gruaja (nëna) pavarësisht nga vështirësitë e shumta që mban mbi supe, në vazhdimësi përkujdeset për fëmijët, burrin, shtëpinë. Rëndësinë e saj e shohim në çdo aspekt të jetës, ajo është shkaku pse jemi këtu ku jemi, është me ne dhe pranë nesh që nga momenti kur jemi në brendësinë e saj (mitrën), në çastin e lindjes, gjatë kohës së fëmijërisë, kur ajo me vetë të tëra mbetet pa gjumë. Pra gruaja është struktura më e fortë brenda familjes. Për të cilën Pejgameri a.s ka thënë: “Xheneti është nën këmbët e nënës”³². Gruaja është nga faktorët më të rëndësishëm brenda familjes, ndërsa familja është institucioni i parë dhe më me rëndësi në shoqërinë njerëzore; aty merren fillet e para të edukimit të njeriut...”³³

Disa nga temat e trajtuara gjerësisht në revistën “Dituria Islame” janë ato rreth rolit, kontributit, rëndësisë, barazisë dhe të drejtës së gruas në familje dhe në shoqëri si: *“Roli i mbulesës në parandalimin e çrregullimit social dhe krimit; Martesa dhe pengesa në rrugë të saj; Roli i gruas myslimane në familje dhe shoqëri; Kontributi i grave të gjeneratës së parë në Islam; Barazia gjinore sipas besimit Islam, dhe barazia gjinore në Ballkan etj.* Autorët që kanë shkruar më së shumti rreth rolit të saj dhe rëndësisë së gruas myslimane në familje dhe shoqëri janë: Dr. Naim Tërnavë, Prof. Dr. Fahrush Rexhepi; Mr. Qemajl Morina; Mr. Sadat Rustemi; Emine Vezaj; Amire Prebeza Sopjani; Hatixhe Ahmeti; Arta Tahiri. Esmë Morina, etj.

Vend i rëndësishëm në këtë revistë i është dhënë **Rolit të gruas në edukimin e fëmijëve** dhe që ata të jenë të sukseshëm në jetë duhet të jenë përgjegjësi e lartë e prindërve. Familja është vatra e parë e dijes dhe shkolla e jetës për edukimin e fëmijëve

³² Mr.Naim Tërnavë, *Gruaja është elementi –struktura më e fortë brenda familjes*, Dituria, Islame, nr.275, f.7.

³³ Amire Preza Sopjani, *Roli i gruas myslimane në familje dhe shoqëri-*, Dituria Islame, nr.204/205, f.36.

dhe se fëmija ka nevojë të domosdoshme për dashurinë e saj, ngase ajo e rrit, e frymëzon i nxit dëshirën dhe i rrit vullnetin për të ecur përpara dhe për të qenë i devotshëm për shoqërinë. Kjo vihet re në rastet kur familjet janë të shëndosha dhe kur prindërit dhe veçanërisht nënat kanë ndikuar në krijimin e personalitetit të tij, ndjenjat e dashurisë, respektit, bashkëpunimit, vullnetin e mirë për të tjerët, punën për të mirën e përgjithshme, si dhe sakrificën për hir të parimeve të larta. Është e domosdoshme të arsimohet më tepër femra, sepse si nënë asaj i duhet të jetë pedagoge dhe psikologe shumë e mirë. Në duart e saj formohet dhe edukohet njeriu. Ky është një funksion jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i ndërlikuar. prandaj ceken këto tema ; *Fëmija janë dhuratë e jo të keqpërdoren apo të abuzohen; Si të rrisim fëmijë të shëndetshëm; Si ta largojmë frikën nga fëmijët tanë; Fëmijët tanë dhe Kurani; dita ndërkombëtare e fëmijëve; edukimi i fëmijëve me namaz; Adoptimi i fëmijëve* etj. Autorët që kanë shkruar më së shumti rreth edukimit të fëmijëve janë; Rexhep Suma, Driton Artifi, Arta Tahiri; Vlora Podvorica-Shala; Nermine Kopriva-Jonuzi; Fatos Gërvalla etj.

Për nevojën e edukimit të grave, Drita Islame shtron këto arsye: Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së globit tokësor, prandaj duke u edukuar ato, është edukuar gjysma e racës njerëzore. Kalimi i një jete të lumtur të çiftit bashkëshortore wshtw tejet e rëndësishme, sepse edukata familjare që buron nga nëna trashëgohet në të gjithë të ardhmen e racës njerëzore. Nga një nënë e edukuar kalohet në një shoqëri të edukuar. Lidhur me këto, pozita e gruas në familje zë një vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste. Drita Islame vlerëson cilësitë e gruas për edukimin e fëmijëve, respektin që duhet të kemi për të si nënë, bashkëshorte, vlerësojnë dhe urdhërojnë pajisjen e saj me kulturë.

Përfundime

Kontributi i publicistikës islame ka qenë i dukshëm dhe i dobishëm sepse në të u pasqyruan materiale origjinale jo vetëm të përkthyer por të hartuara nga të rinj dhe intelektualë shqiptarë me tematikë të gjerë dhe shumë dimensionale. Shtypi islam në Shqipëri paraqet vlera të edukimit fetar e atij patriotik kombëtar të bazuara mbi filozofinë islame. Artikuj të shumtë kanë shërbyer për të rritur më tej vlerën që ka kultura islame në trojet shqiptare, qëndrimin dhe përkrahjen që islami i bën historisë, shoqërisë dhe në veçanti gruas rolit të saj si përçuese e vlerave më të mira shoqërore në edukimin dhe rritjen e brezit të ri.

Besa Ismaili³⁴ - Introduction on Albanians, Nationalism, Islam and Secularism

Since the end of the Ottoman Empire's presence in the Balkans and the subsequent creation of nation-states there, the Albanians have undergone numerous social, economic and political turmoils. Namely, the rise of nationalism in the Balkans has affected the Albanians in a way that is rather specific when compared with other countries of the region. These specificities may nevertheless be attributed to the fact that Albania is the first Muslim majority populated country³⁵ to be created in the Balkans after the retreat of the Ottoman Empire. Separation from the Ottomans also meant separation from power and privileges³⁶ for Balkan Muslims. Muslims who lost their positions of power were transformed into "surviving" religious or ethnic minorities, in countries such as Greece, Bulgaria or Kingdom of Serbia, Croatia and Montenegro. In Albania, however, they became "a surviving majority, as historian Nathalie Clayer puts it."³⁷

With the creation of the Albanian state, Islam, Orthodoxy, and Catholicism were all affected by the onslaught of officialised

³⁴ Lektore në Fakultetin e Studimeve Islame, Prishtinë, Kosovë.

³⁵ Judah Tim, Kosova; Luftë dhe hakmarrje (Kosovo, war and revenge), pg. 53

³⁶ Raymond Zickel and Walter R. Iwaskiw (1994). "Albania: A Country Study ("Local Albanian Leaders in the Early 19th Century")

³⁷ "Islam in Inter-War Europe" Nathalie Clayer and Eric Germain (Ed.) (2008) pg.128

nationalism. Albanian nationalism belongs to the “secular ethnic” type since it sought to create an independent state based on a perceived nation, formed upon the language that most of its members spoke, and out of territories that were under the administration of the Ottoman Empire up until the nineteenth century.

The post-Ottoman Muslim and Christian Albanians excluded religion from their modern identity. Albanian Christians had many reasons to embrace Nationalism in order to distance themselves from the Ottomans, and this is why Muslims came late to the nationalistic scene. As a result, key literary, cultural, historical and political figures of Albanians today have a Christian background. The 20th century Albanian nationalists thought that the only way to reshape the Albanian nation was by ‘killing God’ and inventing a ‘religion’ that would keep all Albanians together; that is, to say, “Albanianism.” This so-called *Albanianism* turned Albanian nationalism into a secular civic religion for the nation.³⁸

Impact of Albanian theism in shaping national movements in Kosovo

In 1944 when the Albanian Labor Party (ALP) came to power in Albania under Enver Hoxha, Kosovo was a part of the Yugoslav regime led by Josip Broz Tito³⁹.

State atheism in Albania and Yugoslavia was conducted pursuant to the Agenda of Socialism and Communism, manifested according to each nation’s state policy. As a result Albania

38 Ibid, pg.128

39 Malcolm Noel, Kosovo: short story, pg. 328

became the first atheist state in the world in 1967.⁴⁰ Immediately after WWII, with the *Agrarian Reform*⁴¹ both regimes nationalized most of the religious property of religious institutions, and tortured and executed clergy and believers.

Kosovar Muslims were subsumed into the South Slavic peoples - namely into their language, culture and politics⁴². Furthermore Kosovars were persecuted, discriminated and fought against, not only based on their religious affiliation, but also for their language, education, political convictions etc.⁴³

In mainstream Albanian society, with its majority oriented towards “Yugoslav spirit of brotherhood,” another layer of underground resistance movement emerged. This resistance, inspired by Albanian Marxist-Leninist ideology, was affiliated with the state of Albania and promoted the idea of unification with Albania.⁴⁴ While a small group of women were part of *Ilegalja*, the majority of Kosovo- Albanian women political elites became part of institutional Yugoslav/Serbian life. The model for modernization and progress for Kosovo women was the “Serbian Lady from Belgrade”.

Kosovan women who were detaching themselves from the traditional/religious/peasant families appeared in short dress and short haircut similar to any other woman in eastern communist

40 Article 37 of the Albanian Constitution of 1976 stipulated, "The state recognizes no religion, and supports atheistic propaganda in order to implant a scientific materialistic world outlook in people.",

41 <http://www.agr.kuleuven.ac.be/aee/clo/prgwp/PRG-WP15.PDF>, last accessed on 23 January 2013.

42 Kosovo: The Splintering of Yugoslavia , Tricia Andryszewski pg.16

43 “Historia e Kosovës”, Jusuf Buxhovi 2012, vol.1, pg.12

44 ‘Karakterit kombëtar i lëvizjes ilegale shqiptare në Kosovë 1945-1990’ – Sabile Basha

Article available at <http://www.sbekongre.sakarya.edu.tr/kongre1/Bildiri/947-954.pdf> ; last accessed on 21 January 2013

countries. The headscarf was regarded as backward and religious, something they didn't wish to be identified with.

Kosovo society has gone through various processes and major changes, but if there is one point that unites all Marxist-Leninists, pro-Yugoslavs, patriots and nationalists, and paradoxically nationalists and feminists together is *hysteria* over the headscarf.

Even today, with Albania no longer an atheist state and Kosovo an independent one, and both without state restrictions or repercussions against religion and the faithful, there remains an attitude of aggression, hatred and denial continues. Furthermore, these attitudes are being translated into concrete political and legal measures.⁴⁵

Freedom of religion in Kosovo

In a country with a long history of wars, suppression, victimisation, discrimination, unequal treatment and unfair representation, respect for human rights in general and religious rights and liberties in particular, is far from being in place and properly implemented in Kosovo⁴⁶, regardless of its modern legal standards.

45 Krasniqi, Milazim, "Lehtesia e padurueshme e intolerances (The unbearable easiness of intolerance)", http://www.gazetashqiptare.eu/milazim/feja_islame.html, accessed 13 January 2013

46 The Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) Mission in Kosovo, in its regular reports on the implementation of legislation (http://www.osce.org/documents/mik/2008/09/32879_en.pdf, accessed 22 May 2011), continuously calls for a more effective implementation of legislation adopted by the Assembly of Kosovo

Violation of religious rights in Kosovo occurs at various levels with various groups and individuals of all communities,⁴⁷ but the systematic, consistent and institutionalized violation of religious rights is manifested especially in the case of headscarved women. The issue of the *headscarf* shows in many dimensions the level of progress Kosovo has made in terms of human rights and their implementation, accommodation of religious beliefs and practices, freedom of expression, and gender equality. Moreover it provides insight into those who would undermine all efforts to install a conciseness of human rights and expression of belief.

Namely, Kosovo Courts have dealt with several cases claiming remedy for the violation of human rights and freedoms, religious rights and freedoms respectively.⁴⁸ The issue of the headscarf in Kosovo illustrates the extreme politicization of human rights issues and interference with the Courts administering these cases.⁴⁹ The largest number of complains for infringement of religious rights and freedoms comes from the largest religious community in Kosovo, the Islamic community.

The complainants were mainly the young women who have been denied access to school or work due to the headscarves they wear. To those opposing this right, the use of a headscarf represents a violation of secular principles whereas those opposing this ban consider it a violation of human rights and

47 Muslim and Protestant religious groups have initiated criminal proceedings before Kosovo Courts due to several physical incidents occurring:

48 State Department Report on religious freedoms, available at <http://www.state.gov/documents/organization/193037.pdf> ; last accessed on 24 January 2013.

49 A është shamia sulm mbi shoqërinë demokratike? By Nexhat Ibrahim, (Is headscarf a threat to a democratic society? Article available at www.zeriislam.com; last accessed on 22 January 2013

freedoms.⁵⁰ The headscarved women have addressed to the Kosovo Court to seek justice and remedies and in all cases the Court decided in their favour, ruling that their expulsion from work and school was a violation of human rights and freedoms.

In one case, in May 2008, the prosecutor Sabit Maliqi in Gjilan District Court issued an arrest order to the school's director who banned a student for entering school with a headscarf.⁵¹ The case appeared in all media headlines, and ended up with an "intervention" by the Ministry of Education Science and Technology, and the director was released and the case silenced.

There are dozens of cases where Kosovo Courts ruled in favour of complainants and their rights to wearing the headscarves. But the general situation is that those decisions remain only on paper and unenforced.

Village school directors⁵² and their personal convictions appear to be prevailing over the Court Decisions and other remedies of addressing religious human rights.

Such cases have frustrated the Muslim community, clergy, civil society and ordinary people, at one point bringing over ten thousand people to Prishtina in June 2010 to protest the situation. Protestors made statements such as⁵³ "Kosovo is secular

50 Xhamia, Shamia, Edukata 'non grata' - article by Faik Myftari, available at: <http://www.mesazhi.com/mendime/xhamia-shamia-edukata-non-grata> ; last accessed on 21 January 2013

51 Yearbook of Muslims in Europe Volume 3, Besa Ismaili

52 Krasniqi, Milazim, "Lehtesia e padurueshme e intolerances (The unbearable easiness of intolerance)", http://www.gazetashqiptare.eu/milazim/feja_islame.html, accessed 31 December 2012

53 Koha Ditore 19 June 2010 (daily newspaper)

and not an atheist state,” “Communism era has gone,” “Stop with religion-based discrimination,” etc.

Despite the fact that all public institutions are reasoning that banning girls from attending lessons, expelling women from work, discrimination during recruitment procedures, and denial of access to justice system, courts, health and social services is “safeguarding” state secularism, they have all been very careful to not document their actions against their victims. Namely, despite tens of cases of expelling students from schools, none of the directors or any of the school management have provided the students with written decisions, orders, or grounds for their actions. When asked by the Ombudsperson Institution to provide such explanations, the Courts were all very careful not to admit any deliberate activity.

Regardless of the fact that Kosovo Ministry of Education (MEST) defends its Administrative Instruction (AI) and banning students from schools, it has never provided any response to Courts for its actions and even further advised the directors not to do so as well. Namely, all the directors have said that “ *the NN student left the school on her own will And we have suggested her to take the headscarf off.* ” The same has been done in the case of Arjeta Halimi⁵⁴, Qefsere Fazliu, and others.

This only reinforces the fact that religious rights and liberties have been taken captive by the private, personal and political convictions of persons who have been ruling through institutions, rather than by the rule of law itself.

The Islamic Community of Kosovo and the Ombudsman Institution in Kosovo have reported many cases mainly related to the use of the headscarf by students and women who have been

54 Interview with Arijeta Halimi, September 2012

expelled from school/work.⁵⁵ Unable to take the case directly to the European Court of Human Rights, the Islamic Community of Kosovo has submitted the case to Ombudsman to be presented in the Kosovo Constitutional Court. Since June 2010, there is still no response from either the Ombudsman or the Constitutional Court on this matter whatsoever.

CLARD (a local free legal aid agency) has represented the case of Arjeta Halimi before the Constitutional Court of Kosovo, which was ruled down her case as *Inadmissible*. Consequently, Arjeta Halimi was instructed to ask for reinforcement of the Decision of District Court of Gjilan Cn. No. 24/09 date 17 November 2009 and its implementation by Vitia Municipal Education Directorate. The Constitutional Court claimed that MEST did not provide any respond, whereas in the letter of Municipal Directorate for Education to the Constitutional Court it states as follows: *We want to inform you that no one from MDE or school management denied or prevented her from her right to schooling, but the School “Kuvendi i Lezhes” warned orally that use of a black headscarf is forbidden in schools, after that the student left the school, school management did not undertake any interdisciplinary measures against her, and it hopes that this former student will be back to continue the lessons”*

Had the school management/municipal directorate and MEST been fully determined and grounded their decisions in the Kosovo Constitution and applicable legislation, then why would they have had to equivocate?

55 Debate organized by Islamic Community of Kosovo on 09/06/2010 with panelists: President of Kosovo Council for Defence of Human Rights and Freedoms –Mr. Behxhet Shala, Kosovo Ombudsman Mr. Sami Kurteshi, President of Kosovo Pupils Association, Students`Association Representative and Prishtina Municipality MP, Mr. Amir Ahmeti, etc

And the equivocation is furthered by the Constitutional Court itself when it ruled the case as inadmissible, stating that the complainant should ask for enforcement of the Decision No. 24/09 issued by District Court in Gjilan by the Municipal Court in Vitia, concluding that the claimant has not exhausted all legal remedies.

In a roundtable organised by the Youth Initiative for Human Rights on the Implementation of Antidiscrimination Law in Kosovo⁵⁶, one of the representatives of the Constitutional Court declared that “the case of Arjeta Halimi shows best how a case should not have been brought before the Court”, trying to explain to the audience the lack of knowledge by citizens on the procedures of the Constitutional Court.

The prominent case of Qefsere Fazliu, who was expelled from her job, and the prominent case of Arijeta Halimi who was expelled from school, both having legally confirmed their rights in secular rule of law institutions in Kosovo, fail to provide an answer on why the Court decisions on redressing religious rights are not being implemented. Kosovo Prosecutors have made a single attempt of sanctioning the violation of human rights by implementing provisions of Kosovo’s Criminal Code.

As no person, natural or legal, has not been sanctioned for violating and/or prohibiting the exercise of religious rights or freedoms in the history of post-war Kosovo, yet with significant dissatisfaction, anger and disappointment from Kosovo’s major religious community, speaks for itself.

To many analysts⁵⁷, this is due to the over-politicization of religious identity amongst Albanians.

56 During the debate discussions held on 22/09/2012 in Hotel Sirius - Prishtina

57 Islami minimal dhe rrenat maksimale - Halil Ibrahim (Minimal Islam and Maximum Lies) article available at: <http://ina-online.net/opinione/6129.html> ; last accessed on 12 January 2013.

To the victims this has obscured their dignity, causing trauma to the young students affected. Unable to return to their normal lives, the students have left the schools and are locked at home with no choice, not even the choice of taking off the headscarves one day.

The Headscarf and Female intellectual elites in Kosovo

A number of women from the underground resistance movement *Ilegalja* have after the war been regrouped into women's rights NGOs and other political parties. In fact, the political representation of Kosovo women in political parties and institutions is legally required and a quota of 30% imposed. On the other hand, the International Community has largely invested in these organizations with the objective of gender mainstreaming in Kosovo society, in general and in the new institutions established in particular. Despite all the progress made in terms of legislative framework, Kosovo women have not freed themselves from the ideologies of the past.

They have tacitly continued to oppose religiosity among women by any means since after the the conflict.

These Women's rights NGOs have lacked both the courage and argument to stand openly with regard to Islam and faith-based living. For twelve years after the war, Kosovo Women NGOs did not make clear their position on the headscarf until August 2011 when they sent a petition to the Assembly of Kosovo not to introduce anti-discriminatory amendments to Kosovo legislation with regard to religious rights. They have also emphasised "their role in nation- building and their contributions during the occupation" and "recalled the consequences of religion on women's liberation and progress".

But the same women have, on the other hand, promoted Christianity, Protestantism, and even acted as missionaries, adopting the symbols of “Motrat Qiriazi” and Mother Theresa in all their activities. Suffering from an unexplainable complex of inferiority and driven by the need to align themselves with ‘free western, modern and intellectual women,” Kosovar women leaders have been wary of any tendency to bring Islam into the public space. Most striking is that Kosovo women, with or without a headscarf, are rather religious, and the stance taken by their leadership draws a conclusion that most of the women civil society organizations are totally detached from the interests of common Kosovo women, both urban and rural. It is precisely this factor, of having a higher level of religious assertion among women in society and the totally different positions of those women who are representing them in institutions and civil society organizations that has made these women leaders “reconcile” with their “oppressors” in combating any form of Islam manifested by female believers.

Kosovo has witnessed radical changes in gender roles. Paradoxically, though, the claims for public recognition of gender equality has been met with contradictions in the post-war reconstruction process; on the one hand through the diffusion of women’s issues in practice and symbolic mimic in the political rhetoric and, on the other, through the marginalization of women. While women have actively sought to have a share in political decision-making and women’s issues, they have been systematically pushed aside. Simultaneously, the same strata of women continue to eagerly push aside from the public life that particular section of Kosovo women who view their faith as important.

In Conclusion

Nevertheless, it is obvious that recently Islam is playing a bigger role in both politics and society among Albanians in Kosovo. In post-conflict situations it is vital that all people are enabled to contribute their ideas, expertise and skills in reconstruction and rehabilitation processes leading to democratization and democracy-building.

Worse than inequality between men and women, the inequality between women, prevents them from fully participating in the processes and gaining a true political voice.

Kosovo women as pointed by Zilka Spahiq in her book “Contesting Female, Muslim and Feminist Identity” in the Chapter dedicated to Kosovo “ Albanian women have the tendency to collectively suppress the experiences they have shared during socialism”. Same has been done also towards the whole experience and the legacy from the Ottoman Era.

Kosovo women need to be freed of what Fraud defines as ‘motivated forgetting’ and Hobsbawm and Ranger’s ‘invented tradition’ and try to restore a denied 500 years under Ottomans and 50 years under Socialism (her-story). Her-story of collective memories and counter memories, and religion, even as unpopular as it was, played a significant role, nevertheless!

Fatma Karaj⁵⁸ - Të drejtat e gruas në Islam dhe qasja e myslimanit në trajtimin e çështjeve që përbëjnë debat

Zhvillimi me një shpejtësi marramendëse i teknologjisë, mundësia e komunikimit dhe e shprehjes së mendimit në platforma të ndryshme thuajse pa asnjë kufi, e të tillë elementë ndikojnë jashtë mase shoqëritë e botës së sotme. Kjo situatë bashkëngjitur sjell edhe problematika që kërkojnë zgjidhje. Ndër problematikat mbarë botërore më në qendër të vëmendjes bëjnë pjesë edhe roli i gruas, të drejtat dhe përgjegjësitë e saj. Në fakt çështja e gruas konceptohet ndryshe në bazë të botëkuptimeve, kulturave apo këndvështrimeve të njerëzve. Shpesh herë, për shkak të keqinformimit, Islami kritikohet si një fe që nuk i jep gruas të drejtat që ajo meriton. Me qëllim apo pa qëllim, tek njerëzit është rrënjësuar ideja, që në Islam gruaja dhe burri nuk janë të barabartë. Nisur nga kjo, ne do të qëndrojmë shkurtimisht mbi këtë çështje, duke sqaruar disa të drejta të gruas, por pa harruar edhe shumë realitete të dhimbshme të shoqërive myslimane.

Në radhë të parë, pavarësisht se është e vërtetë që rreth Islamit ka një keqinformim të qëllimshëm nga qarqe të caktuar, në fakt, situata e gruas në tërësi në shoqëritë myslimane nuk është fort ndryshe nga ç'e shpjegojnë. Mund të thuhet që tradita e vendeve myslimane, në përgjithësi ka arritur të dalë mbi Islamin. Dhe ajo që i përket traditave vendore i është mveshur Islamit. Shumëkush traditat e vendeve arabe i ka mësuar si Islam dhe i ka transportuar ato në vendet evropiane. Kështu janë bërë burim keqkuptimesh të mëdha, të cilat kanë ngritur barriera gjigande

⁵⁸ Përgjegjëse e Zyrës së Gruas në KMSH.

mes njerëzve dhe Islamit. Prandaj, këtu jemi të detyruar të bëjmë një ndarje mes Islamit të vërtetë dhe praktikës së myslimanëve. Nëse duam që të kuptojmë vërtetë pozicionin e gruas, të drejtat dhe përgjegjësitë që Islami i ka dhënë asaj, duhet t'i rikthehemi burimeve origjinale dhe kryesisht jetës së Profetit (a.s).

Psh., është shumë e njohur kritika që mashkulli është në plan të parë dhe femra në plan të dytë. Kjo nis që përpara se individi të vijë në jetë. Shohim që prindërit dëshirojnë të bëhen me djalë dhe jo me vajzë, por në Kuran thuhet: ***“Të Zotit janë pushteti mbi qiejt dhe Tokën. Ai krijon çka të dojë! Ai, i dhuron kujt të dojë vajza, e kujt të dojë i dhuron djem, ose i dhuron dy gjinitë: djem e vajza, e kë të dojë e bënë steril. Ai, në të vërtetë, është i Gjithëdijshëm dhe i Pushtetshëm.”*** (Shûrâ, 42:49) Vajza lind dhe është një fëmijë porsì djali. Prindërit kanë të njëjtat përgjegjësi karshi të dyve. Nëse bëjnë dallime në dhurata, në sjelljen karshi tyre, nëse favorizojnë njërin më shumë sesa tjetrin, atëherë janë përgjegjës fetarisht. Profeti (a.s) ka këshilluar, që, kur bëhesh me fëmijë, të bëhet një kurban në shenjë falënderimi ndaj Allahut pavarësisht gjinisë së fëmijës.

Edukimi dhe mundësimi i studimeve duhet të jetë i barabartë për të dyja gjinitë. Madje, duke ditur se vajzat janë më të rrezikuara për shkak të zakoneve dhe botëkuptimeve të prapta, Profeti (a.s) ka thënë: ***“Prindi që rrit dhe edukon dy apo tre vajza ka fituar xhenetin”***. (Ibn Maxhe, Edeb 3)

Në moshën e martesës, vajza është e lirë të shprehë mendimin e saj. Është kusht që vajza të shprehë mendimin e saj të lirë, në mënyrë që akti martesor të fitojë vlefshmëri juridike dhe fetare. Prindërve nuk i lejohet, që të këmbëngulin në përzgjedhjen e bashkëshortit, por mund ta këshillojnë në dobi të saj.

Islami i ka njohur gruas të drejtën e mehrit. Kjo është një dhuratë në vlerë monetare, të cilën dhëndri ia bën nuses, duke e përcaktuar shumën përpara aktit të martesës. Ajo ka të drejtë të kërkojë çfarëdolloj shume të dëshirojë. Nëse dhëndri pranon

shumën, sado qoftë ajo, ai është i detyruar ta shlyejë atë deri në fund të jetës së tij, por kjo përgjegjësi nuk shfuqizohet në asnjë rast pa pranimin e nuses.

Mehri dhe çdo pasuri individuale e gruas i takon asaj. Kurse sigurimi i nevojave jetike për familjen, si ushqimi, veshmbathja, ilaçet dhe banimi janë detyrë e burrit. Në rast se dhëndri nuk ka mundësi t'ia sigurojë këto gruas, atëherë s'mund të martohet. Gruaja nuk është e detyruar që pasurinë e saj ta ndajë me burrin. Me ato para ajo mund të bëjë ç'të dëshirojë. Mund t'i harxhojë në rrugët e lejuara, mund të investojë në fusha të ndryshme të tregtisë, mund të bëhet aksionare e ndonjë firme, etj.

Bashkëshorti s'mund ta neglizhojë, ofendojë apo poshtërojë gruan. Kur mërzitet me të s'mund të braktisë shtëpinë e të largohet, por duhet t'i qaset asaj me delikatesë dhe të përpiqet të ndërtojë dialog për zgjidhje të mosmarrëveshjeve. Profeti (a.s) ka thënë: *“Më i miri prej jush, është ai që sillet më mirë me bashkëshorten e tij”*. (Buhari, Nikah 43; Muslim, Fedail 68)

Pavarësisht se ka një ide të gabuar, njëkohësisht shumë të përhapur, dijetarët janë të mendimit që gruaia nuk mund të rrihet nga bashkëshorti i saj në asnjë rrethanë. Mashkulli s'mund ta godasë atë. Në rast se gruaia është e pakënaqur nga bashkëshorti i saj, ajo mund t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar divorcin, ashtu si edhe sot në shoqëritë laike. Prandaj, në Islam nuk ekziston një qasje sipas së cilës gruaia s'mund të ndahet pa aprovimin e bashkëshortit.

Gruaja ka të drejtë të punojë. Mjafton që të jetë në rrethana komode për të. Për shkak të natyrës së saj më të brishtë sesa mashkulli, gruaia s'mund të bëjë çdo punë. Ky është fakt. Ajo mund të bëhet gjithashtu, dhe mbase duhet të bëhet, edhe pjesë e politikës e të përzgjidhet si deputete, apo pjesë aktive e shoqërive civile.

Këto ishin vetëm disa nga shumë të drejtat e gruas të cilat zënë vend në të gjitha librat e jurisprudencës islame, pavarësisht

se realiteti i shoqërive myslimane në përgjithësi mund të jetë krejtësisht ndryshe. Këto nuk janë këshilla të rëndomta, por detyrime të parashikuara nga sistemi i drejtësisë islam dhe që në kushte të zbatimit të shariatit mbrohen me ligj.

Sipas botëkuptimit islam, gruaja dhe burri janë dy gjysma që plotësojnë një të tërë të përsosur. Është e vërtetë që Islami në kondita të caktuara ka diferencuar gruan nga burri. Synimi i këtij diferencimi është garantimi i të drejtave të saj. Sepse mashkulli dhe femra nuk janë njësoj në shumë aspekte dhe si rrjedhojë trajtimi mes tyre i barabartë në terma absolut do të na shpinte në padrejtësi. Islami ka për qëllim që të shmangë padrejtësinë.

Dëshiroj t'i rikthehem edhe një herë shkurtimisht çështjes së mungesës së përfaqësimit të vlerave të vërteta islame nga shoqëritë aktuale. Në fakt ky është një dëm i madh. Në ditët e sotme ne myslimanët duhet të jemi në gjendje t'ia shpjegojmë çështjet që besojmë shoqërive moderne apo njeriut bashkëkohor në rrugë logjike dhe jo thjesht si dogmë. Bediuzaman Said Nursi shprehet se ndaj njeriut bashkëkohor del i fituar vetëm nëse atë e bind në rrugë logjike. Ne nuk po ndeshemi, por fitorja jonë e madhe arrihet në momentin që kemi kryer detyrën tonë duke shpalosur argumente të vlefshëm për një sqarim të shëndoshë. Është e qartë që çështjet e besimit janë personale dhe ndoshta është e vështirë të gjejmë argumente logjike të pranueshëm nga gjithkush. Por marrëdhëniet civile janë të trajtueshme lehtë edhe në rrugë logjike.

Për fatin e keq, ne si myslimanë jemi shumë mbrapa në këtë pikë. Njeriu perëndimor i trajton deri në detaje çështjet e gruas dhe tashmë ai, përtej formës, me këndvështrimin dhe vlerësimin e tij, ka tejkaluar shumë problematika në lidhje me gruan. Për këtë arsye, në shumë tematika shoqërore në përgjithësi, dhe të gruas në veçanti gjenden atje ku myslimanët duhet të kishin arritur prej kohësh. Ne ende lodhemi duke i shpjeguar njerëzve përse lejohet poligamia, a lejohet që gruaja të punojë apo jo, apo

argumentimi se përse gruaja meriton sa gjysma e mashkullit në trashëgimi. Të gjitha këto janë çështje të cilat njeriut modern s'mund t'i shpjegohen thjesht me traditën 14 shekullore, sado e pasur që të jetë ajo. Ajo është vlefshme për kohën në të cilën është përpiluar, por tejet e pamjaftueshme sidomos për ditët e sotme ku komunikimi ka arritur majat. Mijëra pyetje ngrihen çdo ditë dhe ne jemi të pamjaftueshëm në përgjigje, sepse sidomos teologët mjaftohen me një hadith apo me një ajet. Ndërkohë që informacionet e marra (në thonjëza) “qyl” nga tradita jonë janë të pamjaftueshme dhe në fakt ne i kërkojmë njerëzve të besojnë apo sillen në një formë të caktuar, sepse kështu kalon në Kuran apo në Traditën Profetike, ndërkohë që vetë Profeti (a.s) në përgjigjet e tij brilante i ushqente njerëzve mendjen, zemrën dhe shpirtin. Jam e bindur se në shumë raste, kur përgjigjet i marrim të gatshme dhe të paketuara, të cilat shpeshherë janë interpretime të një kohe tjetër, të një realiteti krejtësisht ndryshe, ajeteve dhe haditheve i hyjmë në hak. Sepse çdo ajet e çdo hadith na transmeton një mesazh, një parim, të cilin ne kemi për detyrë ta përshtatim me kohën dhe rrethanat ku jetojmë. Mund të themi me plot gojë që perëndimi është shumë përpara nesh edhe në këtë aspekt, si në shumë aspekte të tjerë.

Kjo konferencë dhe punime me tematika të ngjashme janë nga një gur i vendosur në ndërtimin e një kalaje të fortë të jetës sociale të gruas. Duke uruar suksese për konferencën, ju falenderoj që më dëgjuat me durim.

Foto nga konferenca









CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Roli i gruas në shoqërinë moderne sipas këndvështrimit islam (ISCON II) : konferenca e II-të ndërkombëtare në studimet islame: Tiranë, 10 janar 2019: libri i abstrakteve dhe kumtesave/ ed. Genti Kruja; red. shkenc. Rahim Ombashi.
- Tiranë: Bedër press, 2020
141 f. : me foto; 16.5 x 23.5 cm.
ISBN 978-9928-4590-3-9

1.Feja islame 2.Gruaja (Teologji) 3.Konferenca

28 (062)



الجلس العالمي للمجتمعات المسلمة
The World Muslim Communities Council